



PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

2026-2030

Tiranë, 2026

PËRMBAJTJA

1. HYRJA.....	4
2. PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN STRATEGJIK KOMBËTAR E NDËRKOMBËTAR.....	8
2.1 Kuadri ndërkombëtar.....	9
2.2 Kuadri strategjik kombëtar.....	9
2.3 Harmonizimi me strategjitë sektoriale.....	9
2.4 Lidhja me procesin e integritimit evropian.....	10
3. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE	11
3.1. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e aksesueshmërisë	11
3.2. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e aksesit në drejtësi dhe barazisë para ligjit..	14
3.3. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e punësimit dhe aftësimit.....	16
3.4. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e arsimit.....	17
3.5. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e mbrojtjes sociale.....	19
3.6. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e shëndetësisë.....	21
3.7. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e pjesëmarrjes.....	22
3.7.1. Pjesëmarrja në jetën politike.....	22
3.7.2. Pjesëmarrja në jetën artistike dhe kulturore.....	23
3.7.3. Pjesëmarrja në sporte dhe aktivitete rekreative.....	24
3.8. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e bashkëpunimit.....	24
3.8.1. Përmirësimi i funksionimit të mekanizmit kombëtar të koordinimit të politikave..	25
3.8.2. Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm për aftësinë e kufizuar.....	25
3.8.3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar.....	25
3.9. Perceptimi i grupeve të interesit.....	26
4. QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PKVPAK 2026-2030.....	26
4.1. Aksesueshmëria	26
4.1.1. Konteksti strategjik	26
4.1.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	27
4.2. Aksesit në Drejtësi dhe Barazia para Ligjit.....	34
4.2.1. Konteksti strategjik	34
4.2.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	35
4.3. Punësimi dhe Aftësimi	39
4.3.1. Konteksti strategjik.....	39
4.3.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare	41
4.4. Arsimit.....	45
4.4.1. Konteksti strategjik.....	45
4.4.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare	46
4.5. Mbrojtja Sociale.....	49
4.5.1. Korniza strategjike.....	49
4.5.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	51

4.6. Shëndetësia.....	59
4.6.1. Korniza Strategjike.....	59
4.6.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	61
4.7. Përfshirja në jetën publike dhe politike	64
4.7.1. Korniza strategjike.....	64
4.7.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	65
4.8. Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional	67
4.8.1. Korniza Strategjike.....	67
4.8.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare.....	68
5. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	73
5.1 Përgjegjësia e institucioneve.....	73
5.2 Raportimi dhe Monitorimi.....	74
6. INDIKATORET	75
6.1. Aksesueshmëria.....	75
6.2. Aksesimi në Drejtësi dhe Barazia para Ligjit.....	81
6.3. Punësimi dhe Aftësimi.....	86
6.4. Arsimi.....	90
6.5. Mbrojtja Sociale	95
6.6. Shëndetësia.....	101
6.7. Pjesëmarrja	104
6.8. Bashkëpunimi.....	106
7. VLERËSIMI DHE IMPAKTI EKONOMIK & FINANCIAR I PLANIT TË VEPRIMIT KOMBËTAR TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR.....	110
8. KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJITË SEKTORIALE TË VENDIT.....	124
8.1 Kuadri Ligjor.....	124
8.2 Strategjitë Sektoriale.....	130
9. LOGJIKA E NDERHYRJES.....	

LISTA E SHKURTIMEVE

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AK	Aftësia e Kufizuar
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Medieve Audiovizive
AMVV	Agjencia Për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KDPAK	Konventa e OKB për të Drejtat e PAK
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme Shtetërore e Transportit Rrugor
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
EEG	European Expert Group
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
EPSR	Shtylla Evropiane e të Drejtave Evropiane
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GNSPS	Ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
IAP	Institucion i Arsimit Parauniversitar
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KKAK	Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KMVA	Komisioni Multidisiplinor për Vlerësimin në Arsim
KQZ	Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve
KVAK	Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar
LNB	Askush të mos mbetet pas
MA	Ministria e Arsimit

MB	Ministria e Mbrojtjes
MD	Ministria e Drejtësisë
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MEKI	Ministria Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës
MKR	Mekanizmat e Koordinuar të Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
NJF	Ndihma Juridike Falas
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
NJVKSH	Njësia Vendore Kujdesit Shëndetësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPAK	Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
OSHKSH	Operatorit Shtetëror Kujdesit Shëndetësor
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBA	Projekt Buxhet Afatmesëm
PEI	Plan Edukimi Individual
PIZH	Plan Individual Zhvillimi
PKIE	Plani Kombëtar i Integritimit Evropian
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025
QB	Qendra Burimore
QFP	Qendrat e Formimit Profesional
QKSHM	Qendra Komunitare për Shëndetin Mendor
QSUT	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
QSH	Qendrat Shëndetësore
QV	Qendra Votimi
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe integrim Evropian
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ËCAG	Udhëzimi për Aksesueshmërinë e Përmbajtjes në Rrjet
ZVA	Zyrë Vendore e Arsimit

1. HYRJE

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përpertime të rëndësishme në ndërtimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Janë ndërmarrë reforma strukturore, si vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar, zgjerimi i shërbimeve komunitare, përmirësimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe rritja e aksesit në shërbime publike. Megjithatë, sfida kryesore mbetet hendeku midis të drejtave të njohura në kuadrin ligjor dhe zbatimit efektiv të tyre në praktikë.

Për shumë se 148,268 persona me aftësi të kufizuara dhe invalidë pune në Shqipëri, pengesat nuk lidhen vetëm me gjendjen shëndetësore, por me barrierat me të cilat ata ndeshen në mjedis, në shërbimet publike, në informacion, në tregun e punës dhe në jetën komunitare. Për rrjedhojë, përfshirja e tyre nuk është vetëm një çështje e mbrojtjes sociale, por një çështje e të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik dhe demokracisë.

Në këtë kontekst, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 (PKVPAK) përbën dokumentin kryesor të politikave publike, që synon të mundësojë kalimin nga një model i mbështetjes financiare drejt një modeli të përfshirjes së plotë sociale dhe ekonomike. Plani synon të realizojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi reale për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të marrë pjesë në komunitet dhe për të ushtruar të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë. PKVPAK 2026-2030, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të zbatohen gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Ky plan, vjen si një dokument vijues i PKVPAK 2021-2025. Hartimi i PKVPAK 2025-2030 kaloi nëpërmjet një procesi të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP) i ngritur me Urdhër Nr. 553 datë 11.11.2025 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Prosesi i formulimit dhe konsultimit të dokumentit u realizua me asistencën teknike të dy ekspertëve vendas të UNDP-së si pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos Mbetet Pas / *Leave No One Behind*” (LNB), që zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe mbështetet nga Qeveria Zvicerane (SDC).

PKVPAK 2026-2030 përfshin *tetë fusha prioritare* të politikave publike: (i) aksesueshmëria; (ii) barazia para ligjit dhe aksesit në drejtësi; (iii) punësimi dhe aftësimi profesional; (iv) arsimit gjithëpërfshirës; (v) mbrojtja sociale dhe jetesa e pavarur (vi) shëndetësia dhe rehabilitimi; (vii) pjesëmarrja në jetën politike, kulturore, sportive dhe rekreative; (viii) bashkëpunimi institucional dhe koordinimi i politikave.

Në këto fusha prioritare, PKVPAK përcakton *28 objektiva specifike*, të cilat operacionalizohen përmes *68 masave prioritare* dhe *283 ndërhyrjeve konkrete të buxhetuara*, të shpërndara përgjatë periudhës 2026-2030. Kostoja totale për zbatimin e Planit të Veprimit për periudhën 2026-2030 është vlerësuar në **7 615 080 707 (Shtatë miliardë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë milionë e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë.) lekë.**

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në *PKVPAK 2026-2030*, është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministritë e linjës. Në rastet kur buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, *PKVPAK* parashikon një ndarje të hendekut të financimit, si dhe propozimin për fonde donatorësh. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë Plan Kombëtar Veprimi, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore.

PKVPAK 2026-2030, është hartuar përmes një procesi konsultimi gjithëpërfshirës me institucionet publike qendrore dhe vendore, organizatat e shoqërisë civile, organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara, ekspertë të fushës dhe partnerë ndërkombëtarë. Personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre kanë marrë pjesë aktivisht në identifikimin e prioriteteve, diskutimin e masave dhe vlerësimin e pengesave reale në jetën e përditshme, duke siguruar që Plani të reflektojë nevojat konkrete dhe jo vetëm parashikime institucionale.

Dokumenti është i strukturuar në disa kapituj kryesorë. Pas hyrjes, kapitulli i dytë paraqet përputhshmërinë e Planit me kuadrin strategjik kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar. Kapitulli i tretë analizon gjendjen aktuale në secilën fushë prioritare, bazuar në gjetjet e Raportit të Monitorimit të *PKVPAK* të mëparshëm, 2021-2025. Kapitulli i katërt paraqet kontekstin strategjik specifik të çdo fushe veprimi, përfshirë qëllimi, objektivat specifikë, masat prioritare. Kapitulli i pestë, përcakton sistemin e monitorimit, raportimit dhe llogaridhënies. Kapitulli i gjashtë, identifikon treguesit për çdo fushë prioritare dhe kapitulli i shtatë, është i lidhur me buxhetimin në çdo fushë prioritare të dokumentit.

PKVPAK 2026-2030 synon të shërbejë jo vetëm si dokument planifikimi, por si instrument qeverisjeje që orienton institucionet përgjegjëse drejt garantimit real të barazisë së mundësive dhe përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Zbatimi i tij do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe me përfshirjen direkte të pikave fokale në ministritë e linjës. Zbatimi i suksesshëm i këtij Plani, do të varet edhe nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, kryesisht i institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

2. PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN STRATEGJIK KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 (*PKVPAK*) përbën instrumentin qendror të politikave publike të Republikës së Shqipërisë për garantimin e të drejtave, përfshirjes dhe pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara. Ky plan, nuk është një dokument i izoluar politikash sociale, por një dokument i lidhur ngushtë me angazhimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me procesin e integritimit evropian dhe me dokumentet strategjike kombëtare dhe sektoriale. Qasja mbi të cilën ndërtohet Plani mbështetet në parimin e

integritit horizontal të aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat publike. Për rrjedhojë, politikat për personat me aftësi të kufizuara nuk trajtohen si një sektor i veçantë, por si një dimension i detyrueshëm i çdo politike shtetërore që lidhet me shërbimet publike, zhvillimin ekonomik dhe pjesëmarrjen qytetare.

2.1 Kuadri ndërkombëtar

Referenca themelore e Planit është Konventa¹ e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga parimet e e kësaj Konvente, PKVPAK 2026-2030, synon të vendosë në fokus jetesën e pavarur, aksesueshmërinë universale dhe pjesëmarrjen e plotë në komunitet.

Plani kontribuon gjithashtu në realizimin e Objektivave² të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), duke adresuar varfërinë, pabarazitë, arsimin cilësor, punësimin e denjë dhe qytetet gjithëpërfshirëse.

PKVPAK 2026-2030 harmonizohet me politikat e Bashkimit Evropian për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë Strategjinë³ e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030, Direktivat⁴ për aksesueshmërinë, si dhe udhëzimet⁵ për jetesën e pavarur në komunitet. Këto dokumente orientojnë që Shqipëria të kalojë nga politikat mbrojtëse drejt garantimit të barazisë së mundësive dhe eliminimit të barrierave strukturore.

2.2 Kuadri strategjik kombëtar

Në nivel kombëtar, PKVPAK është i harmonizuar me dokumentet kryesore strategjike të vendit, veçanërisht me Strategjinë⁶ Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), e cila synon rritjen e mirëqenies, kohezionit social dhe barazisë së mundësive. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara konsiderohet një tregues i drejtpërdrejtë i cilësisë së zhvillimit dhe i funksionimit të shtetit social.

2.3 Harmonizimi me strategjitë sektoriale

PKVPAK 2026-2030, është hartuar mbi ndërveprimin e drejtpërdrejtë me strategjitë sektoriale të qeverisë shqiptare, duke siguruar që përfshirja e personave me aftësi të kufizuara të jetë pjesë e politikave të çdo sektori dhe jo një ndërhyrje paralele.

¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2006). Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

² Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2015). Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. OKB.

³ Komisioni Evropian. (2021). Bashkimi i Barazisë: Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030. Komisioni Evropian.

⁴ Bashkimi Evropian. (2019). Direktiva (BE) 2019/882 për kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet (Akti Evropian i Aksesueshmërisë). Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian.

⁵ Komisioni Evropian. (2022). *Udhëzues për jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet për personat me aftësi të kufizuara*. Komisioni Evropian

⁶ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2022). *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE)*. Këshilli i Ministrave.

Në fushën e drejtësisë, PKVPAK harmonizohet me Strategjinë⁷ Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Strategjinë⁸ për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe Strategjinë⁹ e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, duke garantuar akses real në drejtësi, barazi para ligjit dhe mbrojtje efektive të të drejtave procedurale.

Në fushën e punësimit dhe aftësive, ai lidhet me Strategjinë¹⁰ Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe kalimin drejt fuqizimit ekonomik të personave me aftësi të kufizuara.

Në arsim, PKVPAK përputhet me Strategjinë¹¹ Kombëtare për Arsimin 2021-2026, duke mbështetur zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe transformimin e sistemit arsimor në një sistem që garanton mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.

Në fushën e mbrojtjes sociale, ai harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen¹² Sociale 2024-2030, duke mbështetur ndërthurjen mes sistemit të pagesave në para me sistemin e shërbimeve në komunitet dhe jetesën e pavarur.

Në fushën e shëndetësisë, PKVPAK lidhet me Strategjinë¹³ Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, zhvillimin¹⁴ e kujdesit shëndetësor parësor dhe ato të lidhura me shëndetin mendor, duke synuar akses të barabartë në shërbime shëndetësore dhe rehabilituese.

Në kulturë¹⁵, turizëm¹⁶ dhe sport¹⁷, ai mbështetet në strategjitë përkatëse kombëtare për kulturën, turizmin dhe sportin, duke promovuar pjesëmarrjen kulturore, rekreative dhe sportive si pjesë e jetës komunitare.

⁷ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2024). *Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030*. Miratuar me VKM nr. 787, datë 18.12.2024.

⁸ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2023). *Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030*. Miratuar me VKM nr. 729, datë 13.12.2023.

⁹ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2022). *Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026*. Miratuar me VKM nr. 892, datë 27.12.2022.

¹⁰ Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2022). *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

¹¹ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2021). *Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026*. Miratuar me VKM nr. 621, datë 22.10.2021.

¹² Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2024). *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 dhe plani i veprimit*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2024). *Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2024-2028*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

¹³ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

¹⁴ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2020). *Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025*. Miratuar me VKM nr. 405, datë 20.05.2020

¹⁵ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. (2019). *Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025*. Miratuar me VKM nr. 903, datë 24.12.2019.

¹⁶ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2025). *Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

¹⁷ Ministria përgjegjëse për sportin, Republika e Shqipërisë. (2025). *Strategjia Kombëtare për Sportin 2025-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

2.4 Lidhja me procesin e integritit evropian

Përtej harmonizimit me strategjitë kombëtare, PKVPAK 2026-2030 lidhet drejtpërdrejt me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Politikat për personat me aftësi të kufizuara janë ndërsektoriale dhe kontribuojnë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga disa kapituj¹⁸ të *acquis communautaire*, veçanërisht ata që lidhen me të drejtat themelore, politikat sociale dhe punësimin, arsimin, shëndetësinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në këtë kuadër, zbatimi i PKVPAK kontribuon në zhvillimin e standardeve në fushën e të drejtave themelore dhe të mosdiskriminimit, përmirësimin e politikave sociale dhe të punësimin, garantimin e aksesit në shërbime publike dhe rritjen e cilësisë së jetës. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara shërben kështu si indikator i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe i kapacitetit administrativ të institucioneve publike.

PKVPAK 2026-2030 përfaqëson mekanizmin që lidh angazhimet ndërkombëtare, reformat e integritit evropian dhe politikat kombëtare sektoriale në një sistem të vetëm veprimi. Ai synon të kalojë nga njohja ligjore e të drejtave drejt realizimit praktik të tyre, duke ndërtuar një model qeverisjeje, ku përfshirja e personave me aftësi të kufizuara bëhet pjesë e funksionimit normal të institucioneve publike.

3. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, tregon se Shqipëria ka bërë përparime në ndërtimin e kuadrit ligjor, zhvillimin e instrumenteve të politikave dhe zgjerimin e disa shërbimeve publike, veçanërisht në mbrojtjen sociale, arsimin gjithëpërfshirës, shëndetësinë dhe aksesin në drejtësi. Reforma e vlerësimit bio-psiko-social, konsolidimi i ndihmës juridike falas dhe zgjerimi gradual i shërbimeve komunitare, përbëjnë arritje strukturore me ndikim afatgjatë. Megjithatë, monitorimi ndërsektorial evidenton se sfida kryesore mbetet hendeku midis të drejtave të njohura në legjislacion dhe zbatimit efektiv të tyre në praktikë. Koordinimi i pamjaftueshëm ndër-institucional, kapacitetet e kufizuara profesionale, mungesa e mekanizmave të qëndrueshëm financiarë, e të dhënave të integruara, si dhe pabarazitë territoriale në ofrimin e shërbimeve, vijojnë të kufizojnë përfshirjen reale të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale, ekonomike dhe publike. Për rrjedhojë, Plani i ri 2026-2030, synon të kalojë nga zgjerimi i politikave dhe programeve drejt konsolidimit të zbatimit, duke përqendruar ndërhyrjet në forcimin e qeverisjes së politikave të aftësisë së kufizuar, garantimin e financimit të qëndrueshëm dhe ndërtimin e mekanizmave të detyrueshëm të monitorimit dhe llogaridhënies, në mënyrë që përparimet e arritura të përkthehen në përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë së jetës.

¹⁸ Komisioni Evropian. (2020). *Metodologjia e zgjerimit: Përmirësimi i procesit të anëtarësimit*. Komisioni Evropian.

3.1. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e aksesueshmërisë

Gjatë zbatimit të PKVPAK 2021-2025, në fushën e aksesueshmërisë u përcaktua si qëllim strategjik realizimi i aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedise, transport, informacion dhe komunikim, me synim reduktimin e barrierave fizike, sociale dhe digjitale në jetën publike.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në OKB, lidhur me zbatimin e Nenit 9 të KDPAK, “*Aksesueshmëria*”, tërheq vëmendjen e Qeverisë Shqiptare në lidhje me: (i) *mungesën e një plani kombëtar gjithëpërfshirës mbi zbatimin e Ligjit¹⁹ Nr. 93/2014 dhe VKM²⁰ Nr. 1074/2015 mbi heqjen e barrierave mjedisore dhe infrastrukturore në shërbimet publike; (ii) mungesën e të dhënave mbi aplikimin e penaliteteve administrative dhe financiare për mos plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë, duke përfshirë ndërtesat e vjetra në shërbim të publikut; (iii) mungesën e informacionit mbi aksesueshmërinë në mediet elektronike, përfshi edhe medien sociale.*

Shpesh aksesueshmëria në mjedise identifikohet vetëm me vendosjen e një rampe në hyrje të ndërtesës, e cila në shumë raste rezulton jashtë standardeve. Më pak vëmendje i kushtohet aplikimit të elementëve të aksesueshmërisë për personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim dhe personat që nuk dëgjojnë ose kanë vështirësi në dëgjim. Gjithashtu, pak vëmendje ka në produktet dhe shërbimet e aksesueshme. Mungesa e një strukture të specializuar mbi kontrollin e territorit në lidhje me nivelin e aksesueshmërisë, ka lejuar krijimin në vazhdimësi të barrierave të reja në mjedis.

Gjatë viteve të fundit aksesueshmëria në mjedise ka pasur përmirësime kryesisht në qytetin e Tiranës, por në shumë raste jo sipas standardeve të kërkuara dhe sigurisht, janë akoma të pamjaftueshme. Përdoruesit e karrigeve me rrota mendojnë që rampat e realizuara janë jashtë standardeve, ndërsa personat me probleme shikimi mendojnë se edhe relievi në rrugë për ta nuk është në përputhje me standardet.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), objektin kryesor të punës së tij e mbështet në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*” të ndryshuar, por Policia Bashkiake nuk ka të specifikuar në objektin e saj të punës, kontrollin e zbatimit të lejeve të ndërtimit në zbatimin e kërkesave të përshtatshmërisë në ndërtim dhe infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara. Rezultatet e raporteve të Monitorimit të zbatimit të Planit 2021-2025 treguan se në sajë të masave të ndërmarra ka pasur zhvillime pozitive në disa sektorë, por progresi ka qenë i pabarabartë dhe i pamjaftueshëm në raport me objektivat. Në aksesueshmërinë në mjedise është rritur numri i institucioneve publike që gjatë ndërtimeve ose rikonstruksioneve janë pajisur me elemente përshtatshmërie, por jo gjithnjë në përputhje me standardet, ndërkohë që kuadri ligjor ekziston dhe konsiderohet bashkëkohor. Megjithatë, zbatimi i tij ka mbetur i ngadalshëm dhe i fragmentuar, për shkak se aksesueshmëria nuk përbën kompetencë të një institucioni të vetëm, mungon një autoritet

¹⁹“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

²⁰ “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

koordinues dhe nuk është ngritur struktura e parashikuar për monitorimin e standardeve. Inspektimi institucional mbetet i kufizuar dhe jo sistematik, ndërsa bashkëpunimi ndërinstitutional dhe shkëmbimi i informacionit mbi nivelin e aksesueshmërisë vijon të jetë i dobët. Në këto kushte, megjithëse ekziston legjislacioni i plotë, ai nuk shoqërohet me mekanizma efektivë zbatimi, me planifikim buxhetor dhe me sanksione, çka ka sjellë moszbatim të akteve nënligjore për eliminimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë, produkte e shërbime.

Në fushën e transportit, situata paraqitet më problematike. Mungesa e transportit të aksesueshëm vazhdon të jetë një nga barrierat kryesore për punësimin, arsimin, shërbime shëndetësore dhe pjesëmarrjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Megjithëse kuadri ligjor për transportin rrugor është përafuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe janë vendosur kërkesa për parametrat e aksesueshmërisë së mjeteve dhe asistencën ndaj pasagjerëve, zbatimi praktik mbetet i kufizuar. Angazhimi institucional për përmirësimin e transportit publik ka qenë i ulët dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi pajisjen reale të mjeteve me elemente aksesueshmërie. Ndërsa, nëse në терминаlet e reja janë bërë hapa pozitiv në lidhje me aksesin, терминаlet ekzistuese vazhdojnë të kenë mungesa të konsiderueshme. Trajnimi i stafit dhe ofrimi i asistencës janë realizuar pjesërisht dhe udhëzuesit informues për përdoruesit nuk janë publikuar ende. Për rrjedhojë, aksesueshmëria në transport vazhdon të mbetet një pengesë e madhe strukturore për integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Informacioni dhe komunikimi janë veçanërisht të rëndësishëm për personat me aftësi të kufizuara. Ndërkohë shumë prej tyre mund të kenë vështirësi të kuptojnë informacionin e ofruar. Ata mund të jenë me vështirësi në shikim, në të dëgjuar, apo mund të kenë pamundësi ose vështirësi në të lexuar. Që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë aktive, të marrin pjesë dhe të bëjnë zgjedhje në lidhje me jetën e tyre, është thelbësore që të kenë mundësi të përdorin informacionin përmes sistemeve të përshtatshme të komunikimit.

Në fushën e informacionit dhe komunikimit është konstatuar progres më i kënaqshëm. Janë ndërmarrë përmirësime ligjore dhe institucionale për aksesueshmërinë digjitale, përfshirë përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane dhe integrimin e kërkesave të aksesueshmërisë në shërbimet e qeverisjes elektronike.

Platforma e shërbimeve publike digjitale është në proces përshtatjeje sipas standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë, ndërsa janë krijuar lehtësira në rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet telefonike. Gjithashtu, ndryshimet në legjislacionin e medieve audiovizive dhe kodi i ri i transmetimit kanë përforcuar detyrimet për përdorimin e gjuhës së shenjave, titrimin dhe aksesin në informacion publik, duke mundësuar informim më të gjerë për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, fusha mbetet komplekse dhe kërkon standardizim të mëtejshëm, rritje të përdorimit të teknologjive asistuese dhe trajnime për përdoruesit.

Në përmbledhje, analiza e periudhës 2021-2025 tregon se vendi ndodhet në një fazë tranzicioni nga krijimi i kuadrit normativ drejt zbatimit praktik të aksesueshmërisë. Nga 60 aktivitetet e planifikuara, vetëm një pjesë e vogël janë realizuar plotësisht, kryesisht në informacion dhe komunikim, ndërsa progresi rezulton i dobët në mjedis dhe transport.

Pushteti vendor luan një rol të rëndësishëm dhe ka përgjegjësi të madhe në realizimin e aksesueshmërisë fizike. Nga ana e bashkive ka një mungesë të theksuar të njohjes dhe zbatimit të VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*. Një ndikim të fuqishëm ka bashkëpunimi dhe ndërveprimi i koordinuar i dy pushteteve në përmirësimin e aksesueshmërisë.

Problemet kryesore lidhen me mungesën e një strukture kombëtare monitorimi, koordinimin e pamjaftueshëm ndërinstucional, mungesën e statistikave dhe raportimit, financimin e kufizuar, si dhe mos shoqërimin e legjislacionit me mekanizma detyrues dhe sanksione.

Për rrjedhojë, Plani i ri 2026-2030 do të fokusohet jo vetëm në ndërhyrje infrastrukturore apo teknologji, por në ndërtimin e një sistemi funksional të qeverisjes së aksesueshmërisë, që përfshin koordinim institucional, monitorim të detyrueshëm, raportim kombëtar periodik, rishikim të legjislacionit me masa zbatuese dhe rritje të investimeve, në mënyrë që aksesueshmëria të kalohet nga një politikë formale në një standard të garantuar realisht për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi është që aksesueshmëria të mos mbetet një standard formal, por një e drejtë e garantuar realisht për çdo person me aftësi të kufizuara.

3.2. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e aksesit në drejtësi dhe barazisë para ligjit

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025²¹, fusha e barazisë në sistemin e drejtësisë synoi garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet rritjes së përdorimit të ndihmës juridike falas, njohjes së barabartë para ligjit dhe respektimit të të drejtave të tyre në institucionet e dënimit.

Vlerësimi i periudhës tregon se progresi më i prekshëm është arritur në dimensionin praktik të aksesit fillestar në drejtësi, ndërsa reformat strukturore të barazisë juridike mbeten ende të papërfunduara.

Arritja më e dukshme lidhet me konsolidimin e sistemit të Ndihmës Juridike Falas. Integrimi i plotë i Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2025 ka shënuar kalimin nga një shërbim i mbështetur kryesisht nga donatorët në një shërbim publik të qëndrueshëm financiarisht. Kjo reformë është reflektuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të përfituesve. Në vitet 2024-2025, 11,636 persona me aftësi të kufizuara përfituan ndihmë juridike parësore dhe 955 persona ndihmë juridike dytësore.

Krahasuar me tre vitet e para të zbatimit të planit (913 përfitues), numri i përfituesve të ndihmës juridike parësore është rritur rreth 12 herë, duke përbërë një nga treguesit më të fortë të progresit real në të gjithë Planin. Vetëm gjatë vitit 2024 përfituan 6,220 persona me aftësi të kufizuara,

²¹ Raporti i Monitorimit të Zbatimit të PKVPAK, 2021-2025. MSHMS. 2026.

ndërsa në vitin 2025 përfituan 5,416, të dhëna të cilat tregojnë jo vetëm rritje, por stabilizim të kërkesës dhe funksionim të konsoliduar të sistemit.

Zgjerimi i aksesit është mbështetur edhe nga 13 klinika ligjore universitare dhe financimi i organizatave të shoqërisë civile për shtrirjen e shërbimit në komunitete të përjashtuara.

Një tjetër element progresi është rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit. Vetëm gjatë vitit 2025 janë realizuar 543 aktivitete informuese në nivel kombëtar, nga të cilat 19 të dedikuara posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara.

Për herë të parë janë prodhuar materiale informuese në gjuhë të thjeshtë, audio, gjuhën e shenjave dhe Braille, duke mundësuar akses të drejtpërdrejtë në informacion për kategori të ndryshme aftësie të kufizuar. Po ashtu, është ofruar shërbim lëvizës i ndihmës juridike për personat me pamundësi lëvizjeje dhe për zonat me akses të kufizuar.

Në drejtim të kapaciteteve profesionale janë realizuar trajnime për aktorët e sistemit të drejtësisë: vetëm përmes bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë janë trajnuar 293 studentë të klinikave ligjore, si dhe punonjës të qendrave të ndihmës juridike, avokatë dhe organizata jofitimprurëse. Gjithashtu, janë zhvilluar 5 trajnime për përfaqësues të institucioneve të drejtësisë në disa qytete dhe 7 seanca trajnuese nga Shkolla e Magjistraturës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Këto ndërhyrje kanë rritur aftësinë e sistemit për të trajtuar rastet e personave me aftësi të kufizuara, por nuk kanë qenë të mjaftueshme për të ndryshuar praktikën gjyqësore në mënyrë sistemike.

Ndryshe nga progresi i dukshëm në ndihmën juridike, njohja e barabartë para ligjit mbetet sfida më e madhe strukturore. Legjislacioni shqiptar, veçanërisht dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Familjes, nuk është përshtatur ende plotësisht me parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në lidhje me zotësinë për të vepruar. Edhe pse është miratuar kuadri për vendimmarrjen e mbështetur, ai nuk shoqërohet ende me ndryshime të plota ligjore dhe procedurale, çka bën që personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara mendore, të mos e ushtrojnë plotësisht kapacitetin juridik në praktikë.

Në institucionet e dënimit janë ndërmarrë masa për përmirësimin e trajtimit dhe monitorimit, përfshirë raportime të rregullta shëndetësore dhe përpjekje për zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare, si dhe planifikimin e ndërtimit të një spitali forensik të specializuar. Megjithatë, disa rregullime ligjore dhe procedurale mbeten të pa miratuara.

Gjatë periudhës 2021-2025, aksesit fillestar në drejtësi është përmirësuar ndjeshëm, përmes shumëfishimit të ndihmës juridike falas, ndërsa barazia para ligjit mbetet kryesisht një objektiv normativ i pa realizuar plotësisht. Sfidat kryesore lidhen me mungesën e reformës së plotë ligjore për zotësinë juridike për të vepruar, koordinimin ndërinstitucional dhe kapacitetet profesionale të sistemit të drejtësisë. Për rrjedhojë, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 do të fokusohet në reforma strukturore, duke kaluar nga garantimi i aksesit formal në

shërbime juridike drejt garantimit të ushtrimit real dhe të plotë të të drejtave për personat me aftësi të kufizuara.

3.3 Analiza e gjendjes aktuale në fushën e punësimit dhe aftësimin

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, fusha e punësimit dhe aftësimin profesional kishte si qëllim rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës dhe krijimin e mundësive të barabarta për punë të denjë, përmes përmirësimit të arsimit dhe formimit profesional, zgjerimit të programeve të nxitjes së punësimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve të integritit në tregun e punës.

Monitorimi i periudhës 2021-2025 tregon se në këtë fushë janë ndërmarrë masa të rëndësishme dhe është shënuar progres i dukshëm në aspektin e përfshirjes, por rezultatet mbeten të pjesshme dhe të paqëndrueshme, pasi shumë prej mekanizmave mbështetës nuk janë institucionalizuar plotësisht dhe nuk kanë arritur ende të përkthehen në punësim të qëndrueshëm.

Në dimensionin e arsimit dhe formimit profesional, zhvillimi më pozitiv lidhet me rritjen graduale të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara. Numri i kursantëve në kurset e formimit profesional u rrit nga 94 në vitin 2024 në 233 persona në vitin 2025, duke reflektuar një trend të qartë të zgjerimit të aksesit në trajnim profesional.

Edhe në arsimin e mesëm profesional vërehet një rritje e vazhdueshme: nga 212 nxënës me aftësi të kufizuara në vitin shkollor 2023-2024, në 242 nxënës me aftësi të kufizuara në vitin 2024-2025, ndërkohë që numri i mësuesve ndihmës u rrit nga 51 në 57. Ky zhvillim tregon një zgjerim real të sistemit gjithëpërfshirës, si dhe një përpjekje për të respektuar standardet nënligjore të mbështetjes arsimore.

Një hap i rëndësishëm cilësor është hartimi i Manualit për Gjithëpërfshirjen e Nxënësve dhe Kursantëve me Aftësi të Kufizuara në Arsimin dhe Formimin Profesional, i cili përcakton standarde për vlerësimin, planet individuale të mbështetjes, përshtatjen e arsyeshme dhe metodat e të nxënësve të aksesueshëm. Për herë të parë u krijua mundësia e financimit të përshtatjes së arsyeshme deri në 200,000 lekë për kursantët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë përshtatjen e kurrikulave dhe përgatitjen e instruktorëve për trajnim të posaçëm. Këto masa përbëjnë një ndryshim të rëndësishëm konceptual, pasi sistemi tentoi të kalojë nga integrimi formal në përpjekje për mbështetje individuale, të bazuar në nevojat e personit.

Megjithatë, këto zhvillime mbeten ende të kufizuara në shtrirje. Manualët dhe standardet janë në fazë pilotimi dhe nuk janë bërë pjesë e detyrueshme e sistemit. Mungojnë programe të strukturuar dhe të certifikuar trajnimi për mësuesit lëndorë, instruktorët dhe mësuesit ndihmës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve arsimore dhe në zbatimin real të gjithëpërfshirjes.

Financimi për përshtatjen e arsyeshme ekziston, por u aplikua në mënyrë të kufizuar për shkak të mungesës së udhëzimeve procedurale. Po ashtu, nuk arritën të realizohen masa të rëndësishme si ofrimi falas i kurseve të gjuhëve të huaja dhe teknologjisë së informacionit, ndërsa përgatitja e

interpretëve të gjuhës së shenjave ka mbetur pa progres, çka tregon se sistemi arsimor profesional është në proces transformimi, por ende nuk ka arritur të krijojë një model të plotë dhe të qëndrueshëm përfshirjeje.

Në dimensionin e punësimit, progresi është më i dukshëm në rritjen e pjesëmarrjes në programe sesa në punësimin real. Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfituan nga programet e nxitjes së punësimit u rrit nga 103 në vitin 2024 në 242 persona në vitin 2025. Edhe skema e Garancisë Rinore përfshiu 71 të rinj me aftësi të kufizuara gjatë dy viteve.

Paralelisht, u rrit edhe numri i personave të regjistruar si punëkërkues, nga 3,347 në vitin 2024 në 3,429 persona në vitin 2025. Këta tregues dëshmojnë një rritje të kontaktit të personave me aftësi të kufizuara me shërbimet e punësimit dhe një besim më të madh ndaj institucioneve publike. Megjithatë, këto zhvillime nuk janë përkthyer ende në rritje të qëndrueshme të punësimit. Në vitin 2024 u punësuan 379 persona me aftësi të kufizuara, ndërsa në vitin 2025 u punësuan 266. Ky kontrast mes rregjistrimit dhe punësimit nxjerr në pah që sistemi funksionon më mirë në regjistrimin sesa në ndërmjetësimin efektiv me punëdhënësit dhe garantimin e një punësimi të qëndrueshëm të punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës së mëparshme, janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e shërbimeve publike të punësimit, përfshirë manuale për këshillim karriere, profilizim dhe punësim me mbështetje, si dhe përmirësim të bazës së të dhënave për punëkërkuesit me aftësi të kufizuara. Megjithatë, këto mekanizma janë ende në konsolidim dhe ndikimi i tyre mbetet i kufizuar. Sfidat kryesore rezultojnë strukturore. Fondi Social i Punësimit, i cili do të mundësonte mbështetje për vetëpunësim dhe integrim afatgjatë, nuk është ende funksional. Mungon një studim kombëtar për situatën e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, çka kufizon planifikimin strategjik. Bashkëpunimi me sektorin privat mbetet i dobët dhe përshtatja e arsyeshme në vendin e punës nuk aplikohet.

Monitorimi i zbatimit të PKVPAK për periudhën 2021-2025 tregon një progres real në aksesin në arsim profesional dhe në pjesëmarrjen në programe punësimi, por një progres shumë më të kufizuar në punësimin e qëndrueshëm. Sistemi aktual ka arritur të afrojë personat me aftësi të kufizuara pranë tregut të punës, por ende nuk ka krijuar mekanizma efektivë për t'i mbajtur ata në të. Për këtë arsye, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 duhet të kalojë nga qasja e përfshirjes sociale drejt gjithëpërfshirjes ekonomike reale, duke institucionalizuar standardet e arsimit profesional gjithëpërfshirës, funksionalizuar mekanizmat financiarë të punësimit, zhvilluar punësimin me mbështetje dhe forcuar ndërmjetësimin me punëdhënësit, në mënyrë që punësimi i personave me aftësi të kufizuara të mos mbetet rezultat projektesh apo programesh të përkohshme, por të bëhet një proces i qëndrueshëm dhe pjesë e zakonshme e tregut të punës.

3.4. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e arsimit

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, në fushën e arsimit u përcaktua si objektiv strategjik ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në arsimin e zakonshëm dhe transformimit të shkollave speciale në qendra burimore.

Monitorimi i zbatimit të këtij Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara tregon se janë hedhur baza të rëndësishme institucionale në arsim gjithëpërfshirës, ndërsa rezultatet janë më të dukshme në aksesin në shkollë dhe ngritjen e strukturave mbështetëse, se sa në cilësinë e qëndrueshme të përfshirjes.

Një nga treguesit më të qartë të progresit është rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsimin parauniversitar publik. Në vitin shkollor 2025-2026 sistemi arsimor përfshin 5,208 nxënës me aftësi të kufizuara, nga 4,682 një vit më parë. Kjo rritje reflekton përmirësim të identifikimit dhe referimit të fëmijëve, por edhe rritje të besimit të familjeve ndaj arsimit gjithëpërfshirës. Nuk janë raportuar raste të braktisjes të shkollës, megjithëse mungesa e të dhënave të detajuara sipas faktorëve socialë dhe ekonomikë e bën të vështirë analizën e plotë të vijueshmërisë.

Në mbështetje të përfshirjes, është ndërtuar një sistem vlerësimi ndërdisiplinor. Komisionet Multidisiplinare për Vlerësimin e Nevojave të Nxënësve me Aftësi të Kufizuara (KMVA) kryejnë vlerësime psiko-pedagogjike dhe funksionale, rekomandojnë masa mbështetëse dhe hartojnë Plane Edukative Individuale, duke bashkëpunuar me shkollat, prindërit dhe shërbimet psiko-sociale. Miratimi në vitin 2024 i udhëzuesit të standardizuar sipas modelit bio-psiko-social ka rritur transparencën dhe koherencën e vendimmarrjes arsimore. Megjithatë, bashkëpunimi i këtyre komisioneve me strukturat e vlerësimit në sistemin e mbrojtjes sociale nuk është ende i institucionalizuar, duke krijuar fragmentarizim në mbështetjen e fëmijëve.

Mbështetja brenda shkollës është përmirësuar ndjeshëm. Raporti mesatar nxënës-mësues ndihmës ka qenë 2.12 në vitin 2024-2025 dhe 2.24 në 2025-2026, ndërsa rregullimi i ri lejon që një mësues ndihmës të punojë edhe me një nxënës të vetëm. Janë miratuar standardet profesionale të mësuesve ndihmës dhe është realizuar një proces i gjerë trajnimi. Rreth 1,500 mësues ndihmës u trajnuan në vitin 2024 dhe rreth 2,000 në vitin 2025.

Në këtë aspekt, janë monitoruar 80 zyra arsimore vendore dhe janë inspektuar 157 institucione arsimore për cilësinë e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara.

Infrastruktura mbështetëse është përmirësuar gjatë viteve të zbatimit të PKVVK 2021-2025. Numri i klasave burimore u rrit nga 291 në vitin shkollor 2024-2025 në 317 në atë 2025-2026.

Paralelisht, ka filluar transformimi i shkollave speciale në qendra burimore. Tre institucione tashmë funksionojnë si struktura referimi për ekspertizë profesionale dhe mbështetje metodologjike për shkollat e zakonshme. Janë zhvilluar module për gjuhën e shenjave dhe materiale didaktike të specializuara, ndërsa Kodi Braille është unifikuar në nivel kombëtar, edhe pse institucionalizimi i plotë ligjor mbetet në proces.

Megjithatë, përtej progresit në akses, cilësia e përfshirjes mbetet sfida kryesore. Ndërhyrjet mbështetëse varen ende nga kapacitetet profesionale lokale dhe zbatimi i Planeve Edukative Individuale nuk është i njëtrajtshëm. Monitorimi i ndikimit real të masave mbështetëse në progresin akademik dhe social të nxënësve mbetet i kufizuar. Po ashtu, mungesa e një sistemi të integruar të të dhënave kufizon analizën e frekuentimit dhe rrezikut për braktisjen e shkollës.

Një problem tjetër është mbështetja sociale e pamjaftueshme për të ndjekur shkollën. Skema e transportit falas ka përfshirë vetëm 30 nxënës në vitin 2024 dhe 32 në vitin 2025, çka tregon se mekanizmat e aksesit nuk janë ende efektivë për shumicën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, furnizimi me materiale didaktike të përshtatura dhe financimi i tyre mbetet i pamjaftueshëm në shumë shkolla.

Në periudhën 2021-2025, Shqipëria ka kaluar nga faza e përjashtimit në arsim drejt përfshirjes në sistem, por ende jo drejt gjithëpërfshirjes cilësore. Sistemi arsimor ka arritur të përfshijë një numër më të madh fëmijësh dhe të krijojë struktura mbështetëse, por nuk ka arritur ende të garantojë standarde të njëtrajtshme cilësie në të gjithë territorin.

Për këtë arsye, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2026-2030 do të fokusohet në konsolidimin e reformës dhe jo vetëm në zgjerimin e aksesit. Prioritetet do të përfshijnë institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet sistemit arsimor dhe atij të mbrojtjes sociale, përfundimin e transformimit të shkollave speciale në qendra burimore funksionale, forcimin e kapaciteteve profesionale të mësuesve dhe mësuesve ndihmës, garantimin e shërbimeve mbështetëse si transporti dhe materialet didaktike, si dhe krijimin e një sistemi të plotë të monitorimit të rezultateve arsimore.

3.5. Analiza e gjendjes aktuale në fushën e mbrojtjes sociale

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, fusha e mbrojtjes sociale synoi përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes përfitimeve dhe shërbimeve të aksesueshme, të përbalueshme dhe të orientuara drejt nevojave individuale.

Monitorimi i zbatimit të këtij Plani, tregon se kjo është një nga fushat ku është arritur progresi më i dukshëm strukturor, veçanërisht me konsolidimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve komunitare. Megjithatë sistemi mbetet ende në një fazë tranzicioni nga përfitimet financiare drejt një modeli të plotë të kujdesit social dhe jetesës së pavarur që ndërthur përfitimet në para me shërbimet e integruara.

Një nga zhvillimet kryesore në këtë drejtim është konsolidimi në shkallë kombëtare i reformës së vlerësimit bio-psiko-social. Reforma tashmë është shtrirë në të gjithë territorin e vendit, përmes funksionimit të 37 komisioneve të vlerësimit, të shpërndara sipas popullsisë dhe numrit të përfituesve. Gjatë kësaj periudhe është investuar në rritjen e kapaciteteve profesionale. Në vitin 2024 janë trajnuar 123 profesionistë të komisioneve (mjekë, punonjës socialë dhe operatorë), s i

dhe stafe të shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor, ndërsa trajnimet vijuan edhe në vitin 2025.

Reforma ka mundësuar gjithashtu zgjerimin e skemës së mbështetjes, duke përfshirë në procesin e vlerësimit kategori dhe tipologji të reja të aftësisë së kufizuar që më parë nuk trajtoheshin nga sistemi, si psh., personat që nuk dëgjojnë mbi 21 vjeç, më shumë raste me probleme të shëndetit mendor, etj.

Përfitimet monetare vijojnë të përbëjnë një komponent të rëndësishëm të mbështetjes sociale për personat me aftësi të kufizuara. Numri i personave që marrin pagesë për aftësinë e kufizuar u rrit nga 73,559 persona në vitin 2024 në 76,586 në vitin 2025. Janë përfshirë në përfitimin e fishave të diabetit falas të gjithë personat me aftësi të kufizuar Po ashtu, është rishikuar pagesa mujore për mbulimin e paketës higjieno-sanitare, duke u rritur me 4,000 lekë dhe duke u indeksuar çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit. Megjithatë, ende nuk është realizuar një analizë e plotë për përshtatjen e kësaj pakete sipas nevojave individuale. Nëpërmjet Fondit Social janë ngritur 39 shërbime të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, nga të cilat përfitojnë rreth 11,000 persona. Këto përfshijnë 18 shërbime lëvizëse me ekipe shumëdisiplinore, që ofrojnë kujdes në familje, 20 qendra ditore rehabilituese dhe një shërbim të specializuar për mjete ndihmëse, që ofron karrige me rrota dhe pajisje mbështetëse çdo vit, nga ku mbi 650 persona përfitojnë karrige me rrota të përshtatura sipas nevojave individuale. Shërbimet lëvizëse kanë rezultuar ndër më efektivet për të arritur përfituesit në komunitet. Megjithatë, shërbimet mbeten të pabarabarta dhe të fragmentuara. Personat mbi 16 vjeç kanë më pak akses në kujdes social dhe të rriturit përbëjnë rreth një të tretën e përfituesve. Ndërkohë, ende nuk ekziston një cikël i plotë i gjurmimit të shërbimit. Sistemi i të dhënave nuk mundëson të dihet, nëse personat e referuar nga komisionet e vlerësimit e marrin realisht shërbimin. Edhe pse ekziston regjistri elektronik i aftësisë së kufizuar dhe realizohet referimi drejt shërbimeve, mungon monitorimi i impaktit në jetën e përfituesit.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është avancimi i deinstitutionalizimit. Numri i personave me aftësi të kufizuara, që jetojnë në institucione rezidenciale u ul në 207 në vitin 2024 dhe 213 në vitin 2025, nga 263 në vitin 2023. Janë hartuar plane individuale mbështetjeje dhe janë zhvilluar modele të reja të jetesës së pavarur, përfshirë shërbimet komunitare dhe përfshirjen në familje kujdestare. Miratimi i ligjit për kujdesin alternativ në familje 92/2025 përforcon këtë drejtim.

Politikat e strehimit social janë zgjeruar për të garantuar akses dhe përfshirje të personave me aftësi të kufizuara. Rreth 18% e përfituesve të programeve të strehimit social janë persona me aftësi të kufizuara dhe subvencioni i qirasë është forma më e përdorur e mbështetjes. Ndryshimet ligjore parashikojnë edhe banesa të përshtatura dhe prioritet në aplikim për familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara.

Disa sfida me karakter strukturor mbeten për t'u adresuar më tej. Ndërkohë që janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e koordinimit dhe planifikimit të shërbimeve, përfshirë hartën kombëtare të shërbimeve sociale që përditësohet periodikisht, mekanizmin e financimit përmes Fondit Social dhe analizat e nevojave të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të planeve sociale vendore, ende nevojitet forcimi i mëtejshëm i një sistemi të integruar monitorimi

që të lidhë procesin e vlerësimit të nevojave me aksesin efektiv në shërbime dhe me ndikimin e tyre në cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Kapacitetet e bashkive, veçanërisht në zonat rurale duhet të fuqizohen, ndërsa po ndërmerren masa për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve përmes forcimit të mekanizmave të financimit, përfshirë edhe krijimin e Fondit Social Vendor. Gjithashtu, kuadri i shërbimeve për jetesë të pavarur kërkon zhvillim të mëtejshëm, veçanërisht përmes avancimit të skemës së asistentit personal, mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur dhe shërbimeve të strukturuar të mbështetjes për familjen.

Në tërësi, periudha 2021-2025 tregon një transformim gradual të sistemit nga një model i bazuar kryesisht në pagesa financiare drejt një modeli që ndërthur përfitimet në para me shërbimet sociale komunitare. Megjithatë, sistemi ende nuk garanton mbështetje të integruar dhe të personalizuar për çdo individ. Për këtë arsye, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, do të përqendrohet në ndërtimin e një sistemi të plotë të jetesës së pavarur. Ai do të mundësojë lidhjen funksionale ndërmjet vlerësimit bio-psiko-social dhe përfitimit real të shërbimeve, krijimin e shërbimeve të reja si ndihmësi personal dhe kujdesi në banesë, zgjerimin e strehimit të përshtatur, garantimin e mjeteve ndihmëse sipas nevojës individuale nëpërmjet sistemit shëndetësor, forcimin e kapaciteteve të bashkive dhe sigurimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve.

3.6. Analizë e gjendjes aktuale në fushën e shëndetësisë

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, në fushën e politikave shëndetësore, u përcaktua si qëllim strategjik sigurimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm dhe të përbalueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet lehtësimit të përdorimit të shërbimeve shëndetësore dhe zhvillimit të shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit.

Monitorimi i periudhës 2021-2025 tregon se sektori i shëndetësisë ka shënuar progres të qëndrueshëm në zgjerimin e shërbimeve dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale, megjithatë një pjesë e rëndësishme e ndërhyrjeve mbetet e pjesshme ose ende në proces zhvillimi.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme është integrimi gradual i kujdesit shëndetësor me atë social në nivel komuniteti. Që nga viti 2023 janë ngritur dhe funksionojnë 103 qendra socio-shëndetësore, ku ekipit tradicional të mjekëve të familjes i janë shtuar profesionistë psiko-socialë si psikologë, punonjës socialë, të cilët ofrojnë shërbime edhe për personat me aftësi të kufizuara. Këto ekipe ndërdisiplinore kanë vijuar funksionimin gjatë viteve 2024-2025 dhe kanë kontribuar në rritjen e aksesit në shërbime, veçanërisht për grupet vulnerabël. Gjithashtu, janë vendosur pika kontakti pranë operatorëve përkatës për koordinimin e çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuara.

Në të njëjtën kohë është zgjeruar kujdesi shëndetësor në banesë, i cili mbulon 325 qendra shëndetësore në nivel kombëtar dhe shoqërohet me trajnimin e 3,142 profesionistëve shëndetësorë për menaxhimin e sëmundjeve kronike dhe të problemeve të shëndetit mendor. Ky shërbim përbën

një nga arritjet më të rëndësishme praktike, pasi lehtëson aksesin në kujdes për personat me kufizime në lëvizje ose me nevoja të vazhdueshme trajtimi.

Përmirësim është vërejtur edhe në fushën e shëndetit mendor. Janë realizuar 43 seanca fuqizimi kapacitetesh për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme të problemeve të shëndetit mendor, me 437 pjesëmarrës, si dhe aktivitete informuese ndërsektorale me rreth 500 profesionistë. Në vijim të reformës në shërbimet e kujdesit parësor është zbatuar udhëzimi për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor, i orientuar drejt qasjes komunitare dhe garantimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të deinstitutionalizimit ka filluar procesi i vlerësimit socio-shëndetësor dhe i riintegritit në komunitet për personat me aftësi të kufizuara intelektuale rezidentë në spitalet psikiatrike, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Paralelisht është ngritur grupi i punës për hartimin e standardeve të cilësisë për shërbimet e specializuara të shëndetit mendor dhe për shtëpitë e mbështetura.

Megjithëse 171 persona pajisen me mjete të tjera ndihmëse lëvizëse krahas karrigeve me rrota, ende nuk ka një sistem të qartë për mjetet ndihmëse sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Përfituesit e kujdesit shëndetësor në banesë janë mbështetur gjithashtu me pajisje ndihmëse sipas vlerësimit funksional. Paralelisht, është zgjeruar infrastruktura e shërbimit stomatologjik përmes hapjes së kabineteve të reja dentare pranë shkollave dhe forcimit të strukturave ekzistuese.

Megjithatë, progresi i arritur shoqërohet me një sërë boshllëqesh strukturore. Shumë masa të lehtësimit të vizitave mjekësore zbatohen në praktikë, por nuk janë të formalizuara në protokolle zyrtare, duke krijuar pabarazi në akses sipas institucioneve. Nuk ekziston ende një udhëzim i detyrueshëm për mënyrën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara dhe ofrimi i interpretimit në gjuhën e shenjave gjatë vizitave mbetet i kufizuar. Gjithashtu, aktivitetet informuese për komunitetin e personave që nuk dëgjojnë kanë qenë relativisht të ulëta.

Mbështetja me mjete ndihmëse mbetet e pjesshme: financimi shtetëror mbulon kryesisht karriget me rrota, ndërsa për proteza dhe mjete e teknologji të tjera ndihmëse nuk ekziston një planifikim i plotë sipas nevojave individuale. Nuk është kryer ende një analizë kombëtare e nevojave për këto pajisje dhe as identifikimi i prodhuesve potencialë në treg. Njëkohësisht, shërbimet e rehabilitimit mjekësor janë të kufizuara dhe ende në zhvillim, megjithëse janë ngritur disa njësi fizioterapie në sistemin parësor dhe spitalor.

Në tërësi, periudha 2021-2025 tregon një kalim gradual nga një model i kujdesit shëndetësor të fokusuar në trajtimin spitalor, drejt një modeli komunitar dhe të integruar me shërbimet sociale. Megjithatë, sistemi ende nuk garanton akses të barabartë dhe të standardizuar për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, PKVPAK 2026-2030 do të përqendrohet në formalizimin dhe standardizimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë miratimin e protokolleve të detyrueshme për aksesin në shërbime, zgjerimin e shërbimeve të shëndetit mendor për të rriturit, planifikimin e mbulimit financiar të mjeteve ndihmëse sipas nevojave individuale dhe zgjerimin e shërbimeve të

rehabilitimit. Gjithashtu, do të forcohet koordinimi ndërinstytucional me shërbimet sociale dhe pushtetin vendor, në mënyrë që kujdesi shëndetësor të mos kufizohet vetëm në trajtim mjekësor, por të mbështesë jetesën e pavarur dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara.

3.7 Analizë e gjendjes aktuale në fushën e pjesëmarrjes

3.7.1 Pjesëmarrja në jetën politike

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2021-2025 janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të garantuar ushtrimin e së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara. Procesi zgjedhor i vitit 2025 përfaqëson për herë të parë një përpjekje më të strukturuar institucionale për të adresuar aksesin në votim. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hartoi një program të veçantë për edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara, i cili synoi informimin dhe krijimin e kushteve reale për ushtrimin e të drejtës së votës.

Fushata informuese u përshtat në gjuhën e shenjave, u prodhuan materiale audiovizive të aksesueshme, 5,500 postera sensibilizues u vendosën në qendrat e votimit dhe u zhvilluan takime informuese në të gjithë vendin.

Një arritje e rëndësishme ishte përdorimi i fletës së votimit në alfabetin Braille, që mundësoi votim të pavarur për personat që nuk shohin. Po ashtu, faqja zyrtare e KQZ u bë e aksesueshme dhe administrata zgjedhore u trajnuar për të adresuar nevojat specifike të votuesve me aftësi të kufizuara. Janë ndërmarrë masa për zhvendosjen e qendrave të votimit në kate përdhese kur ishte e nevojshme dhe janë përdorur të dhënat për planifikimin paraprak të aksesueshmërisë.

Megjithatë, progresi i arritur ka qenë kryesisht në nivel zbatimi praktik, ndërsa dimensionin sistematik mbetet i paadresuar plotësisht. Kodi Zgjedhor nuk parashikon ende në mënyrë të qartë forma alternative votimi, si votimi nga banesa, me postë apo në mënyrë elektronike, për personat që nuk mund të paraqiten fizikisht në qendrën e votimit. Një pjesë e konsiderueshme e qendrave të votimit vijojnë të jenë fizikisht të paarrtshme, ndërsa mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi aksesueshmërinë nuk realizohet sipas një standardi të unifikuar ndërinstytucional. Gjithashtu, nuk është evidentuar përparim në drejtim të rritjes së përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara në këshillat bashkiakë përmes mekanizmave të kuotave.

Në thelb, periudha 2021-2025 ka përmirësuar aksesin në informacion dhe ndërgjegjësim për votimin, por nuk ka garantuar ende akses universal në ushtrimin e kësaj të drejte politike.

PKVPAK2026-2030 do të kalojë nga masa lehtësuese drejt garantimit ligjor të së drejtës së votës. Ai duhet të përfshijë ndryshime në Kodin Zgjedhor për forma alternative votimi, standarde të detyrueshme për aksesueshmërinë e qendrave të votimit, sistem kombëtar raportimi për aksesueshmërinë, trajnime të detyrueshme për administratën zgjedhore dhe mekanizma për përfaqësim real politik, përfshirë nxitjen e kandidimit dhe pjesëmarrjes në organet vendimmarrëse.

3.7.2 Pjesëmarrja në jetën artistike dhe kulturore

Në fushën e kulturës, periudha 2021-2025 shënon një rritje të ndërgjegjësimin institucionale dhe mbështetjes financiare për aktivitetet kulturore që përfshijnë personat me aftësi të kufizuara.

Ndryshimet në Ligjin për të Drejtën e Autorit përafuan legjislacionin me standardet e Bashkimit Evropian dhe krijuan mundësi për publikimin e librave dhe materialeve në formate të aksesueshme për personat e verbër.

Institucionet kulturore organizuan aktivitete gjithëpërfshirëse dhe programe edukimi përmes artit. Në periudhën 2024-2025, në institucionet kulturore kombëtare morën pjesë 51 persona me aftësi të kufizuara në programe edukimi dhe 697 si vizitorë.

U financuan projekte artistike të dedikuara dhe aktivitetet në muze, teatro dhe institucione kulturore u ofruan falas për fëmijët me aftësi të kufizuara Megjithatë, pjesëmarrja mbetet e ulët dhe shpesh e varur nga projekte të përkohshme. Nuk ekziston një program i qëndrueshëm kombëtar për kulturën gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimi institucional me organizatat e personave me aftësi të kufizuara mbetet sporadik. Sistemi statistikor kulturor nuk gjeneron të dhëna të rregullta për pjesëmarrjen dhe aksesueshmëria fizike dhe në informacion në institucionet kulturore mbetet e pjesshme.

PKVPAK2026-2030 synon të institucionalizojë kulturën gjithëpërfshirëse. Ai do të përfshijë standarde të detyrueshme aksesueshmërie për institucionet kulturore, financim të dedikuar për krijimtarinë artistike të personave me aftësi të kufizuara, programe të edukimit kulturor, akses në libra dhe informacion në formate të aksesueshme dhe një sistem të rregullt monitorimi statistikor të pjesëmarrjes kulturore.

3.7.3 Pjesëmarrja në sporte dhe aktivitete rekreative

Në fushën e sportit, arritja më e rëndësishme e periudhës 2021-2025 është ndryshimi i ligjit “Për sportin”, i cili njohu për herë të parë Komitetin Paraolimpik Shqiptar dhe Lëvizjen Speciale Olimpike si struktura të pavarura dhe me financim shtetëror. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të sportit për personat me aftësi të kufizuara dhe drejt përfaqësimit ndërkombëtar.

Gjatë periudhës së monitorimit, janë zhvilluar disa aktivitete sportive dhe projekte promovuese me pjesëmarrjen e sportistëve me aftësi të kufizuara, përfshirë iniciativa rajonale dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Megjithatë, pjesëmarrja mbetet e kufizuar në numër dhe e varur nga projekte të veçuara. Problemi kryesor mbetet infrastruktura. Nuk ka terrene sportive të dedikuara apo të aksesueshme falas për stërvitje dhe shumica e ambienteve sportive nuk plotësojnë standardet e aksesueshmërisë. Nuk ka pasur përfaqësim të personave me aftësi të kufizuara në organet drejtuese sportive dhe as mbështetje për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.

Plani i ri do të kalojë nga njohja ligjore drejt zhvillimit real të sportit paraolimpik. Ai duhet të përfshijë financim të qëndrueshëm për sportin dhe personat me aftësi të kufizuara, standarde të detyrueshme aksesueshmërie për të gjitha terrenet sportive, programe sportive në shkolla dhe komunitet, mbështetje për pjesëmarrjen ndërkombëtare dhe përfaqësim në strukturat drejtuese sportive.

3.8 Analizë e gjendjes aktuale në fushën e bashkëpunimit

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 janë bërë përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstytucional, veçanërisht ndërmjet institucioneve qendrore dhe bashkive. MSHMS ka organizuar takime periodike me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me ministrinë e linjës, si dhe ka përfshirë çështjet e aftësisë së kufizuar në mekanizma konsultativë ndërinstytucionalë dhe platforma dialogu. Në vitin 2025, u publikua udhërrëfyesi për njësitë vendore për shërbimet sociale, i cili orienton bashkitë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ndryshimet në legjislacionin e mbrojtjes sociale kanë përcaktuar më qartë ndërveprimin mes strukturave vendore dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Megjithatë, përfshirja e bashkive në zbatimin e politikave për aftësinë e kufizuar varet ende nga kapacitetet dhe prioritetet lokale. Shumë bashki kanë nevojë për mbështetje metodologjike të vazhdueshme, veçanërisht në vlerësimin e nevojave, planifikimin e buxhetit dhe investimet për realizimin e aksesueshmërisë. Duhet theksuar se mungon një udhëzim i detyrueshëm për përfshirjen sistematike të organizatave të personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje.

3.8.1 Përmirësimi i funksionimit të mekanizmit kombëtar të koordinimit të politikave

Gjatë periudhës 2021-2025 është përmirësuar koordinimi horizontal ndërmjet institucioneve qendrore përmes funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK), i cili shërben si platformë dialogu ndërmjet institucioneve dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara. Janë zhvilluar katër mbledhje të Këshillit dhe monitorimi i Planit është kryer në bashkëpunim me ministrinë e linjës. Po ashtu, janë realizuar raportimet periodike për zbatimin e Konventës së OKB-së dhe është kryer analiza e legjislacionit për përfrimin me Aktin Evropian të Aksesueshmërisë.

Megjithatë, koordinimi funksionon më mirë në nivel qendror sesa në atë vendor dhe kapacitetet administrative për koordinimin e politikave mbeten të kufizuara. Numri i stafit përgjegjës për koordinimin e politikave për aftësinë e kufizuar është i pamjaftueshëm për të përmbushur këtë rol në mënyrë efektive. Për pasojë, shumë politika mbeten sektoriale dhe jo të integruara.

PKVPAK 2026-2030 do të forcojë mekanizmin kombëtar të koordinimit, duke rritur kapacitetet institucionale, duke fuqizuar rrjetin e pikave fokale për aftësinë e kufizuar në çdo institucion dhe duke vendosur detyrime raportimi periodik.

3.8.2 Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm për aftësinë e kufizuar

Në periudhën 2021-2025 janë bërë disa hapa drejt përmirësimit të të dhënave, veçanërisht përmes përfshirjes së pyetjeve të Grupit të Uashingtonit në Censusin e Popullsisë 2023, i cili për herë të parë prodhoi të dhëna të detajuara për aftësinë e kufizuar në Shqipëri.

INSTAT publikon çdo vit të dhëna administrative mbi përfituesit dhe kategoritë e aftësisë së kufizuar. Megjithatë, kuadri statistikor paraqet ende fragmentarizim dhe mungesë koordinimi. Raportimi institucional i të dhënave nuk është zbatuar plotësisht dhe mungon një sistem kombëtar i integruar për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit në të gjitha fushat përkatëse. Të dhënat

ekzistuese janë të kufizuara dhe të pa disagreguara sipas standardeve ndërkombëtare. Të dhënat janë të përqendruara kryesisht në mbrojtjen sociale, ndërkohë që në sektorë të tjerë informacioni është minimal ose mungon. Kjo situatë e vështirëson vlerësimin objektiv të progresit të politikave publike. Në këtë kuadër, Plani i ri parashikon ngritjen e një sistemi të detyrueshëm kombëtar raportimi, rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e statistikave dhe zhvillimin e indikatorëve të standardizuar të monitorimit në të gjithë sektorët.

3.8.3 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Gjatë periudhës 2021-2025 Shqipëria ka marrë pjesë në procese rajonale dhe ndërkombëtare për zbatimin e Konventës së OKB-së, ka shkëmbyer praktika me organizata ndërkombëtare. Janë organizuar aktivitete kombëtare, përfshirë konferencën e parë për pajisjet ndihmëse dhe pjesëmarrje në raportimet pranë institucioneve evropiane. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal mbetet sporadik dhe nuk ka qenë i strukturuar në programe të rregullta shkëmbimi eksperiencash ose projekte të përbashkëta.

Në tërësi, periudha 2021-2025 ka vendosur bazat e koordinimit institucional, por sistemi mbetet ende i fragmentuar dhe i varur nga iniciativa individuale të institucioneve. Sfida kryesore për Planin është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm qeverisës për politikën e aftësisë së kufizuar, të dhëna të matshme dhe përgjegjësi të qarta institucionale.

3.9 Perceptimi i grupeve të interesit

Procesi i monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara 2021-2025 u shoqërua me konsultime dhe fokus-grupe me persona me aftësi të kufizuara, prindër dhe organizata përfaqësuese në disa qarqe të vendit, të cilat ofruan një pasqyrë të drejtpërdrejtë mbi ndikimin e politikave në jetën e përditshme.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit vlerësuan se gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë hapa pozitivë, veçanërisht në zgjerimin e disa shërbimeve sociale, informimin për ndihmën juridike falas dhe përmirësime të pjesshme të aksesueshmërisë në disa institucione publike. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm mbetet se ndërhyrjet janë të fragmentuara dhe jo gjithmonë krijojnë një zinxhir të plotë shërbimesh që garantojnë jetesë të pavarur dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri. Grupet e interesit theksuan veçanërisht vështirësitë në aksesin praktik në shërbime, pabarazitë territoriale, mungesën e informacionit të aksesueshëm dhe zbatimin jo të njëtrajtshëm të legjislacionit. Për këtë arsye, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të kufizuara 2026-2030 duhet të mbështetet më fort në konsultimin e vazhdueshëm me organizatat përfaqësuese, të forcojë mekanizmat e dialogut institucional dhe të parashikojë monitorim të rregullt të politikave bazuar në përvojën reale të përfituesve, me qëllim kalimin nga masa të pjesshme në politika të qëndrueshme dhe të zbatueshme në praktikë.

4. QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PKVPAK 2026-2030

Vizioni: *Një Shqipëri gjithëpërfshirëse dhe e aksesueshme, ku personat me aftësi të kufizuara jetojnë të pavarur, ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në çdo aspekt të jetës shoqërore dhe ekonomike.*

Misioni: Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të integruara, të bazuara në të drejtat e njeriut, për të garantuar përfshirjen reale, autonominë, mirëqenien dhe barazinë e personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

4.1 Aksesueshmëria

4.1.1 Konteksti strategjik

Fusha e aksesueshmërisë në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 mbështetet në një kuadër të konsoliduar dokumentesh ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare, të cilat përcaktojnë standardet, parimet dhe drejtimin politik për garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Për këtë arsye, planifikimi në këtë fushë nuk paraqet një ndërhyrje të veçuar, por një vijimësi të angazhimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në nivel ndërkombëtar dhe në procesin e integrimit evropian.

Në nivel ndërkombëtar, referenca themelore është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK).²² Konventa e trajton aksesueshmërinë si një nga kushtet bazë për ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe për një jetesë të pavarur, duke kërkuar nga shtetet të sigurojnë akses në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikim, si dhe në shërbime të hapura për publikun, në baza të barabarta.

Në nivel evropian, politikat e Bashkimit Evropian e zhvillojnë më tej këtë qasje. Strategjia e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030²³, e konsideron aksesueshmërinë një prioritet ndërsektorial dhe kërkon integrimin e saj në të gjitha politikat publike, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të përdorin shërbimet publike në kushte të barabarta. Kjo qasje konkretizohet në instrumente ligjore të posaçme të Bashkimit Evropian, si Direktiva (BE) 2019/882²⁴, e cila vendos kërkesa të përbashkëta të aksesueshmërisë për produkte dhe shërbime, si dhe Direktiva (BE) 2016/2102²⁵ për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve mobile të institucioneve publike. Këto standarde përbëjnë bazën e aksesueshmërisë në tregun e brendshëm evropian dhe në ofrimin e shërbimeve publike digjitale.

Në nivel kombëtar, kuadri i aksesueshmërisë mbështetet në dokumentet strategjike²⁶ të politikave sociale dhe të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilat e konsiderojnë aksesueshmërinë kusht për ushtrimin e të drejtave në arsim, punësim, shërbime publike dhe jetesë të pavarur. Dokumentet sektoriale të zhvillimit, përfshirë ato në fushën e shërbimeve dhe

²² Ligji nr. 108/2012 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”

²³ EU Disability Strategy 2021-2030

²⁴ Directive (EU) 2019/882 of the European Parliament and of the Council on accessibility requirements for products and services. Ligji nr. 93/2014, datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Direktiva (BE) 2016/2102 për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve mobile të institucioneve publike.

²⁶ Strategjia e Mbrojtjes Sociale/Strategjia e Punësimit, Strategjia e Arsimit

turizmit²⁷, theksojnë nevojën për standarde gjithëpërfshirëse dhe përdorim të barabartë të hapësirave dhe shërbimeve publike.

Në tërësi, ky kuadër politikash e vendos aksesueshmërinë si detyrim ligjor, social dhe zhvillimor, të lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirjen sociale dhe procesin e integritimit evropian.

4.1.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i Politikës 1: Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.

Plani i Veprimit për Aksesueshmërinë 2026-2030, ka për qëllim realizimin gradual dhe të qëndrueshëm të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në mjedise, shërbime, transport dhe informacion.

Aksesueshmëria konsiderohet një parakusht për përfshirje sociale, pavarësi dhe pjesëmarrje të plotë në të gjitha fushat e jetës.

Plani strukturohet mbi katër objektiva specifike që mbulojnë dimensionet kryesore të aksesueshmërisë: (i) mjedisin e ndërtuar, infrastrukturën dhe shërbimet; (ii) transportin dhe lëvizshmërinë; (iii) informacionin, komunikimin dhe mediet; (iv) turizmin dhe trashëgiminë kulturore.

Për realizimin e këtyre objektivave janë parashikuar gjashtë masa prioritare, të shoqëruara me 31 ndërhyrje konkrete, të cilat synojnë eliminimin e barrierave ekzistuese dhe parandalimin e krijimit të barrierave të reja.

Objektivi Specifik 1: Realizimi i aksesueshmërisë në mjedisin e ndërtuar, infrastrukturën dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara.

Masa Prioritare

1.1 Rishikimi i bazës ligjore për aksesueshmërinë dhe fuqizimi i monitorimit të zbatimit të saj. Ngritja dhe funksionimi i strukturës monitoruese/autoritetit, në varësi të Këshillit të Ministrave, për monitorim në nivel kombëtar.

1.2 Vlerësimi i nivelit të aksesueshmërisë së aseteve publike (ndërtesa dhe infrastrukturë), përgatitja e një plani veprimi të strukturuar me masa prioritare për garantimin e standardeve të aksesueshmërisë dhe ngritja e një regjistri përkatës për ndjekjen dhe raportimin e progresit.

Objektivi i parë i fushës së aksesueshmërisë synon të sigurojë që mjedisi i ndërtuar të jetë i përdorshëm dhe i arritshëm për personat me aftësi të kufizuara, si një parakusht për integrimin e tyre dhe për pjesëmarrje të barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Qasja e këtij objektivi nuk kufizohet vetëm në përshtatjen e ndërtesave, por përfshin në mënyrë të integruar

²⁷ Ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

infrastrukturën, produktet dhe shërbimet e ofruara për publikun, duke synuar njëkohësisht eliminimin e barrierave ekzistuese dhe parandalimin e krijimit të barrierave të reja.

Në thelb të këtij objekti qëndron forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon aksesueshmërinë. Parashikohet rishikimi i legjislacionit përkatës përmes miratimit të Ligjit të rishikuar “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe harmonizimi i tij me standardet evropiane për produktet dhe shërbimet. Ky proces shoqërohet me rishikimin e akteve ekzistuese nënligjore dhe plotësimin e tyre me instrumente të reja zbatimi, në mënyrë që kërkesat për aksesueshmëri të jenë të qarta, të detyrueshme dhe të zbatueshme në praktikë. Përveç përmirësimit të kuadrit normativ, parashikohet edhe informimi publik mbi ndryshimet ligjore dhe të drejtat që burojnë prej tyre, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve, profesionistëve dhe qytetarëve.

Një element qendror i këtij objekti është ngritja dhe funksionimi i një strukture monitoruese në nivel kombëtar, pranë Këshillit të Ministrave, e cila do të mbikëqyrë zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në mjedise, shërbime dhe produkte. Kjo strukturë do të ketë rol koordinues dhe kontrollues, duke përcaktuar standardet, duke ndjekur zbatimin e tyre dhe duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse. Për të garantuar funksionimin efektiv të sistemit, parashikohet edhe caktimi i nëpunësve përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar në institucionet qendrore dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke krijuar një rrjet institucional që siguron integrimin e aksesueshmërisë në proceset e përditshme administrative.

Objekti parashikon edhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale. Do të organizohen programe trajnimi për stafet e institucioneve publike, për strukturat e monitorimit, për profesionistët e projektimit dhe ndërtimit, për operatorët ekonomikë dhe për institucionet arsimore. Trajnimet synojnë jo vetëm njohjen e standardeve teknike të aksesueshmërisë, por edhe përmirësimin e komunikimit dhe të sjelljes profesionale ndaj personave me aftësi të kufizuara. Paralelisht, do të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, me qëllim njohjen e të drejtave dhe mundësive që ofron legjislacioni në këtë fushë.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është vlerësimi sistematik i nivelit të aksesueshmërisë së aseteve publike. Institucionet do të kryejnë vlerësime teknike të ndërtesave dhe infrastrukturës në përdorim, duke identifikuar pengesat ekzistuese dhe duke përcaktuar prioritetet e ndërhyrjes. Rezultatet do të regjistrohen në një regjistër të posaçëm të aksesueshmërisë dhe do të shoqërohen me planifikim financiar vjetor për eliminimin e barrierave. Në këtë kuadër, do të hartohet çdo vit një raport kombëtar mbi realizimin e aksesueshmërisë, i cili do të shërbejë si instrument monitorimi, planifikimi dhe transparence, si dhe do të organizohet një konferencë kombëtare vjetore për prezantimin e progresit dhe përcaktimin e prioritetëve të mëtejshme.

Përveç planifikimit dhe vlerësimit, objekti përfshin monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të standardeve. Parashikohet forcimi i mekanizmave të kontrollit për projektet e reja të ndërtimit dhe për investimet publike, në mënyrë që kërkesat e aksesueshmërisë të respektohen që në fazën e projektimit dhe të mos trajtohen vetëm si masa korrigjuese pas ndërtimit. Kontrollat do të shoqërohen me përgjegjësi administrative dhe masa ndëshkuese në rast moszbatimi, ndërsa

monitorimet do të shtrihen edhe mbi ndërtesat e sektorëve të arsimit, shëndetësisë, kujdesit social, drejtësisë dhe tregut të punës. Krahas kësaj, do të promovohen praktikat e mira përmes fushatave të komunikimit publik dhe shkëmbimit të përvojave pozitive.

Objektivi i parë, synon të vendosë një sistem funksional të aksesueshmërisë që fillon nga legjislati dhe standardet, vijon me planifikimin dhe financimin e ndërhyrjeve dhe përfundon me monitorimin dhe ndërgjegjësimin shoqëror. Në këtë mënyrë, aksesueshmëria bëhet pjesë e detyrueshme e projektimit, ndërtimit dhe ofrimit të çdo shërbimi publik, duke kaluar nga një qasje korrigjuese në një qasje parandaluese dhe të integruar në politikat publike.

Objektivi Specifik 2: Realizimi i aksesueshmërisë në transportin dhe lëvizshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.

Masa prioritare

2.1 Të aplikohen standardet e BE-së dhe të përafrohet kuadri ligjor për të mundësuar realizimin e të drejtave të pasagjerëve me aftësi të kufizuara në udhëtimet me autobusë (brenda qyteteve dhe ndërqytete) dhe të gjitha mjetet e tjera të transportit hekurudhor, ujor dhe ajror. Përmirësimi i qëndrimeve dhe sjelljeve ndaj udhëtarëve me aftësi të kufizuara.

Objektivi i dytë synon të rrisë nivelin e aksesueshmërisë në transportin publik, duke përfshirë mjetet e transportit dhe shërbimet për udhëtarët me aftësi të kufizuara, si dhe duke mundësuar udhëtimin falas për ta. Ky objektivi bazohet në parimin se lëvizshmëria është thelbësore për pjesëmarrjen në arsim, punësim, shërbime publike dhe jetën sociale, dhe se mungesa e transportit të aksesueshëm është një pengesë kryesore për përfshirjen shoqërore.

Në këtë kuadër, parashikohet përafrimi i kuadrit ligjor dhe praktikave me standardet e Bashkimit Evropian²⁸ për të drejtat e pasagjerëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mënyrat e transportit, përfshirë atë rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror. Synimi është që personat me aftësi të kufizuara të kenë të drejtë dhe mundësi reale për të përdorur shërbimet e transportit në mënyrë të pavarur dhe të sigurt, në kushte të barabarta me qytetarët e tjerë.

Një nga drejtimet kryesore të këtij objektivi, është përmirësimi i aksesueshmërisë fizike të mjeteve dhe infrastrukturës së transportit. Parashikohet rritja graduale e numrit të autobusëve të përshtatur me platforma dhe pajisje ndihmëse për përdoruesit e karrigeve me rrota, si dhe përmbushja e standardeve të aksesueshmërisë në terminalët e autobusëve, stacionet hekurudhore, portet dhe aeroportet. Krahas përshtatjeve fizike, transporti publik do të pajiset edhe me sisteme informacioni audio-vizuale për orientimin e pasagjerëve, duke përmirësuar aksesin për personat me dëmtime në shikim dhe dëgjim.

Plani parashikon gjithashtu ofrimin e shërbimeve mbështetëse, duke përfshirë transportin “derë më derë” për personat me aftësi të kufizuara që kanë kufizime të rënda lëvizjeje. Në të njëjtën kohë

²⁸ European Union standards on the rights of passengers with disabilities

do të forcohet monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor nga operatorët e transportit përmes strukturave inspektuese dhe task-forcave të dedikuara në nivel qendror dhe vendor.

Një komponent i rëndësishëm i objektivit është përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe i komunikimit me udhëtarët me aftësi të kufizuara. Do të organizohen trajnime për stafin e transportit publik, përfshirë drejtuesit e mjeteve dhe personelin e shërbimit, për mënyrën e trajtimit dhe komunikimit të duhur me këtë kategori udhëtarësh. Gjithashtu, parashikohet hartimi i një kodi etike për ndërveprimin me pasagjerët me aftësi të kufizuara, si dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe materialeve informuese për të drejtat në transport dhe mënyrat e përdorimit të shërbimeve të aksesueshme.

Objektivi përfshin edhe masat për sigurimin e transportit falas për personat me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, do të rishikohet legjislacioni për rimbursimin e shërbimeve të transportit dhe do të krijohen mekanizma financimi që mbulojnë kategoritë përfituese, përfshirë edhe kujdestarët kur është e nevojshme. Parashikohet , krijimi i kartës së posaçme të aftësisë së kufizuar për transportin, e cila do të shërbejë si mjet identifikimi dhe përfitimi nga shërbimet e subvencionuara, si dhe përshtatja e sistemeve për bileta elektronike për të garantuar aksesueshmërinë e tyre.

Objektivi i dytë synon të kalojë nga një sistem transporti që ofron shërbime të përgjithshme, por jo gjithmonë të përdorshme për të gjithë, drejt një sistemi transporti gjithëpërfshirës. Ai kombinon përshtatjet infrastrukturore, përmirësimin e shërbimit, mbështetjen financiare dhe rritjen e ndërgjegjësimin, me qëllim që transporti të mos përbëjë më pengesë për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Objektivi Specifik 3. Realizimi i aksesueshmërisë në informacion, komunikim dhe mediat për personat me aftësi të kufizuara.

Masa Prioritare

3.1 Përmirësime ligjore dhe përshtatja e standardeve ndërkombëtare të sigurimit të aksesueshmërisë në TIK. Strukturat për monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të kuadrit ligjor.

3.2 Sigurimi i produkteve dhe shërbimeve të aksesueshme për informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi i tretë synon të sigurojë akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në informacion, komunikim dhe media për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në çdo shërbim dhe platformë të ofruar për publikun, duke përfshirë sportelet fizike, portalet dhe faqet e internetit, pajisjet dhe shërbimet celulare, transmetimet televizive, publikimet, si edhe takimet dhe aktivitetet publike. Ky objektivi, mbështetet në parimin se qasja në informacion dhe komunikim është kusht thelbësor për ushtrimin e të drejtave, për pjesëmarrjen qytetare dhe për përdorimin efektiv të shërbimeve publike në kushte të barabarta me të tjerët.

Një drejtim i parë i rëndësishëm është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi i tij me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Parashikohet rishikimi i legjislacionit që rregullon ofrimin e shërbimeve publike në sportel dhe i

akteve nënligjore përkatëse, me qëllim përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet evropiane për faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të institucioneve publike. Në këtë kuadër do të përshtaten standarde ndërkombëtare për aksesueshmërinë në portalet²⁹ qeveritare, në komunikimin institucional, në publikime dhe në organizimin e aktiviteteve publike. Gjithashtu, do të vendosen standarde që sigurojnë bashkërendimin e shërbimeve televizive me pajisjet teknologjike që mundësojnë përdorimin e tyre nga personat me aftësi të kufizuara.

Në praktikë, kjo do të përfshijë zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në portalin e-Albania dhe në të gjitha platformat e tjera ndërvepruese me publikun, si dhe zhvillimin e programeve teknologjike mbështetëse, përfshirë aplikacione për leximin e tekstit (text-to-speech) për personat me dëmtime në shikim. Paralelisht, do të rishikohen dhe forcohen strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë në informacion dhe komunikim, me qëllim garantimin e respektimit të standardeve në mënyrë të vazhdueshme.

Objekti përfshin edhe rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale. Do të organizohen trajnime për stafet e institucioneve publike mbi mënyrën e ofrimit të shërbimit ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe mbi përdorimin e informacionit të aksesueshëm në sportele dhe portale publike. Njëkohësisht, do të krijohen grupe trajnerësh të specializuar brenda institucioneve për të garantuar përhapjen e njohurive dhe praktikave të aksesueshmërisë. Personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre do të informohen dhe trajnohen për përdorimin e shërbimeve të aksesueshme dhe të teknologjive të komunikimit, përfshirë telefoninë e lëvizshme dhe platformat digjitale.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit do të shoqërohet me trajnime për personelin që ndërvepron drejtpërdrejt me qytetarët dhe me ndërgjegjësimin e ofruesve të mediave dhe komunikimeve elektronike. Institucionet arsimore të larta dhe ato të formimit profesional do të inkurajohen të zhvillojnë programe mësimore për aksesueshmërinë e faqeve të internetit, duke kontribuar në krijimin e kapaciteteve profesionale në këtë fushë. Po ashtu, do të zhvillohen fushata informimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në lidhje me transmetimet televizive të aksesueshme.

Një komponent tjetër thelbësor është sigurimi i produkteve dhe shërbimeve të aksesueshme në praktikë. Institucionet publike do të marrin masa që pajisjet dhe shërbimet e tyre të jenë të përdorueshme edhe nga persona me dëmtime në shikim, dëgjim, lëvizje apo me aftësi të kufizuara intelektuale, përmes përdorimit të ikonave universale, programeve të leximit të ekranit, pajisjeve audio, mundësisë për zmadhimin e tekstit dhe përdorimit të Braille. Informacioni zyrtar, përfshirë ligje, vendime, strategji dhe plane veprimi, do të ofrohet në formate alternative dhe të kuptueshme, ndërsa komunikimet publike dhe aktivitetet institucionale do të organizohen në mënyrë të aksesueshme për të gjithë.

²⁹ International standards for web accessibility / WCAG (Web Content Accessibility Guidelines)

Në fushën e medias do të sigurohet përdorimi i titrave, përshkrimeve audio dhe gjuhës së shenjave në programe të caktuara, si dhe monitorimi i zbatimit të këtyre kërkesave nga ofruesit e licencuar. Po ashtu, do të promovohet shkëmbimi i përvojave me vende të tjera për të përmirësuar praktikat e aksesueshmërisë.

Objektivi i tretë synon të garantojë që askush të mos përjashtohet nga informacioni, komunikimi dhe jeta publike për shkak të barrierave komunikative ose teknologjike. Ai e zhvendos fokusin nga thjesht disponueshmëria e informacionit drejt shfrytëzimit të tij në praktikë, duke e bërë aksesueshmërinë digjitale dhe mediatike pjesë integrale të ofrimit të shërbimeve publike dhe të komunikimit institucional.

Objektivi Specifik 4: Realizimi i aksesueshmërisë në objektet dhe shërbimet turistike dhe të trashëgimisë kulturore.

Masa Prioritare

4.1 Të realizohet aksesueshmëria fizike dhe e shërbimeve në objekte turistike dhe të trashëgimisë kulturore, në parqe kombëtare dhe plazhe, në ambientet sportive dhe shërbimet e guidave turistike.

Objektivi i katërt synon të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi reale për të përdorur dhe përfituar nga objektet dhe shërbimet turistike, si dhe pasuritë e trashëgimisë kulturore, në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë. Ky objektivi mbështetet në parimin se pjesëmarrja në jetën kulturore, rekreative dhe turistike është pjesë e mirëqenies sociale dhe e integritetit shoqëror dhe nuk duhet të kufizohet nga barrierat fizike, informuese apo organizative.

Një drejtim i parë i rëndësishëm është përfshirja e kërkesave të aksesueshmërisë në kuadrin rregullator të turizmit dhe trashëgimisë kulturore. Parashikohen ndryshime ligjore dhe nënligjore që standardet e aksesueshmërisë të bëhen pjesë e kritereve të vlerësimit për licencimin e strukturave akomoduese, të objekteve të turizmit kulturor dhe të shërbimeve përkatëse. Në këtë mënyrë, aksesueshmëria nuk konsiderohet më thjesht si një zgjedhje, por bëhet një kusht i domosdoshëm për funksionimin e strukturave turistike dhe për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut.

Për të siguruar zbatimin efektiv, do të realizohet një vlerësim sistematik i nivelit të aksesueshmërisë në objektet turistike dhe të trashëgimisë kulturore, i shoqëruar me rekomandime konkrete për përmirësime. Rezultatet e këtij procesi do të përfshihen në një regjistër të posaçëm të aksesueshmërisë, i cili do të shërbejë si instrument informimi dhe planifikimi për institucionet dhe operatorët. Në të njëjtën kohë, parashikohet përshtatja e mjediseve të hapura, si parqet natyrore, plazhet dhe hapësirat rekreative, sipas standardeve të aksesueshmërisë, me qëllim që përdorimi i tyre të jetë i mundur nga të gjithë.

Përveç infrastrukturës, objektivi adreson edhe përmbajtjen dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve turistike. Parashikohet përfshirja e standardeve të aksesueshmërisë në paketat turistike, duke përfshirë transport të përshtatur, guida audio, materiale informuese në Braille ose në gjuhë të thjeshtuar dhe interpretim në gjuhën e shenjave. Operatorët turistikë do të ndërgjegjësohen për

rëndësinë e turizmit gjithëpërfshirës dhe për nevojën e përshtatjes së shërbimeve për kategori të ndryshme përdoruesish.

Një element tjetër i rëndësishëm është sigurimi i informacionit të aksesueshëm për vizitorët. Faqet e internetit dhe aplikacionet turistike duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe informacioni për destinacionet, shërbimet dhe pikat turistike të ofrohet në mënyrë të përshtatshme dhe të kuptueshme. Do të përgatiten edhe broshura dhe materiale informuese të aksesueshme, në mënyrë që planifikimi dhe realizimi i vizitave turistike të jetë i mundur në mënyrë të pavarur.

Objektivi i katërt synon të zhvillojë një model turizmi gjithëpërfshirës, ku personat me aftësi të kufizuara të mos jenë vetëm përfitues pasivë, por pjesëmarrës aktivë në jetën kulturore dhe turistike. Duke kombinuar përshtatjen e infrastrukturës, përmirësimin e shërbimeve dhe ofrimin e informacionit të aksesueshëm, ky objektivi kontribuon jo vetëm në respektimin e të drejtave, por edhe në zhvillimin e një oferte turistike më të hapur, cilësore dhe të qëndrueshme për të gjithë.

4.2. Aksesimi në Drejtësi dhe Barazia para Ligjit

4.2.1. Konteksti strategjik

Fusha e drejtësisë në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, mbështetet në një kuadër të gjerë standardesh ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, instrumentesh evropiane dhe dokumentesh strategjike kombëtare. Qasja e këtij kapitulli bazohet në parimin se aksesimi i sistemit të drejtësisë nuk është vetëm një shërbim publik, por një e drejtë themelore, e lidhur drejtpërdrejt me barazinë para ligjit, me mbrojtjen nga diskriminimi dhe me garantimin e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuptim, ndërhyrjet në fushën e drejtësisë nuk ndërtohen si politika të veçuara sociale, por si pjesë e detyrimeve shtetërore për respektimin e të drejtave themelore dhe për përmbushjen e standardeve të integritetit evropian.

Në nivel ndërkombëtar, referenca kryesore është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³⁰. Konventa njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për njohje të barabartë para ligjit dhe për ushtrimin e plotë të zotësisë juridike (neni 12), si dhe detyrimin e shtetit për të siguruar akses efektiv në drejtësi në të gjitha fazat e procedurave ligjore (neni 13). Ajo kërkon që shtetet të ofrojnë akomodime procedurale dhe mbështetje të përshtatshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë në procedurat gjyqësore si palë, dëshmitarë apo viktima. Komenti i Përgjithshëm nr. 1 i Komitetit të KDPAK³¹-së e thekson më tej këtë parim, duke kërkuar kalimin nga sistemet e kujdestarisë ligjore drejt mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur, për të garantuar autonominë dhe vetëvendosjen e individit

Po ashtu, Konventa lidhet me të drejtën për liri dhe siguri personale dhe me trajtimin dinjitoz (nenet 14 dhe 15), duke kërkuar që personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ata në paraburgim apo në institucionet e vuajtjes së dënimit, të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë akses në

³⁰ Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

³¹ Initial report submitted by Albania under article 35 of the Convention, due in 2014

shërbime mbështetëse dhe shëndetësore. Në këtë mënyrë, drejtësia nuk kufizohet vetëm në gjykata, por përfshin policinë, prokurorinë, institucionet penitenciare dhe shërbimet ligjore mbështetëse.

Në nivel evropian, këto parime reflektohen në politikat dhe instrumentet e Bashkimit Evropian për të drejtat themelore. Strategjia e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030³² thekson nevojën për akses efektiv në drejtësi dhe për eliminimin e pengesave procedurale dhe institucionale. Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale³³, në parimin për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, kërkon pjesëmarrje të plotë në jetën shoqërore dhe mbrojtje ligjore efektive. Në mënyrë plotësuese, direktivat evropiane mbi ndihmën juridike falas dhe të drejtat e viktimave vendosin standarde minimale për përfaqësim ligjor, mbështetje dhe informim të personave që përfshihen në procedura gjyqësore.

Këto standarde lidhen drejtpërdrejt me procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, veçanërisht në Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, theksojnë rëndësinë e aksesit në drejtësi dhe të mbrojtjes efektive të të drejtave themelore si element i shtetit të së drejtës.

Në të njëjtën linjë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030³⁴ e lidh qeverisjen e mirë dhe barazinë para ligjit me funksionimin efektiv të institucioneve të drejtësisë dhe me mbrojtjen e grupeve të cenueshme.

Në nivel kombëtar, fusha e drejtësisë mbështetet gjithashtu në dokumentet sektoriale të reformës në drejtësi dhe të mbrojtjes sociale. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030³⁵ dhe politikat për të drejtat e fëmijëve adresojnë aksesin në drejtësi për grupet vulnerabël, ndërsa Plani Kombëtar i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026³⁶ lidhet me trajtimin e personave me aftësi të kufizuara psiko-sociale në sistemin ligjor. Në këtë kuadër, politika e drejtësisë synon që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë plotësisht zotësinë juridike, të kenë akses të barabartë dhe efektiv në gjykata, prokurori, polici dhe shërbime ligjore, si dhe të mbrohen nga dhuna dhe abuzimi.

4.2.2. Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i Politikës II: Të garantohet që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë plotësisht zotësinë juridike për të vepruar, të kenë akses të barabartë dhe efektiv në sistemin e drejtësisë dhe

³² EU Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030

³³ The European Pillar of Social Rights (EPSR)

⁵ VKM nr. 88/2023, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030” <https://www.kryeministria.al/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-evropian-skzhe/>

³⁵ VKM nr. 823, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj” <https://www.drejtësia.gov.al/plani-i-veprimit-te-strategjise-ndersektoriale-te-drejtësisë/>

³⁶ <https://medialook.al/wp-content/uploads/2024/01/Plani-i-Veprimit-per-Shendetin-Mendor-2023-2026.pdf>

të mbrohen nga dhuna, abuzimi dhe shkeljet e të drejtave, përmes vendimmarrjes së mbështetur dhe akomodimit të arsyeshëm.

Plani strukturohet mbi 3 objektiva specifike që mbulojnë dimensionet kryesore të politikës së aksesit në drejtësi dhe barazisë para ligjit, të detajuara më tej në 8 masa prioritare dhe 35 ndërhyrje për realizimin e tyre.

Objektivi specifik 1: *Të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të kenë akses fizik, procedural, informativ dhe digjital në gjykata, prokurori, polici dhe shërbime ligjore, si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në të gjitha nivelet që nga hetimi, gjykimi etj.*

Masa prioritare

1.1. Rishikimi i kuadrit ligjor për të mundësuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.

1.2. Ofrimi i shërbimeve të aksesueshme të ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara.

1.3. Ndërgjegjësimi i profesionistëve të sistemit të drejtësisë mbi të drejtën për të pasur akses në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara, bazuar në praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

1.4. Garantimi i aksesueshmërisë në mjedise, informacion e komunikim për personat me aftësi të kufizuara në institucione të sistemit të drejtësisë, apo të lidhura me të.

Objektivi i parë në fushën e drejtësisë synon që gjatë periudhës 2026-2030, personat me aftësi të kufizuara të kenë akses real dhe efektiv në sistemin e drejtësisë në të gjitha fazat e tij, nga hetimi dhe kontaktet me policinë, te procedurat në prokurori dhe gjykatë, si dhe në shërbimet ligjore mbështetëse. Qasja e planit nuk kufizohet vetëm në hyrjen fizike në institucionet e drejtësisë, por përfshin në mënyrë të integruar aksesin fizik, procedural, informativ dhe digjital, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë në proceset ligjore si palë, dëshmitarë, viktima ose përfitues shërbimesh, në kushte të barabarta me të tjerët.

Në pesë vitet e ardhshme, një drejtim kryesor do të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor. Do të realizohet një analizë e plotë e legjislacionit ekzistues, duke shqyrtuar kodet dhe ligjet kryesore për të identifikuar boshllëqet që kufizojnë aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara. Në vijim, do të rishikohen dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Familjes, si dhe ato të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, me qëllim garantimin e aksesit efektiv në organet e drejtësisë dhe parashikimin e akomodimeve procedurale të përshtatshme sipas moshës dhe llojit të aftësisë së kufizuar. Këto ndryshime synojnë që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë realisht në procedurat ligjore, përfshirë edhe në rolin e dëshmitarit, dhe të mos përballen me pengesa procedurale apo komunikimi.

Një nga premtimet më të rëndësishme në fushën e realizimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara gjatë periudhës 2026-2030 është edhe ratifikimi i Protokollit Opsional të KDKPAK.

Një komponent tjetër thelbësor është zgjerimi dhe përmirësimi i ndihmës juridike falas. Plani parashikon që shërbimet e ndihmës juridike të jenë të arritshme dhe efektive për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ata në zonat rurale, në institucione rezidenciale, si dhe për gratë dhe fëmijët. Do të zhvillohen sesione informuese në të gjitha bashkitë, do të përgatiten manuale dhe udhëzues praktikë në gjuhë të thjeshtë dhe në formate të kuptueshme dhe do të përdoren kanale komunikimi si linja telefonike dhe platformat digjitale për informim dhe aplikim për ndihmë juridike. Parashikohet gjithashtu ofrimi i ndihmës juridike përmes ekipeve lëvizëse në terren dhe përfaqësimi ligjor në proceset administrative, civile dhe penale. Për të rritur cilësinë e shërbimit, do të trajnohen punonjësit e qendrave të ndihmës juridike, studentët e klinikave të ligjit dhe organizatat që ofrojnë shërbime ligjore, si dhe do të hartohet një listë e përditësuar e avokatëve të specializuar për këtë kategori.

Plani parashikon gjithashtu ndërgjegjësimin dhe fuqizimin profesional të aktorëve të sistemit të drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe do të zhvillohen konferenca, aktivitete dhe programe trajnimi për gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe noterë mbi të drejtën e njohjes së barabartë para ligjit dhe mbi aksesin efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara. Do të miratohen dhe zbatohen programe të rregullta trajnimi dhe certifikimi, duke synuar aplikimin e ligjit pa qasje paternaliste dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Njëkohësisht, do të inkurajohet përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në pozicione pune brenda sistemit të drejtësisë dhe do të analizohet nevoja për interpret të gjuhës së shenjave në procedurat gjyqësore.

Një drejtim i rëndësishëm i këtij objektivi është garantimi i aksesueshmërisë në mjediset dhe komunikimin e institucioneve të drejtësisë. Do të kryhen vlerësime të detajuara të nevojave për aksesueshmëri fizike, informuese dhe komunikative në gjykata, prokurori, polici dhe institucionet e tjera të lidhura me drejtësinë. Rezultatet e këtyre vlerësimeve do të përfshihen gradualisht në planifikimin buxhetor të institucioneve, me qëllim eliminimin e barrierave fizike dhe organizative. Në vijim do të hartohen protokolle dhe procedura që përcaktojnë mënyrën e ofrimit të informacionit dhe komunikimit të aksesueshëm, si dhe udhëzime të qarta mbi akomodimin e arsyeshëm në çdo fazë të procesit gjyqësor.

Ky objektivi synon kalimin nga një sistem drejtësie formal, ku e drejta ekziston në ligj, drejt një sistemi drejtësie të përdorshëm në praktikë, ku personat me aftësi të kufizuara mund të kuptojnë procedurat, të komunikojnë me institucionet, të mbrojnë të drejtat e tyre dhe të marrin shërbime ligjore pa pengesa. Përmes përmirësimit të legjislacionit, ofrimit të ndihmës juridike, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe përshtatjes së mjediseve dhe procedurave, plani synon që drejtësia të jetë realisht e aksesueshme për të gjithë.

Objektivi Specifik 2: *Të garantohet njohja e barabartë para ligjit dhe ushtrimi i plotë i zotësisë për të vepruar për personat me aftësi të kufizuara, duke zëvendësuar kujdestarinë ligjore me mekanizma të vendimmarrjes së mbështetur.*

Masa prioritare

2.1. Përgatitja e kuadrit ligjor dhe fuqizimi i kapaciteteve për të mundësuar vendimmarrjen e mbështetur

Objektivi i dytë synon të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë njohje të barabartë para ligjit dhe të ushtrojnë plotësisht zotësinë për të vepruar, duke kaluar gradualisht nga sistemi tradicional i kujdestarisë ligjore drejt mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur. Ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për autonomi personale dhe vetëvendosje dhe synon që personat me aftësi të kufizuara të marrin vendime për jetën e tyre në mënyrë të pavarur, me mbështetje të përshtatshme kur është e nevojshme, dhe jo përmes zëvendësimit të vullnetit të tyre nga persona të tjerë.

Në periudhën 2026-2030, një hap i parë do të jetë rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues. Do të realizohet një analizë e thelluar për të identifikuar dispozitat ligjore dhe praktikën që pengojnë ushtrimin e plotë të zotësisë për të vepruar nga personat me aftësi të kufizuara. Mbi këtë bazë, do të ndërmerren ndryshime në legjislacionin përkatës, përfshirë Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Familjes, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për shëndetin mendor, me qëllim garantimin e ushtrimit të të drejtave ligjore në të gjitha aspektet e jetës. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet personave me aftësi të kufizuara psiko-sociale dhe intelektuale, të cilët historikisht janë prekur më shumë nga kufizimi ose heqja e zotësisë për të vepruar.

Paralelisht, plani parashikon ngritjen e mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur. Këta mekanizma do të krijojnë mundësi që individët të marrin vendime vetë, duke përdorur forma të ndryshme mbështetjeje, si asistencë në komunikim, interpretimi i informacionit, këshillimi ose përfaqësimi i mbështetur, pa i hequr të drejtën për të vendosur. Për këtë qëllim do të përgatiten dhe miratohet kuadri ligjor përkatës, i cili do të përcaktojë mënyrën e funksionimit të këtyre mekanizmave dhe rolet e institucioneve dhe personave mbështetës.

Një element thelbësor i zbatimit do të jetë fuqizimi i kapaciteteve profesionale. Do të zhvillohen programe trajnimi për profesionistët që ndërveprojnë me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë stafin e shëndetësisë, policisë, prokurorisë, gjyqësorit, noterët dhe avokatët, me qëllim që ata të kuptojnë dhe të zbatojnë në praktikë konceptin e vendimmarrjes së mbështetur. Këto programe do të ndihmojnë kalimin nga qasja tradicionale mbrojtëse dhe zëvendësuese drejt një qasjeje që respekton vullnetin dhe preferencat e individit.

Plani parashikon gjithashtu njohjen e praktikave ndërkombëtare dhe përshtatjen e tyre në kontekstin shqiptar përmes vizitave studimore në vende ku vendimmarrja e mbështetur është zbatuar me sukses. Për të siguruar kuptim të gjerë dhe përdorim praktik, do të përgatiten materiale udhëzuese në formate të aksesueshme dhe do të zhvillohen fushata informimi për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, me qëllim që ata të njohin të drejtat dhe mënyrat e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Ky objektivi synon një ndryshim thelbësor në mënyrën se si sistemi juridik trajton personat me aftësi të kufizuara: nga një model i mbrojtjes përmes zëvendësimit të vendimmarrjes, drejt një modeli që mbështet autonominë personale dhe respektimin e vullnetit individual. Përmes

reformimit të legjislacionit, ngritjes së mekanizmave mbështetës dhe rritjes së kapaciteteve profesionale, plani synon të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të jenë subjekt i plotë i të drejtave dhe detyrimeve juridike, në kushte të barabarta me të gjithë qytetarët.

Objektivi Specifik 3: *Të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara në paraburgim dhe në institucionet e vuajtjes së dënimit të kenë ambiente të aksesueshme, shërbime shëndetësore e psiko-sociale dhe plane individuale mbështetjeje, për të garantuar trajtim dinjitoz dhe të barabartë.*

Masa prioritare

3.1. Realizimi i aksesueshmërisë fizike dhe aksesueshmërisë në informacion e komunikim për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimeve.

3.2. Fuqizimi i kapaciteteve në institucionet e paraburgimit dhe ato të vuajtjes së dënimit, duke mundësuar mbështetjen bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Objektivi i tretë synon të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të vendosur në paraburgim apo në institucionet e vuajtjes së dënimit të trajtohen në mënyrë dinjitoze dhe të barabartë, duke pasur kushte të përshtatshme jetese, akses në shërbime dhe mbështetje sipas nevojave individuale. Ky objektivi e shtrin konceptin e aksesit në drejtësi edhe në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, duke e konsideruar respektimin e të drejtave të personit jo vetëm gjatë procesit gjyqësor, por edhe gjatë qëndrimit në institucionet e mbyllura.

Në periudhën 2026-2030, një hap fillestar do të jetë vlerësimi i plotë i kushteve ekzistuese në institucionet e vuajtjes së dënimit. Do të realizohet një analizë për të identifikuar nevojat për aksesueshmëri fizike, informuese dhe komunikative për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Kjo analizë do të shërbejë si bazë për përcaktimin e prioriteteve dhe përfshirjen graduale të ndërhyrjeve në buxhetet institucionale, me qëllim përshtatjen e mjediseve dhe eliminimin e barrierave që pengojnë përdorimin e hapësirave dhe shërbimeve brenda institucioneve.

Paralelisht, plani parashikon krijimin e mekanizmave për identifikimin e hershëm të personave me aftësi të kufizuara që në momentin e pranimit në institucion. Do të hartohen procedura dhe formularë standardë për evidentimin e nevojave, në mënyrë që çdo i paraburgosur apo i dënuar të përfitojë akomodimin e arsyeshëm dhe mbështetjen e nevojshme. Në vijim, për secilin person do të përgatitet një plan individual mbështetjeje, bazuar në vlerësimin e nevojave të tij, i cili do të orientojë ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin gjatë qëndrimit në institucion.

Një komponent thelbësor është garantimi i shërbimeve shëndetësore dhe psiko-sociale. Personat me aftësi të kufizuara do të kenë akses në mjekë, psikologë dhe terapi të vazhdueshme, përmes sistemeve të referimit dhe bashkëpunimit me shërbimet komunitare. Kjo qasje synon të parandalojë përkeqësimin e gjendjes shëndetësore dhe të mbështesë riintegrimin social, duke e konsideruar shërbimin shëndetësor si pjesë të trajtimit human dhe jo vetëm si ndërhyrje emergjente.

Plani parashikon gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kapaciteteve profesionale të personelit të policisë dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimit. Do të zhvillohen programe trajnimi dhe kurrikula të posaçme mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mbi aksesin në drejtësi dhe mbi mënyrën e trajtimit të përshtatshëm të tyre në mjedise të mbyllura. Trajnimet synojnë të sigurojnë që stafi të njohë standardet ndërkombëtare dhe të zbatojë praktika që respektojnë dinjitetin, integritetin dhe nevojat individuale të personave.

Objektivi synon që institucionet e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit të mos përbëjnë një mjedis përjashtues për personat me aftësi të kufizuara. Përmes përshtatjes së mjediseve, ofrimit të shërbimeve të specializuara, hartimit të planeve individuale të mbështetjes dhe rritjes së kapaciteteve profesionale, plani synon të garantojë trajtim të barabartë dhe human, duke respektuar të drejtat themelore të personit edhe gjatë kufizimit të lirisë.

4.3 Punësimi dhe Aftësimi

4.3.1 Konteksti strategjik

Fusha e punësimit dhe aftësimit në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 mbështetet në një kuadër të gjerë dokumentesh ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare, të cilat e trajtojnë punësimin jo vetëm si politikë ekonomike, por si një e drejtë themelore e njeriut dhe si kusht për jetesë të pavarur, përfshirje sociale dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri. Në këtë kuadër, ndërhyrjet nuk konsiderohen si masa të izoluar të tregut të punës, por si pjesë e një qasje të integruar politikave, e cila nis me arsimin gjithëpërfshirës, vijon me zhvillimin dhe fuqizimin e aftësive, dhe përmbillet me sigurimin e një punësim të denjë dhe të qëndrueshëm.

Në nivel ndërkombëtar, baza normative përcaktohet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³⁷, e cila garanton të drejtën për arsim gjithëpërfshirës dhe të barabartë (neni 24), duke kërkuar që sistemet arsimore dhe të formimit profesional të jenë të aksesueshme dhe të përshtatura për nevojat individuale të nxënësve dhe kursantëve me aftësi të kufizuara.

Ajo njeh gjithashtu të drejtën për punë dhe punësim në një treg të hapur dhe gjithëpërfshirës, si dhe nevojën për aksesueshmëri dhe mbledhje të dhënash për të orientuar politikat publike (nenet 9 dhe 31). Kjo qasje, vendos detyrimin që shteti të garantojë jo vetëm mundësinë për të punuar, por edhe kushtet reale që e bëjnë punësimin të arritshëm.

Parimet e Konventës plotësohen nga standardet ndërkombëtare të arsimit gjithëpërfshirës, përfshirë udhëzimet e UNESCO-s, të cilat kërkojnë që sistemet arsimore dhe të formimit profesional të funksionojnë mbi parimet e aksesueshmërisë, përshtatjes së arsyeshme dhe dizajnit universal për të nxënëit. Kjo e lidh drejtpërdrejt aftësimin profesional me pjesëmarrjen e mëvonshme në tregun e punës.

³⁷ Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

Në nivel evropian, këto parime reflektohen në Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030³⁸, e cila synon rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe eliminimin e barrierave strukturore që përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara nga punësimi.

Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale³⁹ përcakton se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbështetje që u mundëson pjesëmarrjen në tregun e punës dhe një mjedis pune të përshtatur sipas nevojave të tyre.

Po në këtë linjë, paketa evropiane për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (Disability Employment Package)⁴⁰ orienton shtetet drejt shërbimeve të personalizuar të punësimit, përshtatjes së arsyeshme dhe mbështetjes aktive për punëdhënësit.

Këto politika lidhen edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm⁴¹, veçanërisht Objektivin 8 për punë të denjë dhe rritje ekonomike gjithëpërfshirëse, që kërkon rritjen e punësimit, mbrojtjen e të drejtave në punë dhe përfshirjen e të rinjve dhe grupeve vulnerabël në ekonomi. Për rrjedhojë, punësimi i personave me aftësi të kufizuara trajtohet njëkohësisht si çështje e të drejtave të njeriut dhe si element i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik.

Në nivel kombëtar, ky kapitull harmonizohet me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030⁴², Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030⁴³ dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore⁴⁴, të cilat synojnë rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive sipas nevojave të ekonomisë.

Po ashtu, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030,⁴⁵ e lidh kapitalin njerëzor dhe mirëqenien sociale me fuqinë punëtore dhe përfshirjen në tregun e punës.

Politikat digjitale, sipërmarrja inovative dhe zhvillimi i aftësive të gjelbra konsiderohen gjithashtu elemente të rëndësishme për përfshirjen në ekonominë moderne.

Në këtë kuadër, Plani i Veprimit e trajton punësimin e personave me aftësi të kufizuara si rezultat të një procesi të integruar politikash: arsimit dhe formimi profesional gjithëpërfshirës, ndërmjetësimi i punësimit dhe mbështetja me programe të nxitjes funksionojnë si instrumente plotësuese që sigurojnë pjesëmarrje reale në tregun e punës.

Kjo qasje e lidh drejtpërdrejt politikën e punësimit me procesin e integritit evropian, duke synuar përafrimin gradual me *acquis* të BE-së dhe me standardet evropiane të tregut të punës dhe të përfshirjes sociale.

³⁸ EU Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030

³⁹ The European Pillar of Social Rights (EPSR)

⁴⁰ EU Disability Employment Package

⁴¹ The Sustainable Development Goals (OZHQs)

⁴² Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030

⁴³ Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030

⁴⁴ Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore, VKM nr. 201, datë 3.4.2019

⁴⁵ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030

Dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare vendosin një parim të përbashkët, i cili thekson se punësimi i personave me aftësi të kufizuara nuk është një politikë kompensuese, por një e drejtë dhe një detyrim shtetëror. Ai kërkon ndërhyrje të koordinuara në arsim, aftësim, tregun e punës dhe mbrojtje sociale, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kenë jo vetëm mundësi teorike, por edhe mundësi reale për punë të denjë dhe pjesëmarrje ekonomike.

4.3.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i politikës: Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët, në një treg dhe mjedis pune të hapur, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm.

Për të realizuar qëllimin, plani strukturohet në 2 objektiva specifike, 11 masa prioritare dhe 48 ndërhyrje konkrete të buxhetuara.

***Objektivi specifik 1:** Nxitja e pjesëmarrjes, zgjerimi i aksesit dhe përfitimit të nxënësve dhe kursantëve me aftësi të kufizuara nga programet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe parimet e arsimit gjithëpërfshirës.*

Masat prioritare

- 1.1 Përmirësimi i kornizës politike, ligjore dhe institucionale për arsim e formim profesional gjithëpërfshirës;
- 1.2 Përmirësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë asistive;
- 1.3 Përshtatja e kurrikulave dhe programeve mësimore;
- 1.4 Mbështetja e nxënësve dhe kursantëve me aftësi të kufizuara;
- 1.5 Bashkëpunimi me sektorin privat dhe tregun e punës;
- 1.6 Monitorimi, vlerësimi dhe administrimi i të dhënave.

Gjatë periudhës 2026-2030, Plani i Veprimit synon ngritjen një sistem të arsimit dhe formimit profesional (AFP) funksional dhe gjithëpërfshirës, i cili garanton përfshirjen efektive të personave me aftësi të kufizuara dhe krijon ura konkrete drejt punësimit. Qasja nuk kufizohet në regjistrimin formal në një shkollë profesionale apo qendër formimi, por synon të krijojë një zinxhir të plotë përfshirjeje: nga hyrja në sistem, cilësia e formimit, mbështetja individuale gjatë studimit dhe deri te lidhja me tregun e punës.

Së pari, Plani ndërhyr në nivel strukturor dhe ligjor. Do të rishikohen Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional dhe ai për Arsimin Parauniversitar për të garantuar një sistem gjithëpërfshirës. Ndërsa në politikat e punësimit do të përfshihen programe rehabilitimi, formimi dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara. Paralelisht do të forcohen mekanizmat e cilësisë: udhëzime të përbashkëta institucionale, standarde të reja për akreditimin dhe inspektimin e ofruesve të AFP-së, si dhe zhvillimi profesional i mësimeve, përfshirë mësuesit mbështetës. Njësitë e zhvillimit në institucionet e AFP-së do të konsolidohen për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe do të krijohen rrjete bashkëpunimi mes institucioneve për shkëmbim praktikash.

Një element i rëndësishëm është krijimi i mjediseve të aksesueshme. Institucionet e AFP-së do të pajisen me teknologji asistive dhe pajisje ndihmëse, si lexues ekrani, tastiera të përshtatura dhe programe mbështetëse. Do të sigurohet akses fizik dhe digjital në shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional, përfshirë laboratorët e teknologjisë së informacionit dhe aftësive të gjelbra. Plani parashikon edhe zhvillimin e platformave digjitale dhe mësimin të kombinuar, me informacion në formate alternative, për të garantuar mundësi të barabarta për të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.

Një tjetër shtyllë është përshtatja e përmbajtjes së mësimin. Kurrikulat ekzistuese do të rishikohen për të integruar parimet e dizajnit universal për të nxënëit, ndërsa do të zhvillohen module të reja, përfshirë ato digjitale dhe të ekonomisë së gjelbër, të përshtatura për tipologji të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Materialet didaktike do të ofrohen në formate të aksesueshme, Braille, audio, gjuhë e thjeshtuar, gjuhë e shenjave dhe titra, dhe mësuesit do të trajnohen për përdorimin e teknologjisë asistive në procesin mësimor.

Plani parashikon edhe mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit dhe kursantët. Do të identifikohen nevojat individuale dhe do të hartohen plane individuale të të nxënëit, do të ofrohet këshillim profesional dhe orientim në karrierë i personalizuar, si dhe mbështetje financiare përmes bursave, transportit dhe pajisjeve personale. Do të forcohet bashkëpunimi mes shkollës, familjes dhe komunitetit dhe do të përfshihen bizneset në praktika profesionale të përshtatura.

Një element thelbësor i objektivit është lidhja e drejtpërdrejtë me punësimin. Plani parashikon partneritete me kompanitë, programe të praktikave të asistuar dhe sensibilizim të punëdhënësve mbi potencialin e punësimit gjithëpërfshirës. Certifikimi i aftësive, përfshirë ato digjitale dhe të gjelbra, do të standardizohet në mënyrë që kualifikimet e fituara të kenë vlerë reale në tregun e punës.

Së fundi, objektivi mbështetet në monitorim të vazhdueshëm dhe përdorim të të dhënave. Do të mblidhen statistika të ndara sipas kategorisë të aftësisë së kufizuar, gjinisë dhe moshës, do të vendosen tregues performance për pjesëmarrjen, përfundimin dhe punësimin dhe politikat do të rishikohen mbi bazë evidence. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të përfshihen në projekte pilot, trajnime dhe hartim udhëzuesish praktikë.

Ky objektivi, synon të krijojë një rrugë të plotë tranzicioni nga arsimi në punë, ku arsimi dhe formimi profesional nuk janë një fazë e izoluar, por një instrument konkret për integrimin ekonomik dhe social të personave me aftësi të kufizuara.

Objektivi specifik 2: Zgjerimi dhe konsolidimi i shërbimeve të punësimit që synojnë fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara, përmes konsolidimit të programeve të aftësimin dhe punësimit dhe ngritjes së Fondit Social të Punësimit.

Masat prioritare

2.1 Plotësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për të nxitur punësimin e punëkërkesve me aftësi të kufizuara;

- 2.2 Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe kapaciteteve institucionale të AKPA-së dhe zyrave të punësimit;
- 2.3 Përmirësimi i sistemit të vlerësimit, regjistrimit dhe profilizimit të punëkërkuarve me aftësi të kufizuara;
- 2.4 Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për punëdhënësit dhe punëkërkuarët;
- 2.5 Forcimi i qeverisjes, koordinimit dhe monitorimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës 2026-2030, Plani i Veprimit synon të krijojë një sistem funksional të përfshirjes në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara. Ky objektivi ndërton hallkën që mungon mes arsimit/formimit profesional dhe punësimit real, duke e konsideruar punësimin si proces të vazhdueshëm që përfshin rehabilitimin për punë, ndërmjetësimin, mbështetjen në vendin e punës dhe qëndrueshmërinë në punësim.

Së pari, Plani parashikon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional. Do të rishikohet Ligji për Nxitjen e Punësimit për të garantuar mekanizma efektivë rehabilitimi për punë dhe punësim të denjë për personat me aftësi të kufizuara. Paralelisht, Ligji për Sigurimet Shoqërore do të rregullojë vlerësimin e aftësisë për punë dhe do të sigurojë që mbështetja financiare për kostot e lidhura me aftësinë e kufizuar të mos ndërpritet për shkak të punësimit. Një element thelbësor i reformës do të jetë krijimi dhe operacionalizimi i Fondit Social të Punësimit. Ky fond do të financojë programe aftësimi, punësimi, vetëpunësimi, sipërmarrjeje sociale dhe përshtatje të arsyeshme në vendin e punës, përmes një mekanizmi kontributësh nga punëdhënësit dhe administrimi nga një bord i posaçëm, me përfaqësim edhe nga organizatat e fushës, me eksperiencë në punësim. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohen udhëzime dhe vendime për zbatimin e programeve aktive të tregut të punës, përfshirë programin e punësimit me mbështetje dhe financimin e përshtatjes së arsyeshme.

Një drejtim i rëndësishëm është transformimi i shërbimeve publike të punësimit. Zyrat e punësimit do të bëhen të aksesueshme fizikisht dhe në mënyrë digjitale, duke garantuar komunikim dhe informacion të kuptueshëm dhe akomodime të arsyeshme, kur të jetë e nevojshme. Do të vendosen specialistë të dedikuar për punëkërkuarët me aftësi të kufizuara dhe për punëdhënësit, si dhe do të trajnohen këshilltarë të specializuar për ndërmjetësim profesional dhe mbështetje të vazhdueshme. Modeli i ofrimit të shërbimit do të strukturohet në tre nivele: shërbime universale bazë, ndërmjetësim i avancuar dhe shërbime intensive të personalizuar, përfshirë punësimin me mbështetje.

Plani parashikon edhe përmirësimin e sistemit të vlerësimit të kapaciteteve për punë. Do të ngrihet një sistem profilizimi individual cilësor për punëkërkuarët me aftësi të kufizuara, që merr në konsideratë aftësitë, interesat, aspiratat, nevojat për përshtatje të arsyeshme dhe dimensionin gjinor e moshën. Do të krijohet një sistem digjital ndërmjetësimi i aksesueshëm, i cili lidh automatikisht personin me arsimin dhe formimin profesional, skemat aktive të punësimit dhe tregun e hapur të punës.

Një tjetër shtyllë është mbështetja e drejtpërdrejtë për punëdhënësit dhe për punëkërkuarët. Do të përshtaten programet e nxitjes së punësimit, duke garantuar masa prioritare për personat me aftësi

të kufizuara, si subvencionimi i pagave, përshtatja e vendit të punës dhe financimi i pajisjeve ndihmëse. Do të zhvillohen programe të reja, përfshirë punësimin me mbështetje, vetëpunësimin, sipërmarrjen sociale dhe aftësimin në partneritet me aktorë publikë e privatë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tranzicionit nga shkolla në punë për të rinjtë me aftësi të kufizuara, përmes praktikave të asistuara, përfshirjes në Garancinë Rinore dhe mbështetjes për të rinjtë e pa përfshirë në arsim, punësim dhe formim profesional (NEET). Gjithashtu, do të mbështeten punëdhënësit për realizimin e përshtatjes së arsyeshme dhe do të zhvillohen fushata informuese për programet aktive të tregut të punës.

Në fund, Plani përfshin forcimin e qeverisjes dhe monitorimit. Do të realizohen vlerësime kombëtare për nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat, si dhe vlerësime periodike të efekteve të politikave të përfshirjes aktive në tregun e punës, përfshirë lidhjen me sistemin e pagesave të papunësisë. Zbatimi i këtij objekti do të koordinohet me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Garancinë Rinore, për të siguruar që politikat e aftësimit, mbrojtjes sociale dhe punësimit të funksionojnë si një sistem i vetëm.

Objekti 2, synon të krijojë një treg pune gjithëpërfshirës, ku personat me aftësi të kufizuara të mos mbeten përfitues pasivë të mbështetjes sociale, por pjesëmarrës aktivë në ekonomi, me mundësi reale për punësim të qëndrueshëm dhe pavarësi ekonomike.

4.4 Arsimi

4.4.1 Konteksti strategjik

Kapitulli i arsimit në Planin e ri të Veprimit 2026-2030 për Personat me Aftësi të Kufizuara ndërtohet mbi një kornizë të qartë ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare, ku arsimi gjithëpërfshirës trajtohet si e drejtë themelore dhe si parakusht për përfshirje shoqërore. Qasja e Planit synon të ofrojë një udhëzues të konsoliduar për politikëbërjen dhe zbatimin praktik të arsimit gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, nga edukimi i hershëm deri te arsimi i lartë, duke garantuar akses të barabartë, cilësi, mbështetje dhe pjesëmarrje aktive të fëmijëve/nxënësve/ studentëve me aftësi të kufizuara, familjeve dhe shoqërisë civile.

Në nivel ndërkombëtar, referenca kryesore është Konventa e OKB-së⁴⁶ për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe rekomandimet e Komitetit KDPAK⁴⁷, të cilat kërkojnë arsim gjithëpërfshirës, mosdiskriminim, aksesueshmëri dhe përshtatje të arsyeshme, si dhe mbështetje të individualizuar në mjedise të zakonshme mësimore. Kjo linjë harmonizohet me orientimet dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, përfshirë Strategjinë BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁴⁸, e cila e lidh përfshirjen arsimore me

⁴⁶ Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

⁴⁷ Initial report submitted by Albania under article 35 of the Convention, due in 2014

⁴⁸ EU Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030

heqjen e barrierave, sigurimin e mbështetjes dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Në nivel kombëtar, ky kapitull vendoset në vijimësi me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026⁴⁹, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030⁵⁰ (Shtylla “Kohezioni social”), si edhe me Agjendën e Reformave 2024-2027⁵¹, në kuadër të reformave dhe lehtësirave të rritjes për Ballkanin. Paralelisht, ai lidhet me përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë (përfshirë ato që burojnë nga korniza evropiane si European Accessibility Act⁵² dhe me Kornizën e Zhvillimit Profesional⁵³, që orienton ngritjen e kapaciteteve të stafit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës.

4.4.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i Politikës: Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor për fëmijët, nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara.

Për të realizuar qëllimin më sipër, plani parashikon 4 objektiva specifike, 15 masa prioritare dhe 45 ndërhyrje konkrete.

Objektivi 1: Zhvillimi dhe edukimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me aftësi të kufizuara në fëmijërinë e hershme dhe arsimin parashkollor duke investuar në infrastrukturë, shërbime mbështetëse dhe zhvillimin profesional të stafit të kopshteve.

Masat prioritare

- 1.1 Përmirësimi i kuadrit të politikave dhe qeverisjes për akses të barabartë në edukimin e hershëm;
- 1.2 Infrastrukturë dhe mjedise të aksesueshme, të sigurta dhe miqësore në kopshte/klasa përgatitore;
- 1.3 Shërbime mbështetëse shumëdisiplinore dhe edukim i individualizuar;
- 1.4 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe sigurimi i cilësisë në edukimin e hershëm gjithëpërfshirës.

Plani i ri e vendos edukimin e hershëm si pikën e parë ku ndërtohet barazia në arsim: ai synon që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos hyjnë “me vonesë” në sistem, por të identifikohen, të referohen dhe të mbështeten që në kopshte dhe klase përgatitore. Për këtë arsye, ndërhyrjet fillojnë me rishikimin dhe përditësimin e politikave, akteve nënligjore dhe udhëzimeve, me synim heqjen e mangësive dhe krijimin e një baze të qartë të përgjegjësive dhe bashkërendimit ndërmjet arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Në praktikë, kjo do të realizohet përmes forcimit të

⁴⁹ VKM nr. 1037, datë 23.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2030 dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj”.

⁵⁰ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030

⁵¹ Reforms Agenda 2024-2027 within the Framework of Reforms and Growth Facilitation for the Western Balkans

⁵² European Accessibility Act (Directive (EU) 2019/882)

⁵³ VKM nr. 765, datë 16.10.2019 “Për miratimin e Kornizës Kombëtare të Zhvillimit Profesional të Mësuesve dhe Stafit Arsimor në arsimin parauniversitar”

mekanizmave ndërinstitucionalë dhe hartimit të udhëzimeve të përbashkëta për identifikim, referim, regjistrim dhe mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në edukimin e hershëm.

Paralelisht, Plani e trajton aksesueshmërinë dhe mjedisin mësimor si kushte minimale për pjesëmarrje: parashikohen investime të planifikuara për përshtatjen e godinave (hyrje, ambiente të brendshme, nyje hidro-sanitare, ambiente loje), sinjalistikë e elemente orientuese (përfshirë kontrastet për fëmijët e verbër), si edhe pajisja me mjete didaktike/lojëra të përshtatura dhe teknologji asistive. Njëkohësisht, për të ulur barrierat në qëndrime dhe për të rritur pjesëmarrjen reale, Plani parashikon sesione informuese dhe ndërjegjësuere me prindërit dhe komunitetin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe gjithëpërfshirjen.

Thelbi i cilësisë në këtë objektiv është mbështetja shumëdisiplinore dhe individualizimi. Plani synon rritjen e numrit të mësuesve ndihmës dhe të specialistëve (psikologë, logopedë, terapist zhvillimi, punonjës socialë), krijimin/forcimin e hapësirave zhvillimore dhe hartimin e Planeve Individuale të Zhvillimit dhe Edukimit, me monitorim periodik të progresit dhe përshtatje të ndërhyrjeve sipas nevojave. Për të rritur pjesëmarrjen, parashikohet edhe ofrimi i transportit falas, i orientuar nga vlerësime kombëtare dhe buxhetim. Në të njëjtën kohë, Plani e lidh suksesin e arsimit gjithëpërfshirës me kapacitetet e stafit: do të zhvillohen programe të detyrueshme trajnimi fillestar dhe të vazhdueshëm për edukatorët dhe mësuesit mbështetës, mbështetje për rrjetet profesionale, si dhe programe për prindërit për të forcuar bashkëpunimin familje-institucion dhe për të siguruar cilësi të qëndrueshme.

Objekivi 2: *Arsim parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe i barabartë për nxënësit me aftësi të kufizuara.*

Masat prioritare

- 2.1 Kuadër ligjor, institucional dhe mekanizma qeverisjeje për arsimin parauniversitar gjithëpërfshirës;
- 2.2 Identifikim i hershëm, vlerësim ndërdisiplinor dhe planifikim i individualizuar;
- 2.3 Mbështetje profesionale, kurrikulare dhe mjedisore;
- 2.4 Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe përfshirja e prindërve/komunitetit.

Në arsimin parauniversitar, Plani synon të kalojë nga një përfshirje formale, e kufizuar në kuadrin rregullator, drejt një përfshirjeje funksionale dhe efektive në praktikë: rregulla të qarta, koordinim ndërsektorial, planifikim individual dhe mbështetje reale në klasë. Fillimisht, do të rishikohen dhe përmirësohen aktet nënligjore dhe udhëzimet për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, mbi parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Një element kritik është koordinimi i qëndrueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse (arsimi dhe shërbimet sociale/shëndetësore), duke formalizuar bashkëpunimin për identifikim dhe vlerësim të integruar të nevojave të nxënësve. Paralelisht, Plani synon të forcojë mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe llogaridhënies, duke integruar indikatorë të aksesit (përfshirë dimensionin gjinor dhe tipologjitë e aftësisë së kufizuar), indikatorë të cilësisë, të mbështetjes individuale dhe të rezultateve arsimore.

Qasja e individualizuar është boshti i këtij objekti: parashikohet forcimi i identifikimit të hershëm, rritja e efektivitetit të strukturave vlerësuese pranë niveleve vendore dhe zbatimi i vlerësimit ndërdisiplinor të nevojave arsimore, i lidhur me planifikim buxhetor vjetor për akomodimin/përshtatjen e arsyeshme. Në vijim, do të hartohen dhe zbatohen Plane Individuale Arsimore (PEI), me monitorim të rregullt dhe me përfshirje aktive të prindërve përmes takimeve periodike të formalizuara.

Në nivel të klasës dhe mjedisit mësimor, Plani synon të rrisë dhe forcojë rrjetin e mbështetjes: mësues ndihmës, psikologë shkollorë, punonjës socialë dhe specialistë të tjerë, si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse, pajisjeve dhe teknologjive asistive sipas nevojave individuale. Një element thelbësor është rishikimi/hartimi dhe zbatimi i kurrikulës gjithëpërfshirëse dhe metodologjive fleksibël të mësimdhënies e vlerësimit, duke vendosur në praktikë parimet e Dizajnit Universal për të Nxënëit. Gjithashtu, do të përshtaten infrastruktura shkollore, materialet mësimore dhe platformat digjitale për aksesueshmëri fizike, komunikimi dhe informacioni.

Së fundi, për të garantuar cilësi dhe ndryshim kulturor brenda shkollës, plani parashikon programe të detyrueshme zhvillimi profesional për mësuesit, drejtuesit dhe stafin mbështetës për menaxhimin e diversitetit dhe mbështetjen e të nxënëit të individualizuar, si edhe forcim të mekanizmave të bashkëpunimit shkollë-prind-komunitet dhe përfshirje të prindërve në vendimmarrje dhe mirëqenie.

Objektivi 3: *Transformimi/riorganizimi i shkollave speciale në qendra burimore dhe konsolidimi i rolit dhe veprimtarisë së tyre.*

Masat prioritare:

- 3.1 Konsolidimi i kuadrit rregullator për qendrat burimore;
- 3.2 Akreditimi dhe integrimi i moduleve të trajnimit të qendrave burimore në programet kombëtare të zhvillimit profesional;
- 3.3 Zgjerimi territorial dhe funksional i shërbimeve të qendrave burimore;
- 3.4 Monitorimi, vlerësimi dhe siguri i cilësisë së funksionimit të qendrave burimore.

Ky objektivi ndryshon rolin e shkollave speciale nga institucione “të ndara” të edukimit, drejt qendrave burimore që mbështesin sistemin e zakonshëm shkollor me ekspertizë, shërbime, materiale dhe trajnim. Plani parashikon së pari konsolidimin e bazës rregullatore, duke përfshirë ndërhyrje të tilla si unifikimi i Kodit Braille në nivel kombëtar dhe qartësimi i marrëdhënieve institucionale ndërmjet qendrave burimore, strukturave vendore të arsimit dhe institucioneve parauniversitare, në mënyrë që referimi dhe mbështetja të funksionojnë pa boshllëqe.

Në vijim, Plani synon të kthejë produktet e qendrave burimore në standard kombëtar për ngritjen e kapaciteteve: përfundim i akreditimit të moduleve të trajnimit, integrim i moduleve të akredituara në programet kombëtare të zhvillimit profesional dhe zgjerim i përdorimit të tyre në trajnimet e detyrueshme për stafin e shkollave të zakonshme. Një hallkë e rëndësishme është edhe forcimi i lidhjes me institucionet e arsimit të lartë, për të krijuar një linjë të qëndrueshme përgatitjeje të specialistëve.

Nga ana e shërbimeve, Plani synon shtrirje territoriale dhe funksionale: zgjerim gradual i shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese në të gjitha qarqet, formalizim të mekanizmave të referimit dhe mbështetjes për nxënësit në shkollat e zakonshme, si edhe zhvillim dhe shpërndarje të materialeve didaktike të specializuara për përdorim kombëtar. Për të garantuar që ky transformim prodhon efekt në cilësi, Plani parashikon një sistem të standardizuar monitorimi dhe raportimi për qendrat burimore, vendosje indikatorësh performance dhe raportim periodik mbi efektivitetin, në mënyrë që gjetjet të përdoren për përmirësim politikash dhe qëndrueshmëri institucionale/financiare.

Objektivi 4: *Arsim i lartë gjithëpërfshirës me standarde aksesueshmërie, cilësie dhe mbështetjeje.*

Masat prioritare

- 4.1 Kuadër i qëndrueshëm ligjor/institucional dhe mekanizma cilësie për mosdiskriminim dhe akses të barabartë;
- 4.2 Aksesueshmëri e plotë fizike, digjitale dhe akademike në institucionet e arsimit të lartë;
- 4.3 Shërbime mbështetëse dhe zhvillim kapacitetesh;
- 4.4 Mbështetje financiare, pjesëmarrje e barabartë dhe mundësi zhvillimi akademik.

Plani e trajton arsimin e lartë si fazë ku barazia duhet të matet me akses real në studim, shërbime universitare, vlerësim akademik dhe mundësi zhvillimi. Në këtë kuadër, ndërhyrjet fillojnë me rishikimin dhe përditësimin e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të institucioneve të arsimit të lartë, për t'i harmonizuar me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes. Paralelisht, Plani kërkon integrimin e indikatorëve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë në sistemet e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë dhe raportim periodik mbi progresin dhe ndikimin.

Në planin praktik, fokusi vihet te mjedisi universitar i aksesueshëm: investime për përshtatjen e infrastrukturës fizike (ambiente mësimore, biblioteka, laboratorë), aksesueshmëria e platformave digjitale dhe materialeve mësimore, si dhe përshtatja e metodave të mësimdhënies, vlerësimit dhe pjesëmarrjes akademike sipas parimeve të dizajnit universal. Për ta bërë këtë të zbatueshme, parashikohet hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të mbështetjes akademike në bashkëpunim me studentët.

Plani parashikon edhe forcimin e mbështetjes institucionale: krijim/forcim të njëjësive të posaçme mbështetëse në universitete, këshillim akademik e psiko-social dhe ndërmjetësim për përshtatje të arsyeshme, sigurim të teknologjive asistive dhe pajisjeve ndihmëse, si dhe programe të detyrueshme trajnimi për stafin akademik dhe administrativ mbi arsimin gjithëpërfshirës.

4.5 Mbrojtja Sociale

4.5.1 Korniza strategjike

Fusha e mbrojtjes sociale në Planin e Veprimit 2026-2030 për personat me aftësi të kufizuara përfaqëson shtyllën, që garanton jetesë dinjitoze, pavarësi dhe siguri sociale. Qasja e Planit e koncepton mbrojtjen sociale, jo vetëm si sistem përfitimesh financiare, por si një sistem të

integruar të të drejtave sociale, që përfshin vlerësimin e nevojave, shërbimet komunitare, jetesën e pavarur, strehimin e aksesueshëm, vendimmarrjen e mbështetur, mbrojtjen e grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe reagimin gjithëpërfshirës në situata emergjence. Synimi është që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi reale për të jetuar në komunitet, me zgjedhje dhe kontroll mbi jetën e tyre, përmes mbështetjes individuale dhe shërbimeve të bazuara në komunitet, duke reduktuar varësinë nga familja dhe institucionalizimi.

Në nivel ndërkombëtar, kjo fushë mbështetet në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)⁵⁴, veçanërisht në nenet mbi jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet (neni 19), mbrojtjen sociale dhe standardin e përshtatshëm të jetesës (neni 28), rehabilitimin (neni 26), mbrojtjen në situata rreziku dhe emergjencash humanitare (neni 11), si dhe barazinë para ligjit (neni 12). Komiteti i KDKPAK⁵⁵, në rekomandimet e tij për shtetet palë, ka theksuar nevojën për kalimin nga modeli institucional drejt shërbimeve të bazuara në komunitet, zhvillimin e programeve të jetesës së pavarur dhe zëvendësimin e kujdestarisë ligjore me mekanizma të vendimmarrjes së mbështetur. Në të njëjtën linjë, Komentet e Përgjithshme të Komitetit mbi nenin 19 dhe nenin 12 theksojnë se pagesat financiare duhet të lidhen me mbështetjen individuale dhe se shërbimet sociale duhet të jenë të orientuara drejt autonomisë së individit.

Korniza strategjike mbështetet gjithashtu në Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁵⁶ dhe në Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale⁵⁷, të cilat kërkojnë akses në mbrojtje sociale, shërbime komunitare, kujdes afatgjatë dhe jetesë të pavarur. Udhëzimet e BE-së për de-institucionalizimin dhe jetesën e pavarur⁵⁸ kërkojnë zhvillimin e ndihmësit personal, strehimit komunitar dhe mbështetjes individuale, si kushte për përfshirje sociale dhe ekonomike. Në mënyrë të veçantë, politikat evropiane kërkojnë që sistemet e mbrojtjes sociale të mos krijojnë varësi nga përfitimet, por të mbështesin autonominë dhe pjesëmarrjen aktive.

Në aspektin e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së fëmijëve, kjo fushë mbështetet në standardet ndërkombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi i shumëfishtë, përfshirë Konventën për Eliminimin

⁵⁴ Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

⁵⁵ CRPD Committee, *General Comment No. 5 (2017) on Article 19 - Living independently and being included in the community*, CRPD/C/GC/5, 27 October 2017, paras. 16-23, 28, 30-32.

CRPD Committee, *General Comment No. 1 (2014) on Article 12 - Equal recognition before the law*, CRPD/C/GC/1, 19 May 2014, paras. 26-29, 40

⁵⁶ European Commission, *Union of Equality: Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030*, COM(2021) 101 final, Brussels, 3 March 2021, pp. 5-9, 13-16.

⁵⁷ European Pillar of Social Rights, Proclamation by the European Parliament, the Council and the European Commission, Gothenburg, 17 November 2017, Principle 17 (Inclusion of persons with disabilities) and Principle 18 (Long-term care).

⁵⁸ European Expert Group on the Transition from Institutional to Community-based Care (EEG), *Common European Guidelines on the Transition from Institutional to Community-based Care*, Brussels, 2012.

European Commission, *Guidance on the use of European Structural and Investment Funds in the transition from institutional to community-based care*, Brussels, 2014.

e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)⁵⁹ dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës⁶⁰, të cilat kërkojnë që gratë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në shërbime sociale, mbrojtje nga dhuna dhe mbështetje komunitare. Në mënyrë të veçantë, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)⁶¹ kërkon që shërbimet e mbrojtjes, strehëzat, mekanizmat e raportimit dhe procedurat mbrojtëse të jenë të aksesueshme për gratë me aftësi të kufizuara, duke njohur rrezikun më të lartë të dhunës dhe pengesat në aksesin në drejtësi dhe shërbime mbështetëse.

Në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara, korniza strategjike mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, e cila garanton të drejtën e çdo fëmije për mbrojtje, zhvillim, pjesëmarrje dhe përfshirje pa diskriminim, si dhe kërkon që shtetet të sigurojnë mbështetje të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Në përputhje edhe me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht nenin 7 mbi fëmijët me aftësi të kufizuara, politikat publike duhet të sigurojnë që interesi më i lartë i fëmijës të jetë parimi udhëheqës në çdo vendimmarrje dhe që fëmijët të kenë mundësi të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të dëgjohen.

Gjithashtu, Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve⁶² dhe politikat evropiane për mbrojtjen e fëmijëve⁶³ kërkojnë shmangien e institucionalizimit, zhvillimin e shërbimeve mbështetëse për familjen, ndërhyrjen e hershme dhe shërbimet komunitare për të parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja për shkak të aftësisë së kufizuar. Kjo nënkupton se sistemi i mbrojtjes sociale duhet të ofrojë mbështetje të personalizuar për fëmijët dhe kujdestarët e tyre, shërbime rehabilituese, mbështetje psiko-sociale dhe mekanizma mbrojtës nga dhuna, neglizhenca dhe izolimi social.

Në fushën e emergjencave dhe fatkeqësive natyrore, Plani mbështetet në Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030⁶⁴, e cila kërkon përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në planifikimin, reagimin dhe rimëkëmbjen pas fatkeqësive. Korniza Sendai parashikon sisteme paralajmërimi të hershëm të aksesueshëm, plane evakuimi gjithëpërfshirëse dhe rindërtim të aksesueshëm, duke e konsideruar përfshirjen e aftësisë së kufizuar si pjesë të menaxhimit të rrezikut dhe jo vetëm të reagimit humanitar.

⁵⁹ United Nations, *Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (CEDAW)*, 18 December 1979, Articles 2, 12 and 14.

CEDAW Committee, *General Recommendation No. 18: Disabled Women*, 1991;

⁶⁰ United Nations, *Convention on the Rights of the Child*, 20 November 1989, Articles 2, 19 and 23.

Committee on the Rights of the Child, *General Comment No. 9 (2006): The rights of children with disabilities*, CRC/C/GC/9, 27 February 2007, paras. 8, 13, 39-42, 66.

⁶¹ Council of Europe, *Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention)*, CETS No. 210, Istanbul, 11 May 2011, Articles 18(3), 20, 22, 23 and 25.

⁶² United Nations General Assembly, *Guidelines for the Alternative Care of Children*, A/RES/64/142, 24 February 2010.

⁶³ Committee on the Rights of the Child, *General Comment No. 9 (2006): The rights of children with disabilities*, CRC/C/GC/9, 27 February 2007.

European Commission Recommendation (EU) 2021/1004, *Establishing a European Child Guarantee*, 14 June 2021

⁶⁴ United Nations Office for Disaster Risk Reduction. (2015). *Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015-2030*. United Nations

Në nivel kombëtar, kjo fushë lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030⁶⁵, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030⁶⁶, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030⁶⁷, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026⁶⁸ dhe Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030⁶⁹, si dhe me procesin e përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian⁷⁰, veçanërisht Kapitullin 19 (politikat sociale dhe përfshirja sociale) dhe Kapitullin 23 (të drejtat themelore). Në këtë kuadër, plani synon ndërtimin e një sistemi të integruar, ku pagesat sociale, vlerësimi funksional, shërbimet komunitare, jetesa e pavarur, strehimi dhe mbështetja individuale funksionojnë së bashku për të parandaluar varfërinë, institucionalizimin dhe përjashtimin social dhe për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

4.5.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i Politikës: Të gjithë personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri duhet të kenë mundësi reale dhe të barabarta, për të jetuar në komunitet, me zgjedhje dhe kontroll mbi jetën e tyre, përmes strehimit të aksesueshëm, mbështetjes individuale, shërbimeve të bazuara në komunitet dhe njohjes së plotë të kapacitetit ligjor, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Qëllimit në fushën e mbrojtjes sociale, do të arrihet përmes 6 objektiveve, të detajuar në 11 masa prioritare dhe 72 ndërhyrje konkrete të buxhetuara.

Objektivi Specifik 1: *Përmirësimi i cilësisë së jetesës për personat me aftësi të kufizuara, përmes skemave financiare të përshtatshme, transparente dhe të afta për të përballuar rreziqet e ndryshme.*

Masat prioritare

1.1 Konsolidimi dhe përmirësimi i skemës së pagesave të aftësisë së kufizuar, për të garantuar rritjen e masës së përfitimit, për të mbuluar kostot që lidhen me aftësinë e kufizuar, por edhe skemave të tjera mbështetëse financiare (NE etj) për të garantuar akses, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre me ndikim zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë;

⁶⁵ Vendimi nr. 152, datë 13.03.2024, *Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj*, Këshilli i Ministrave, Fletore Zyrtare.

⁶⁶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 88, datë 22 shkurt 2023, botuar në *Fletoren Zyrtare nr. 31*

⁶⁷ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30 qershor 2021,

⁶⁸ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

⁶⁹ Ministria e Mbrojtjes. (2023). *Strategjia kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2023-2030 dhe plani i veprimit*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

⁷⁰ European Commission. (2023). *Albania 2023 report*. European Union.

European Union. (2016). *EU acquis and negotiation chapters*. Publications Office of the European Union.

1.2 Konsolidimi i vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar me qëllim adresimin efektiv dhe të përgjegjshëm gjinor të nevojave individuale të tyre.

Ky objektivi synon të vendosë themelet e një sistemi mbrojtjeje sociale që garanton siguri ekonomike dhe akses real në mbështetje për personat me aftësi të kufizuara. Qasja e planit është që mbrojtja sociale të mos kufizohet vetëm në dhënien e një përfitimi monetar, por të funksionojë si një mekanizëm i plotë mbështetjeje, i cili parandalon varfërinë, redukton pabarazitë dhe krijon kushtet minimale për pjesëmarrje në jetën shoqërore.

Në kuadër të masës së parë prioritare, Plani parashikon përmirësimin e skemës së pagesave të aftësisë së kufizuar përmes rishikimit të mekanizmit indeksues periodik të këtyre pagesave për t'iu përgjigjur situatave të krizave dhe emergjencave në përshtatje me nevojat e posaçme të individëve. Përgatitja e mekanizmave fleksibël mbështetës në situata emergjence dhe krize, parashikon mbështetje të posaçme për personat me aftësi të kufizuara në rast fatkeqësish natyrore, krizash shëndetësore apo zhvendosjeje. Kjo e kthen skemën financiare në një instrument rezistence sociale dhe jo vetëm një pagesë periodike.

Masa e dytë prioritare lidhet me konsolidimin e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, i cili përbën elementin më transformues të këtij objektivi. Rishikimi i kritereve të vlerësimit për të rritur dhe për fëmijë, përfshirja e komponentit gjinor dhe përafrimi me klasifikimet ndërkombëtare do të sigurojnë një proces më të drejtë dhe më të saktë vlerësimi. Njëkohësisht, Plani parashikon përmirësimin e infrastrukturës së vlerësimit, rritjen e kapaciteteve profesionale të strukturave zbatuese dhe forcimin e funksioneve monitoruese dhe kontrolluese. Analizat periodike të impaktit të skemës, vlerësime të kënaqësisë së përfituesve dhe fushata informimi të aksesueshme, do të ndikojnë në përmirësime të mëtejshme dhe do orientojnë që personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre të kuptojnë të drejtat dhe procedurat.

Një ndërhyrje e rëndësishme është lidhja e drejtpërdrejtë e vlerësimit me mbështetjen. Personi i vlerësuar nuk do të përfitojë vetëm pagesën e aftësisë së kufizuar, por do të përfshihet edhe në një mekanizëm referimi dhe menaxhimi rasti. Përmes profileve individuale të nevojave dhe ekipeve shumëdisiplinore, do të referohet në shërbime sociale, shëndetësore, arsimore, rehabilituese, shërbime të formimit profesional dhe punësimin, si edhe në pajisje dhe teknologji ndihmëse. Integrimi i sistemit të informacionit me sektorët e tjerë do të mundësojë koordinim ndërinstytucional dhe mbështetje të vazhdueshme.

Ky objektivi synon të krijojë një sistem ku pagesat financiare, vlerësimi funksional dhe referimi në shërbime funksionojnë si një mekanizëm i vetëm mbështetës.

Objektivi Specifik 2: *Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore për personat me aftësi të kufizuara, si dhe avancimi i deinstitucionalizimit, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë.*

Masat prioritare

2.1 Përmirësimi i sistemit të planifikimit për shërbime të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, udhëhequr nga parimet e qasjes duale dhe shërbimeve në përputhje me moshën dhe nevojat.

Plani i Veprimit parashikon rishikimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimet e qasjes duale dhe të ofrimit të shërbimeve përgjatë gjithë ciklit të jetës. Në këtë kuadër synohet përmirësimi i standardeve ekzistuese dhe hartimi i standardeve të reja për shërbimet sociale, në përputhje me Kornizën e Standardeve Bazë të Cilësisë për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, duke integruar në mënyrë sistematike elementët e aksesueshmërisë dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në çdo shërbim, qoftë gjithëpërfshirës apo specifik.

Një drejtim i rëndësishëm i ndërhyrjes është përmirësimi i mekanizmave të referimit dhe koordinimit ndërinstitutional, përmes rishikimit të protokolleve dhe procedurave operacionale që lidhen me komisionet bio-psiko-sociale të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Kjo synon të forcojë ndërveprimin ndërmjet institucioneve dhe shërbimeve, duke mundësuar një menaxhim më të integruar të rastit dhe lidhjen më efektive midis procesit të vlerësimit dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse.

Në të njëjtën kohë, plani parashikon realizimin e një vlerësimi të situatës së fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në lidhje me nevojën për shërbime alternative, përfshirë analizën e skenarëve të mundshëm të mbështetjes, hartimin e planeve individuale dhe kostimin e tyre.

Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punësimit, do të ndërveprojnë për të ndërtuar një mbështetje të koordinuar dhe të personalizuar. Vlerësimet e situatës dhe planet individuale do të shërbejnë për të planifikuar shërbimin më të përshtatshëm për çdo individ, duke marrë parasysh moshën, nivelin e funksionimit dhe preferencat personale. Ky proces do të shërbejë si bazë për planifikimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe për orientimin më të mirë të burimeve financiare.

Një rol qendror në këtë proces do të ketë pushteti vendor. Bashkitë do të fuqizohen në planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve të integruara komunitare, përmes udhëzimeve, standardeve dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale. Qasja e Planit synon, që shërbimet e integruara sociale të mos jenë të përqendruara vetëm në disa zona urbane, por të shtrihen në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin, përfshirë zonat rurale. Për këtë arsye parashikohet zhvillimi i shërbimeve lëvizëse dhe edhe ofrimi i mbështetjes/këshillimit në distancë, për të reduktuar izolimin social dhe mungesën e aksesit.

Një element kyç i objektivit është zhvillimi i ndërhyrjes së hershme për fëmijët 0-6 vjeç, përmes një sistemi i cili do të lidhë identifikimin e hershëm me ndërhyrjen rehabilituese dhe më pas me tranzicionin drejt arsimit, shërbimeve shëndetësore dhe sociale, duke krijuar vazhdimësi të mbështetjes gjatë gjithë jetës. Kjo qasje synon të parandalojë përkeqësimin e funksionimit dhe të zvogëlojë nevojën për ndërhyrje intensive në faza të mëvonshme.

Në të njëjtën kohë, Plani parashikon zgjerimin e shërbimeve komunitare për të gjitha grupmoshat: qendra ditore, shërbime rehabilituese, këshillimore dhe psiko-sociale, si dhe shërbime mbështetëse për të moshuarit me aftësi të kufizuara. Mbështetje do të ofrohet edhe për familjet përmes shërbimeve për prindërit dhe kujdestarët, përfshirë *respite care*, me qëllim lehtësimin e barrës së kujdesit dhe parandalimin e izolimit social të familjes.

Një drejtim i rëndësishëm i këtij objekti është avancimi i procesit të deinstitucionalizimit, me fokus sigurimin e jetesës në komunitet dhe parandalimin e institucionalizimit. Në këtë kuadër plani parashikon mbështetjen për zhvillimin e shërbimeve të reja komunitare, përfshirë ngritjen e modeleve të shtëpive familje për të rriturit e vetmuar me aftësi të kufizuara dhe në rrezik institucionalizimi, si dhe zhvillimin e modelit të kujdestarisë alternative për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimet e mbështetura për të rinjtë mbi 14 vjeç dhe mbështetja për të rriturit e vetmuar ose në rrezik institucionalizimi. Përmes këtyre ndërhyrjeve synohet që kujdesi institucional të përdoret vetëm si masë e fundit, ndërsa prioritet t'i jepet mbështetjes në familje dhe në komunitet.

Për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit, Plani parashikon zhvillimin e standardeve të reja të shërbimeve dhe përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë në mjedis, informacion, komunikim dhe transport në çdo shërbim social. Po ashtu, ai parashikon fuqizim kapacitetesh të stafeve për parandalimin e institucionalizimit dhe për ofrimin e shërbimeve alternative, ndërsa monitorimi do të forcohet përmes bazës së të dhënave, treguesve të performancës dhe vlerësimeve periodike të nevojave dhe cilësisë së shërbimeve.

Në mënyrë të veçantë, vlerësimi i cilësisë do të bazohet edhe në perceptimin e vetë personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre, duke analizuar nëse shërbimet plotësojnë realisht nevojat, frekuencën dhe efektivitetin e mbështetjes, si dhe cilësinë e komunikimit me stafin.

Përmes këtyre ndërhyrjeve synohet krijimi i një sistemi shërbimesh sociale më të koordinuar, të aksesueshëm dhe të orientuar drejt nevojave individuale, i cili mbështet përfshirjen sociale dhe jetesën në komunitet të personave me aftësi të kufizuara gjatë gjithë ciklit të jetës.

Objektivi Specifik 3: *Të mundësohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri të kenë mundësi reale dhe të barabarta për të jetuar në komunitet, me zgjedhje dhe kontroll mbi jetën e tyre, përmes strehimit të aksesueshëm, mbështetjes individuale, shërbimeve të bazuara në komunitet dhe njohjes së plotë të kapacitetit ligjor, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.*

Masat prioritare

- 3.1 Garantimi i së drejtës për të jetuar në komunitet përmes strehimit të aksesueshëm, shërbimeve mbështetëse në banesë dhe alternativave komunitare ndaj institucionalizimit;
- 3.2 Krijimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar të Shërbimit të Ndihmës Personal në mbështetje të jetesës së pavarur;

3.3 Njohja e plotë para ligjit dhe zëvendësimi i kujdestarisë ligjore me sistemin e vendimmarrjes së mbështetur.

Ky objektiv përfaqëson thelbin e reformës së mbrojtjes sociale dhe kalimin nga një model kujdesi tradicional drejt një modeli të jetesës së pavarur. Në praktikë, shumë persona me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jetojnë në kushte varësie nga familja, ose përballen me rrezik institucionalizimi për shkak të mungesës së strehimit të përshtatshëm, shërbimeve mbështetëse dhe autonomisë ligjore. Plani 2026-2030 synon të krijojë kushtet reale që individit të ketë zgjedhje mbi jetën e tij, ku jeton, me kë jeton dhe si organizon jetën e përditshme.

Në radhë të parë, ndërhyrjet fokusohen tek strehimi. Do të realizohet një studim kombëtar për të identifikuar nevojat reale për strehim të aksesueshëm dhe për të përcaktuar rrezikun e institucionalizimit. Programet publike të strehimit social do të vijojnë të përfshijnë kuota të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara dhe subvencione qiraje, ndërsa informacioni mbi përfitimin do të ofrohet në formate të aksesueshme. Një element i ri është përcaktimi i standardeve të detyrueshme të aksesueshmërisë për banesat sociale, me qëllim shmangien e segregimit dhe krijimin e banimit të integruar në komunitet. Në nivel vendor, do të hartëzohen personat në rrezik institucionalizimi dhe do të zhvillohen modele të ndryshme të strehimit komunitar, përfshirë shtëpitë e mbështetura për personat që nuk mund të jetojnë plotësisht të pavarur.

Paralelisht me strehimin, Plani parashikon zhvillimin e paketës së shërbimeve të jetesës së pavarur në banesë. Kjo nënkupton që personi nuk do të jetë i detyruar të largohet nga komuniteti për të marrë kujdes, pasi mbështetja do të ofrohet në vendbanim përmes shërbimeve sociale dhe mbështetjes individuale.

Shtylla kryesore e këtij transformimi është krijimi i shërbimit të ndihmës personal. Për herë të parë synohet ndërtimi i një programi kombëtar të strukturuar, të standardizuar dhe të financuar publikisht, që i jep individit kontroll real mbi jetën e tij të përditshme. Do të kryhet një analizë e plotë ligjore dhe funksionale e skemave ekzistuese, do të hartohet kuadri ligjor dhe nënligjor, standardet e shërbimit, procedurat e vlerësimit dhe skema e financimit. Përfituesit dhe ndihmësit personalë do të trajtohen për të menaxhuar shërbimin, ndërsa sistemi do të pilotohet fillimisht tek personat me aftësi të kufizuara të thella dhe ata në rrezik institucionalizimi. Njëkohësisht, do të krijohen mekanizma monitorimi, ankimi dhe informimi publik, si dhe do të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi për këtë të drejtë. Krahas ndihmës personal, do të promovohet edhe mbështetja nga të ngjashmit (*peer support*), si një formë fuqizimi dhe përfshirjeje sociale.

Elementi i tretë i objektivit lidhet me autonominë ligjore. Aktualisht, një pjesë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psiko-sociale, janë subjekt i heqjes / kufizimit së zotësisë për të vepruar dhe vendimmarrjes nga kujdestarët. Plani synon zëvendësimin gradual të këtij sistemi me vendimmarrjen e mbështetur. Për këtë arsye, do të realizohet analizë e plotë ligjore, rishikim i kodeve dhe ligjeve kryesore, si dhe ngritje e mekanizmave të rinj ligjorë që respektojnë vullnetin dhe preferencat e individit. Parashikohet gjithashtu trajnimi i profesionistëve të sistemit të drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale,

si dhe zhvillimi i materialeve udhëzuese dhe fushatave informuese për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.

Ky objektiv synon të krijojë një ndryshim thelbësor nga një sistem që mbështetet në kujdesin institucional dhe vendimmarrjen për individin, drejt një sistemi që garanton autonomi personale, jetesë në komunitet dhe pjesëmarrje të plotë sociale.

Objektivi specifik 4: *Të garantohet mbrojtja efektive e të drejtave, dinjitetit dhe barazisë së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga të gjitha format e dhunës, duke adresuar diskriminimin e shumëfishtë dhe duke siguruar akses të plotë dhe të përshtatur në shërbime, mekanizma mbrojtës dhe drejtësi.*

Masat prioritare

- 4.1 Garantimi i aksesueshmërisë dhe përshtatjes së shërbimeve, mekanizmave të referimit dhe procedurave për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, viktime të dhunës;
- 4.2 Parandalimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në familje dhe komunitet, përmes ndërgjegjësimit, forcimit të raportimit, mbrojtjes dhe ndërhyrjes së hershme, të bazuara në evidencë;
- 4.3 Mundësimi i një qasjeje të plotë, të informuar dhe pa diskriminim në shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues, duke respektuar autonominë dhe të drejtat riprodhuese të grave me aftësi të kufizuara.

Ky objektiv adreson një nga sfidat më të ndjeshme dhe më pak të raportuara, dhunën dhe abuzimin ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, të cilat përballen shpesh me diskriminim të shumëfishtë dhe barriera të shtuara në aksesin në shërbime, mbrojtje dhe drejtësi. PKVPAK 2026-2030 synon të garantojë që sistemi i mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të dhunës me bazë gjinore të përshtatet realisht për nevojat e grave me aftësi të kufizuara, duke zvogëluar pengesat fizike, procedurale, të komunikimit dhe të qëndrimeve.

Në kuadër të masës prioritare 4.1, Plani parashikon fillimisht krijimin e një baze të qartë, evidence mbi nivelin e aksesueshmërisë në shërbimet ekzistuese. Auditimi i aksesueshmërisë në të gjitha qendrat, që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat viktime të dhunës, do të shërbejë si pikënisje për të identifikuar boshllëqet konkrete në ambiente, shërbime, komunikim dhe procedura. Mbi këtë bazë, do të përcaktohen tregues minimalë për monitorimin e aksesueshmërisë dhe efektivitetit të masave, me qëllim që përmirësimet të mos jenë sporadike, por të matshme dhe të raportueshme.

Plani synon të garantojë, që shërbimet për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të jenë të aksesueshme në mënyrë të plotë, pra jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë digjital, si dhe të pranishme dhe funksionale në të gjitha mjediset, ku gratë me aftësi të kufizuara përballen me rrezik të shtuar (p.sh. në institucione, në izolim familjar, në zona të largëta). Një element kyç është zbatimi sistematik i akomodimit të arsyeshëm, duke përfshirë edhe akomodimin procedural në aksesin në drejtësi (p.sh. mënyra e marrjes në pyetje, afatet, prania e mbështetjes së nevojshme, interpretimi në gjuhë shenjash, formatet e komunikimit të përshtatura). Kjo qasje lidhet drejtpërdrejt me integrimin e kritereve specifike të aftësisë së kufizuar në procedurat e vlerësimit

të riskut dhe menaxhimit të rasteve nga mekanizmat e koordinuar të referimit, në mënyrë që rreziku të mos nënvlerësohet dhe ndërhyrjet të jenë të personalizuara.

Për të forcuar cilësinë e ndërhyrjes, Plani parashikon rishikimin e standardeve të shërbimeve për qendrat e trajtimit të viktimave të dhunës dhe viktimave të trafikimit, duke i përafuar me standardet e KDPAK, Konventës së Stambollit dhe Direktivës së BE-së 1385/2024. Kjo nënkupton jo vetëm rishikim dokumentesh, por edhe riformulimin të protokolleve të punës, rolit të stafit, burimeve njerëzore dhe zbatimin e një qasjeje shumëdisiplinore dhe individuale për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Për ta bërë të zbatueshme këtë qasje, do të realizohen vlerësime të nevojave për trajnime dhe do të strukturohen programe të financuara trajnimi për stafin e shërbimeve, duke synuar të rritet aftësia e ndërveprimit profesional me gratë me aftësi të kufizuara.

Masa prioritare 4.2 e zhvendos fokusin edhe tek parandalimi dhe ndërhyrja e hershme, duke pranuar se dhuna shpesh ndodh në mjedise, ku raportimi është i vështirë ose i pamundur, veçanërisht kur gruaja është e varur nga familja/ndihmësi personal ose jeton në izolim. Plani parashikon fushata ndërgjegjësimi me materiale në formate të aksesueshme, që synojnë të rrisin njohjen e të drejtave, identifikimin e shenjave të dhunës dhe rrugët e raportimit. Ndërkohë, akses i vazhdueshëm në informacion do të garantohet sa më afër mjediseve, ku jetojnë gratë me aftësi të kufizuara, përmes fuqizimit të aktorëve kyç të vijës së parë: mjeku i familjes, administratori shoqëror, punonjësi social dhe psikologu i shkollës.

Në të njëjtën linjë, do të zhvillohen programe të synuara për familjarët dhe kujdestarët, pasi në shumë raste pikërisht varësia nga kujdesi dhe mungesa e rrjeteve alternative e rrit rrezikun e abuzimit. Një element shumë i rëndësishëm i masës 4.2 është përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave, të ndara sipas gjinisë dhe llojit të aftësisë së kufizuar, me standarde të qarta për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Plani parashikon edhe zbatimin e rekomandimeve të organeve të të drejtave të njeriut dhe integrimin e çështjeve të grave me aftësi të kufizuara, në mekanizmat ekzistues të parandalimit dhe raportimit të dhunës, duke e bërë këtë temë pjesë të qëndrueshme të qeverisjes së politikave gjinore.

Masa prioritare 4.3 adreson një dimension shpesh të lënë jashtë në mbrojtjen sociale, të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye do të sigurohet informacion në formate të aksesueshme (Braille, audio, gjuhë e thjeshtuar, gjuhë shenjash), do të zhvillohen trajnime për personelin shëndetësor mbi komunikimin etik, pëlqimin e informuar dhe vendimmarrjen e mbështetur dhe do të hartohen protokolle standarde që garantojnë pëlqimin e informuar për çdo shërbim. Njëkohësisht, do të hartohen protokolle, që ndalojnë praktikën diskriminuese, si sterilizimi i detyruar apo ndërhyrjet pa pëlqim, duke respektuar autonominë dhe integritetin e grave me aftësi të kufizuara.

Objektivi 5: *Fëmijët me aftësi të kufizuara gëzojnë plotësisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, duke pasur gjithmonë parasysh interesin më të lartë të tyre, me fokus mbështetjen e përshtatshme sipas moshës dhe nevojave individuale.*

Masa prioritare

5.1 Përforcimi i mbrojtjes nga dhuna dhe diskriminimi përmes fuqizimit të kapaciteteve, shërbimeve të integruara, forcimit të sistemeve të të dhënave, monitorimit dhe raportimit.

Ky objektivi synon të vendosë në qendër të politikave të mbrojtjes sociale fëmijën me aftësi të kufizuara, si mbajtës të drejtash dhe jo vetëm si përfitues shërbimesh. Plani synon që mbrojtja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të mos trajtohet si çështje sektoriale, por si përgjegjësi e integruar e sistemit të mbrojtjes së fëmijës, ku çdo institucion që ndërvepron me fëmijën ka rol në identifikimin e rrezikut, parandalimin e dhunës dhe ofrimin e mbështetjes së përshtatshme.

Një nga sfidat kryesore është fakti, që fëmijët me aftësi të kufizuara janë më të ekspozuar ndaj neglizhencës, dhunës dhe izolimit social, ndërkohë që rastet shpesh mbeten të paidentifikuara për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale dhe barrierave në komunikim. Për këtë arsye, Plani parashikon rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë, mësuesve, edukatorëve, punonjësve socialë, stafit shëndetësor dhe personelit të qendrave të zhvillimit, në identifikimin e hershëm të dhunës, raportimin dhe menaxhimin e rasteve. Trajnimet do të fokusohen në përdorimin e metodave praktike dhe studimeve të rasteve konkrete, në mënyrë që profesionistët të kuptojnë shenjat e abuzimit edhe kur fëmija ka vështirësi komunikimi ose nuk është në gjendje të raportojë vetë.

Paralelisht, Plani parashikon fuqizimin e prindërve dhe kujdestarëve, përmes informimit dhe trajnimit mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, format e dhunës dhe mekanizmat e raportimit. Qëllimi është që familja të mos mbetet vetëm bartëse e përgjegjësisë së kujdesit, por të bëhet partner aktiv në mbrojtjen e fëmijës dhe në identifikimin e hershëm të rrezikut. Në rastet kur dhuna apo diskriminimi ndodh, fëmijët dhe familjet e tyre do të kenë akses në mbështetje psiko-sociale të përshtatur, sipas moshës, të ofruar në institucione arsimore dhe në shërbime komunitare, duke shmangur ndërhyrjet e vonuara ose të fragmentuara.

Një rol kyç do të kenë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel vendor, të cilat do të fuqizohen për të përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara në planet, programet dhe raportimet e tyre. Kjo do të thotë që menaxhimi i rasteve, vlerësimi i riskut dhe ndërhyrjet mbrojtëse do të përshtaten për nevojat specifike të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke marrë në konsideratë komunikimin alternativ, mbështetjen e specializuar dhe përfshirjen e shërbimeve të tjera sektoriale.

Objektivi specifik 6: *Forcimi i një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësive dhe krizave në Shqipëri, në nivel qendror dhe lokal, me fokus të veçantë te personat me aftësi të kufizuara, për të garantuar sigurinë e jetës dhe mbrojtjen e tyre.*

Masat prioritare

6.1 Integrimi i aftësisë së kufizuar në politikat dhe kuadrin ligjor për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Ky objektivi adreson sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata emergjente, fatkeqësi natyrore dhe kriza humanitare. Përvoja ndërkombëtare dhe situatat e fundit të emergjencave kanë treguar se personat me aftësi të kufizuara janë ndër grupet më të rrezikuara gjatë fatkeqësive, jo

për shkak të aftësisë së kufizuar në vetvete, por për shkak të mungesës së planifikimit gjithëpërfshirës, informacionit të aksesueshëm dhe mekanizmave të përshtatur të evakuimit dhe mbështetjes.

PKVPAK synon që sistemi i menaxhimit të emergjencave të mos ndërhyjë vetëm pas krizës, por të përfshijë personat me aftësi të kufizuara që në fazën e parandalimit dhe planifikimit. Hapi i parë do të jetë rishikimi i kuadrit ligjor dhe strategjik të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, për të siguruar përfshirjen e detyrimeve të qarta për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo do të thotë që aftësia e kufizuar të mos trajtohet si çështje ndihme humanitare, por si element i detyrueshëm i politikave të sigurisë civile.

Në këtë drejtim, legjislacioni dhe planet e emergjencave do të integrojnë kërkesa specifike për aksesueshmërinë e njoftimeve të hershme, të sistemeve të alarmit dhe të procedurave të evakuimit. Synimi është që paralajmërimet për rrezik të jenë të kuptueshme dhe të arritshme për të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë komunikimin alternativ dhe teknologjitë asistive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për personat me dëmtime të dëgjimit, shikimit, intelektuale apo psiko-sociale, të cilët shpesh nuk përfitojnë nga sistemet standarde të njoftimit.

Plani parashikon edhe hartimin e udhëzimeve specifike për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave që adresojnë nevojat individuale të personave me aftësi të kufizuara. Këto udhëzime do të kenë një fokus të veçantë tek institucionet rezidenciale dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, ku rreziku është më i lartë për shkak të varësisë nga mbështetja e vazhdueshme. Për këtë arsye, do të hartohen protokolle operacionale të detajuara për evakuimin, strehimin e përkohshëm dhe shpërndarjen e ndihmës humanitare në mënyrë të aksesueshme dhe të sigurt për çdo kategori të aftësisë së kufizuar.

Një element i rëndësishëm i objektivit është ndërtimi i kapaciteteve institucionale. Administrata publike, strukturat e emergjencave civile dhe pushteti vendor do të trajnohen mbi qasjen gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar në situata krize. Trajnimet synojnë të sigurojnë që personeli të jetë i përgatitur për të identifikuar nevojat specifike, për të komunikuar në mënyrë të përshtatshme dhe për të ofruar mbështetje të sigurt gjatë evakuimit, strehimit dhe shpërndarjes së ndihmës.

4.6 Shëndetësia

4.6.1 Korniza Strategjike

Fusha e shëndetësisë në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 mbështetet në një ndryshim thelbësor të mënyrës se si konceptohet kujdesi shëndetësor, nga një model tradicional, i fokusuar kryesisht në diagnozën dhe trajtimin mjekësor, drejt një sistemi të bazuar në të drejtat e njeriut, funksionimin dhe pjesëmarrjen sociale. Sistemi shëndetësor konsiderohet një faktor kyç për parandalimin e përjashtimit social dhe për mundësimin e jetesës së pavarur.

Në nivel ndërkombëtar, ky kapitull mbështetet para së gjithash në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)⁷¹, e cila përcakton qartë se personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit, pa diskriminim dhe pa barriera në akses. Konventa kërkon që shërbimet shëndetësore të jenë të aksesueshme, të përballueshme dhe të bazuara në pëlqimin e informuar të individit, duke përfshirë shërbimet për personat me aftësi të kufizuara psiko-sociale, rehabilitimin dhe teknologjitë ndihmëse. Ajo thekson rëndësinë e rehabilitimit si proces që synon ruajtjen dhe zhvillimin e funksionimit dhe jo izolimin institucional. Në të njëjtën kohë, orienton situatat e rrezikut dhe kërkon që sistemet shëndetësore dhe të emergjencave të jenë gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara.

Komentet dhe rekomandimet e Komitetit të KDKPAK⁷² kanë theksuar se pengesat kryesore në fushën e shëndetësisë nuk lidhen vetëm me mungesën e shërbimeve, por me mënyrën se si funksionon sistemi, përfshirë refuzimi i trajtimit për shkak të aftësisë së kufizuar, mungesa e aksesueshmërisë fizike dhe në komunikim, trajtime pa pëlqim të informuar, institucionalizimi i panevojshëm dhe mungesa e shërbimeve komunitare të personave me aftësi të kufizuara psiko-sociale. Për këtë arsye, shtetet inkurajohen të kalojnë nga kujdesi institucional drejt shërbimeve komunitare, të integruara dhe të orientuara nga personi.

Në nivel evropian, kjo qasje përforcohet nga Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁷³, e cila kërkon që sistemet shëndetësore të garantojnë akses universal dhe të barabartë në shërbime shëndetësore dhe rehabilituese, përfshirë aftësinë e kufizuar psiko-sociale dhe teknologjitë ndihmëse. Strategjia e BE-së vendos theks të veçantë tek jetesa e pavarur dhe deinstitutionalizimi, duke kërkuar zhvillimin e shërbimeve komunitare, kujdesit afatgjatë dhe mbështetjes individuale. Këto parime lidhen drejtpërdrejt edhe me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, e cila njih kujdesin shëndetësor dhe kujdesin afatgjatë si të drejta themelore sociale dhe kërkon që personat me aftësi të kufizuara të marrin mbështetjen e nevojshme për autonomi dhe përfshirje në komunitet.

Fusha e shëndetësisë lidhet edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm⁷⁴, veçanërisht me objektivin për shëndet dhe mirëqenie, dhe atë për uljen e pabarazive, të cilat kërkojnë eliminimin

⁷¹ United Nations, Convention on the Rights of Persons with Disabilities (CRPD), United Nations Treaty Series, 2515, 3 (2006), <https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

⁷² United Nations Committee on the Rights of Persons with Disabilities, *Concluding observations on the initial report of Albania* (CRPD/C/ALB/1) (2018), https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/ALB/CO/1&Lang=En

⁷³ European Commission, *EU strategy for the rights of persons with disabilities 2021-2030* (Publications Office of the European Union, 2021), https://commission.europa.eu/publications/eu-strategy-rights-persons-disabilities-2021-2030_en

⁷⁴ United Nations, *Transforming our world: The 2030 agenda for sustainable development* (2015), OZHQ 3 & OZHQ 10, <https://OZHQs.un.org/2030agenda>.

e barrierave në shërbimet shëndetësore për grupet e cenueshme. Në këtë kuadër, shëndetësia nuk shihet vetëm si shërbim publik, por si një mekanizëm i barazisë sociale.

Në nivel kombëtar, kapitulli harmonizohet me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030⁷⁵ dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030⁷⁶, si dhe me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*⁷⁷ të Bashkimit Evropian në fushën sociale dhe të të drejtave themelore. Reforma e sistemit shëndetësor synon të ndërtojë një sistem të integruar ku kujdesi shëndetësor lidhet me mbrojtjen sociale, rehabilitimin, arsimin dhe punësimin, duke shmangur fragmentimin e shërbimeve.

Dokumenti i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, e konsideron shëndetin një element themelor të përfshirjes sociale. Sistemi shëndetësor duhet të jetë i aksesueshëm, të respektojë vendimmarrjen e individit, të sigurojë pëlqim të informuar dhe të ofrojë shërbime komunitare dhe rehabilituese përgjatë gjithë jetës.

4.6.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi i politikës: *Të sigurohet akses i barabartë, cilësor, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.*

Në fushën e shëndetësisë janë parashikuar 3 objektiva specifike, të arritshëm përmes 7 masave prioritare dhe 24 ndërhyrjeve konkrete.

Objektivi Specifik 1: *Ulja e numrit të rasteve të reja dhe e ashpërsisë së aftësisë së kufizuar të evitueshme, si dhe garantimi i kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara gjatë gjithë ciklit të jetës.*

Masat prioritare

1.1. Forcimi i parandalimit dhe diagnostikimit të hershëm;

1.2. Zhvillimi i kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt personave me aftësi të kufizuara.

Ky objektivi përfaqëson një nga ndryshimet më të rëndësishme konceptuale të Planit të ri, kalimin nga një sistem që reagon pasi aftësia e kufizuar është shfaqur, drejt një sistemi që vepron përgjatë gjithë ciklit të jetës për të parandaluar, identifikuar herët dhe menaxhuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët që ndikojnë në funksionimin dhe mirëqenien e individit. Qasja nuk synon reduktimin e faktorëve të evitueshëm dhe minimizimin e pasojave të saj, përmes ndërhyrjeve të hershme dhe kujdesit të vazhdueshëm.

⁷⁵ Republika e Shqipërisë. (2022). *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

⁷⁶ Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

⁷⁷ Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030*. Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Plani fokusohet tek periudha e hershme e jetës, e cila është vendimtare për zhvillimin e fëmijës. Vendosja e protokolleve standarde për kontrollet parandaluese dhe depistimin e hershëm të çrregullimeve zhvillimore për moshën 0-6 vjeç synon që aftësia e kufizuar të mos identifikohet vetëm në momentin kur ajo është e konsoliduar, por në fazat e para të shfaqjes së rrezikut. Përmes bashkëpunimit të shërbimeve shëndetësore, shërbimeve sociale dhe institucioneve parashkollore do të krijohet një sistem i integruar identifikimi, ku pediatri, infermierët e konsultoreve të nënës dhe fëmijës, edukatorët dhe strukturat sociale veprojnë si një rrjet i vetëm referimi. Kjo do të mundësojë ndërhyrje të personalizuara në kohë, duke ulur ashpërsinë e pasojave funksionale dhe duke përmirësuar zhvillimin e fëmijës.

Në të njëjtën linjë, rritja e ndërgjegjësimit dhe mbulimit me vaksinim të fëmijëve me aftësi të kufizuara është pjesë e një qasjeje parandaluese të shëndetit publik. Këta fëmijë shpesh përjashtohen nga programet parandaluese për shkak të barrierave sociale, informacionit të kufizuar ose frikës së familjeve. Angazhimi i komunitetit dhe familjeve synon të sigurojë që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos jenë më një grup me rrezik më të lartë për sëmundje të parandalueshme.

Realizimi i këtij objektivi të Planit, shtrin qasjen përgjatë gjithë jetës së individit, duke vendosur bazat e një sistemi shëndetësor gjithëpërfshirës. Rritja e numrit të ekipeve socio-shëndetësore në kujdesin shëndetësor parësor synon që personi me aftësi të kufizuara të mos jetë i detyruar të kërkojë shërbime të fragmentuara, por të ketë një pikë hyrëse të koordinuar në sistem.

Një element thelbësor i reformës është përcaktimi i standardeve kombëtare për kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës dhe i protokolleve klinike që garantojnë trajtim me dinjitet, respekt dhe pa diskriminim. Vendosja e standardeve do të harmonizojë praktikën klinike dhe do të kërkojë që sistemi shëndetësor të përshtatet ndaj pacientit dhe jo e kundërta.

Pjesë e rëndësishme e objektivit është edhe garantimi i aksesit në shëndetin seksual dhe riprodhues në formate të aksesueshme për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar. Po ashtu, krijimi i mekanizmave për trajtim prioritar për personat me aftësi të kufizuara komplekse synon të shmangë vonesat e trajtimit dhe përkeqësimin e gjendjes shëndetësore.

Ky objektivi synon të ndërtojë një sistem shëndetësor që nuk reagon vetëm ndaj sëmundjes, por mbështet funksionimin, autonominë dhe cilësinë e jetës.

Objektivi Specifik 2: *Mundësimi i rehabilitimit cilësor, shërbimeve të shëndetit mendor dhe aksesit në teknologji ndihmëse, të bazuara në komunitet dhe në nevojat individuale*

Masat prioritare

- 2.1 Forcimi i shërbimeve të rehabilitimit të bazuara në komunitet;
- 2.2 Forcimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara psiko-sociale përmes harmonizimit të kuadrit ligjor dhe zhvillimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;
- 2.3 Aksesit në teknologji dhe mjete ndihmëse.

Ky objektivi adreson vazhdimësinë e kujdesit për personat me aftësi të kufizuara. Së pari, ai synon të forcohen shërbimet e rehabilitimit me bazë komunitare. Kryerja e një vlerësimi kombëtar të

shërbimeve ekzistuese do të krijojë për herë të parë një panoramë të plotë mbi mbulimin territorial, cilësinë dhe aksesueshmërinë e rehabilitimit. Vendosja e standardeve të rehabilitimit, të harmonizuara me qasjen bio-psiko-sociale, do të përcaktojë jo vetëm shërbimin mjekësor, por edhe ndërhyrjet fizio-terapeutike, ergo-terapeutike, logopedike dhe psiko-sociale, duke e konsideruar rehabilitimin një proces të vazhdueshëm që mbështet funksionimin në jetën e përditshme.

Një element themelor i objektivit është reforma në shëndetin mendor. Plani synon kalimin nga modeli institucional drejt shërbimeve komunitare dhe të orientuara nga të drejtat e njeriut. Rishikimi i kuadrit ligjor do të synojë garantimin e pëlqimit të informuar, vendimmarrjes së mbështetur dhe përfshirjes së individit në trajtimin e tij.

Vendosja e standardeve të unifikuara për qendrat komunitare të shëndetit mendor, shtëpitë e mbështetura dhe shërbimet me shtretër do të synojë të sigurojë cilësi të njëjtë të kujdesit në të gjithë vendin. Hartimi i planeve individuale të mbështetjes dhe qasja shumëdisiplinore do të lidhin trajtimin mjekësor me rehabilitimin dhe përfshirjen sociale, duke ulur rrezikun e izolimit dhe institucionalizimit afatgjatë.

Paralelisht, plani trajton një element shumë të rëndësishëm për jetesën e pavarur, aksesin në teknologji dhe mjete ndihmëse. Për shumë persona me aftësi të kufizuara, pajisjet ndihmëse janë parakusht për mobilitet, komunikim, arsimim dhe punësim. Kryerja e një vlerësimi kombëtar të nevojave do të mundësojë planifikim real të mbulimit, ndërsa rishikimi i kuadrit ligjor synon eliminimin e pengesave administrative dhe financiare.

Hartimi i listës prioritare të pajisjeve dhe miratimi i listës kombëtare, në përputhje me standardet ndërkombëtare, do të vendosë një sistem të qëndrueshëm rimbursimi. Standardet për përshkrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve do të garantojnë jo vetëm ofrimin e tyre, por edhe përdorimin efektiv, duke shmangur situatat kur pajisjet shpërndahen, por nuk përdoren për shkak të mungesës së udhëzimit ose përshtatjes.

Objektivi Specifik 3: *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve përmes forcimit të burimeve njerëzore, aksesueshmërisë dhe mekanizmave të monitorimit dhe llogaridhënies.*

Masat prioritare

3.1 Edukimi dhe forcimi i kapaciteteve të personelit shëndetësor;

3.2 Akses i barabartë në mjedise dhe informacion shëndetësor për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Ky objektivi synon të adresojë një problem të rëndësishëm të sistemit shëndetësor. Edhe kur shërbimet ekzistojnë, ato shpesh nuk janë realisht të përdorshme nga personat me aftësi të kufizuara. Pengesat nuk lidhen vetëm me mungesën e strukturave apo pajisjeve, por me mënyrën si organizohet shërbimi, si komunikon personeli dhe si kuptohet roli i pacientit në procesin e kujdesit shëndetësor. Për këtë arsye, Plani e vendos cilësinë e shërbimit në qendër, duke ndërhyrë njëkohësisht në kompetencat profesionale dhe aksesueshmërinë.

Në radhë të parë, përmes zbatimit, do të forcohen kapacitetet e personelit shëndetësor, duke synuar që profesionistët e shëndetit të kalojnë nga një qasje thjesht klinike drejt një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut.

Së dyti, Plani parashikon sigurimin e aksesit të barabartë në mjedise dhe informacion shëndetësor. Përshtatja graduale e infrastrukturës fizike të institucioneve shëndetësore synon që qendrat shëndetësore, poliklinikat dhe spitalet të jenë të përdorshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Paralelisht, informacioni shëndetësor do të ofrohet në formate të ndryshme komunikimi, duke përfshirë materiale të lexueshme, audio, video, gjuhë shenjash dhe formate të tjera alternative. Kjo është thelbësore sepse shumë persona me aftësi të kufizuara nuk përjashtohen nga shërbimi për shkak të trajtimit mjekësor, por për shkak të pamundësisë për të kuptuar informacionin ose për të komunikuar me personelin.

Programet e promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve do të përshtaten për të qenë gjithëpërfshirëse, duke siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mos mbeten jashtë informimit publik për shëndetin. Kjo do të rrisë ndërgjegjësimin, përdorimin e shërbimeve dhe parandalimin e ndërlikimeve shëndetësore që shpesh lidhen me mungesën e aksesit në informacion.

Ky objektivi synon krijimin e një sistemi shëndetësor ku vlerësimi nuk bazohet vetëm në sasinë e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, por edhe në funksionalitetin dhe efektivitetin e tyre për përdoruesit. Përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale, aksesueshmërisë fizike dhe komunikimit të përshtatur, personi me aftësi të kufizuara trajtohet si pacient i barabartë, me të drejtën për informacion, zgjedhje dhe pjesëmarrje.

4.7 Përfshirja në jetën publike dhe politike

4.7.1 Korniza strategjike

Fusha e përfshirjes në jetën publike dhe politike në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 synon të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të mos mbeten vetëm përfitues të politikave publike, por të jenë pjesëmarrës aktivë në vendimmarrje, përfaqësim dhe në jetën demokratike, kulturore e sportive të vendit. Qasja e Planit bazohet në parimin se demokracia funksionale dhe gjithëpërfshirëse, kërkon pjesëmarrje reale të çdo qytetari dhe se aftësia e kufizuar nuk duhet të përbëjë pengesë për ushtrimin e të drejtave politike, përfaqësimin në institucione apo pjesëmarrjen në jetën kulturore e komunitare.

Në nivel ndërkombëtar, kjo fushë mbështetet drejtpërdrejt në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁷⁸, e cila garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të votuar, për t'u zgjedhur, për të marrë pjesë në administrimin e çështjeve publike dhe në organizatat e shoqërisë civile. Konventa kërkon që shtetet të sigurojnë procedura, ambiente dhe

⁷⁸ Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

materiale zgjedhore të aksesueshme, të kuptueshme dhe të lehta për t'u përdorur, si dhe të mundësojnë votimin e pavarur dhe sekret për çdo person me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, ajo thekson edhe të drejtën për pjesëmarrje në jetën kulturore, rekreative dhe sportive si pjesë e barazisë dhe përfshirjes sociale.

Këto standarde përforcohen nga politikat e Bashkimit Evropian për përfshirjen sociale dhe nga Strategjia e BE për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁷⁹, e cila vendos si prioritet rritjen e pjesëmarrjes demokratike, aksesin në procese zgjedhore, përfaqësimin në vendimmarrje dhe eliminimin e barrierave në kulturë, sport dhe aktivitete komunitare. Në këtë kuadër, pjesëmarrja politike dhe publike shihet si element i qytetarisë aktive dhe i barazisë, dhe jo vetëm si e drejtë formale.

Në nivel kombëtar, kjo fushë lidhet me kuadrin ligjor dhe strategjik të Shqipërisë për demokracinë vendore dhe pjesëmarrjen qytetare, përfshirë Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin për vetëqeverisjen vendore, të cilat garantojnë ushtrimin e të drejtës së votës dhe pjesëmarrjen në organet vendimmarrëse. Në mënyrë të veçantë, Plani lidhet me Strategjinë Evropiane për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila thekson rëndësinë e përfaqësimit dhe fuqizimit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe me procesin e përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave themelore dhe antidiskriminimit.

Përfshirja në jetën publike shtrihet edhe përtej proceseve zgjedhore, duke përfshirë pjesëmarrjen në kulturë, art dhe sport. Në këtë drejtim, Plani mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2021-2025⁸⁰ dhe Planin Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore dhe Arsimin Artistik⁸¹, të cilat synojnë zgjerimin e aksesit në aktivitete kulturore dhe artistike për të gjithë qytetarët. Po ashtu, Strategjia Kombëtare e Sportit 2021-2025⁸² promovon sportin gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive, duke e konsideruar sportin si instrument të integritimit social dhe të mirëqenies.

Zbatimi i objektivave të kësaj fushe, ndërton një lidhje të drejtpërdrejtë midis të drejtave politike, përfaqësimit demokratik dhe përfshirjes sociale. Plani synon të krijojë kushte që personat me aftësi të kufizuara të votojnë në mënyrë të pavarur, të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse, të përfaqësojnë interesat e tyre në institucione dhe organizata, si dhe të jenë pjesë aktive e jetës kulturore, artistike dhe sportive të vendit. Në këtë mënyrë, përfshirja publike dhe politike trajtohet jo vetëm si e drejtë qytetare, por si element thelbësor i barazisë, dinjitetit dhe demokracisë funksionale.

4.7.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

⁷⁹ EU Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030

⁸⁰ VKM nr. 107, datë 17.2.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2021-2025 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj”

⁸¹ VKM nr. 448, datë 26.7.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore dhe Arsimin Artistik”

⁸² VKM nr. 715, datë 24.11.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sportit 2021-2025 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj”

Qëllimi politik: *Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre.*

Për arritjen e qëllimit më sipër, janë parashikuar 2 objektiva specifike, 4 masa prioritare dhe 10 ndërhyrje konkrete të buxhetuara.

Objektivi specifik 1: *Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënia e mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje.*

Masat prioritare

- 1.1 Përmirësime ligjore për të mundësuar pjesëmarrjen në votime të të gjithë votuesve me aftësi të kufizuara;
- 1.2 Rritje e ndërgjegjësimit për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore, jo vetëm si votues.

Ky objektivi synon të garantojë që e drejta e votës për personat me aftësi të kufizuara të mos mbetet thjesht një garanci formale, por të jetë e zbatueshme në çdo nivel. Në praktikë, një pjesë e konsiderueshme e personave me aftësi të kufizuara hasin pengesa për të marrë pjesë në proceset zgjedhore, të lidhura me mungesën e informacionit të përshtatur, pamundësinë fizike për të shkuar në qendrat e votimit, procedurat administrative jo fleksibël dhe mungesën e mbështetjes së personalizuar. Plani synon të adresojë këto pengesa në mënyrë sistematike, duke ndërhyrë njëkohësisht në legjislacion, procedura, informacion dhe ndërgjegjësim.

Në radhë të parë, ndërhyrjet fokusohen në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ zgjedhor. Parashikohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë detyrimin të dërgojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të dhëna mbi zgjedhësit me aftësi të kufizuara dhe nevojat konkrete të tyre për pjesëmarrje në votim. Kjo do të mundësojë planifikim paraprak të aksesueshmërisë dhe mbështetjes së nevojshme. Paralelisht, do të përmirësohen dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe procedurat administrative për të siguruar që personat që nuk mund të largohen nga vendbanimi të kenë mundësi reale për të votuar, duke reduktuar kështu përjashtimin faktik nga procesi zgjedhor.

Një element i rëndësishëm i reformës është sigurimi i votimit të pavarur për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psiko-sociale. Kjo do të realizohet përmes përshtatjes së materialeve zgjedhore në formate të thjeshtuara dhe të kuptueshme, në mënyrë që informacioni mbi procedurat dhe alternativat zgjedhore të jetë i aksesueshëm dhe të mos kërkojë ndërmjetësim nga persona të tjerë. Synimi është që çdo zgjedhës të mund të votojë në mënyrë autonome dhe me votë të fshehtë.

Njëkohësisht, sistemi i të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të riorganizohet për të prodhuar statistika mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë numrin e qendrave të votimit të aksesueshme dhe numrin e votuesve që marrin pjesë. Kjo do të krijojë një bazë të qëndrueshme të dhënash për monitorimin e progresit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit zgjedhor.

Përtej ndryshimeve ligjore, plani synon të ndryshojë edhe qasjen sociale ndaj pjesëmarrjes politike. Përmes fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara në bashkëpunim me organizatat e personave me

aftësi të kufizuara, do të promovohet pjesëmarrja aktive në zgjedhje dhe njohja e të drejtave politike. Këto aktivitete do të synojnë të kapërcejnë vetë-përrjashtimin dhe perceptimin se procesi politik nuk është i arritshëm për këtë kategori qytetarësh.

Plani parashikon edhe ndërtimin e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në administrimin e zgjedhjeve, si anëtarë komisionesh apo vëzhgues, duke kaluar nga roli pasiv i votuesit në rolin aktiv të pjesëmarrësit në procesin demokratik. Një hap më tej është promovimi i përfaqësimit në organet e vetëqeverisjes vendore, përmes analizës së mundësisë së kuotave për kandidimin dhe pjesëmarrjen në këshillat bashkiakë, në mënyrë të ngjashme me mekanizmat e barazisë gjinore.

Objektivi synon të transformojë pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara nga një e drejtë teorike në një pjesëmarrje reale dhe aktive. Përmes përmirësimit të legjislacionit, aksesit në votim, informacionit të përshtatur, ndërgjegjësimit dhe përfaqësimit në vendimmarrje, Plani parashikon që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta për të ndikuar në politikat publike dhe për të mbrojtur interesat e tyre si qytetarë të plotë.

Objektivi specifik 2: *Promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike, për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.*

Masa prioritare

1.1 Rritje e aksesit për pjesëmarrje të PAK në aktivitete kulturore e sportive;

1.2 Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve.

Objektivi specifik 2 synon të sigurojë përfshirjen e plotë dhe të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike, kulturore dhe sportive, duke promovuar talentin dhe punën e artistëve me aftësi të kufizuara, si dhe duke rritur mundësitë për pjesëmarrje aktive në aktivitete dhe evenimente kombëtare e ndërkombëtare. Aktualisht, pjesëmarrja e kësaj kategorie mbetet e kufizuar për shkak të barrierave fizike, institucionale dhe sociale, mungesës së programeve të përshtatura dhe kapaciteteve profesionale të pamjaftueshme, si dhe mungesës së të dhënave të strukturuar mbi përfshirjen e tyre.

Nëpërmjet rritjes së aksesit në aktivitete kulturore dhe sportive, institucionalizimit të bashkëpunimit me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, përmirësimit të sistemit të mbledhjes së të dhënave dhe zgjerimit të qendrave gjithëpërfshirëse. Ky objektivi synon të krijojë kushte të barabarta pjesëmarrjeje. Paralelisht, përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale, trajnimit të mësuesve dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në strukturat vendimmarrëse sportive, synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe përfaqësimi i drejtpërdrejtë i tyre.

Zbatimi i këtij objektivi pritet të kontribuojë në fuqizimin social të personave me aftësi të kufizuara, rritjen e dukshmërisë së tyre në shoqëri dhe garantimin e ushtrimit të të drejtës për pjesëmarrje në jetën kulturore, rekreative dhe sportive në kushte të barabarta me të.

4.8 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional

4.8.1 Korniza Strategjike

Korniza strategjike e fushës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030 mbështetet mbi parimin themelor se realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara nuk është përgjegjësi e një sektori të vetëm, por një detyrim ndërsektorial i të gjithë shtetit. Kjo qasje buron drejtpërdrejt nga Konventa e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK⁸³), e cila kërkon që shtetet të sigurojnë koordinim institucional horizontal dhe vertikal për zbatimin efektiv të konventës, përfshirë krijimin e mekanizmave koordinues, monitorues dhe konsultues me organizatat e personave me aftësi të kufizuara (neni 33 i KDPAK). Konventa vendos si standard pjesëmarrjen aktive të organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.

Në këtë kuadër, fusha e bashkëpunimit institucional në Plan synon të shndërrojë parimin “asgjë për ne pa ne” në veprime konkrete, duke e shndërruar konsultimin me organizatat e personave me aftësi të kufizuara nga një praktikë formale në një mekanizëm të strukturuar vendimmarrjeje. Rekomandimet e Komitetit të KDPAK për Shqipërinë kanë theksuar nevojën për forcimin e koordinimit ndërinstitucional, përmirësimin e rolit të mekanizmave kombëtarë të monitorimit dhe mbledhjen sistematike të të dhënave mbi aftësinë e kufizuar për politika të bazuara në evidencë.

Në nivel evropian, kjo qasje përputhet me Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁸⁴, e cila thekson se zbatimi i politikave për aftësinë e kufizuar kërkon integrim të dimensionit të aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat publike - dhe një koordinim të fortë institucional midis sektorëve të punësimit, arsimit, mbrojtjes sociale, drejtësisë, shëndetësisë dhe vetëqeverisjes vendore. Strategjia e BE-së kërkon zhvillimin e sistemeve të të dhënave të harmonizuara dhe të krahasueshme për monitorimin e progresit.

Kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale⁸⁵ dhe me programet e BE-së për përfshirjen sociale, të cilat kërkojnë politika të koordinuara ndërsektoriale për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social dhe për garantimin e aksesit të barabartë në shërbime publike.

Në nivel global, fusha përputhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht objektivin 10 (reduktimi i pabarazive dhe 16 (institucione efektive, transparente dhe gjithëpërfshirëse), si dhe objektivin 17 (partneritete për zhvillim). Këto objektiva kërkojnë institucione funksionale, koordinim ndërinstitucional dhe sisteme të qëndrueshme statistikore për monitorimin e progresit social.

⁸³ Ligji nr. 108/2012 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”

⁸⁴ EU Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030

4 The European Pillar of Social Rights (EPSR)

5The Sustainable Development Goals (OZHQs)

Në nivel kombëtar, kjo fushë lidhet drejtpërdrejt me: (i) Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)⁸⁶, që vendos qeverisjen e mirë, koordinimin institucional dhe politikat e bazuara në evidencë si shtylla të zhvillimit; (ii) Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale⁸⁷, i cili kërkon harmonizim ndërmjet politikave sociale, ekonomike dhe territoriale; (iii) Procesin e integritit evropian, veçanërisht Kapitullin 19 (Politikat sociale dhe punësimi) dhe Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore).

Brenda këtij konteksti, Plani synon të ndërtojë një arkitekturë funksionale qeverisëse për aftësinë e kufizuar, ku: (i) ministritë e linjës të integrojnë dimensionin e aftësisë së kufizuar në politikat sektoriale; (ii) pushteti vendor të jetë aktor kyç në zbatimin e shërbimeve dhe planeve sociale vendore; (iii) Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar të funksionojë si mekanizëm koordinues dhe këshillimor; (iv) sistemi statistikor të prodhojë të dhëna të besueshme për monitorim; (v) organizatat e personave me aftësi të kufizuara të jenë partnerë të përhershëm në hartimin dhe vlerësimin e politikave.

4.8.2 Qëllimi, objektivat dhe masat prioritare

Qëllimi politik: *Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.*

Në fushën e bashkëpunimit, janë parashikuar 4 objektiva specifike, 6 masa prioritare dhe 18 ndërhyrje konkrete.

Objektivi Specifik 1: *Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave qendrore dhe pushtetit vendor dhe ndërveprimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) në të gjitha nivelet.*

Masat prioritare

1.1 Orientimi i bashkive për të fuqizuar bashkëpunimin me MSHMS;

1.2 Fuqizimi i rolit të bashkive dhe promovimi i tyre në njohjen dhe përmbushjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në territorin e tyre.

Ky objektivi synon të adresojë një nga sfidat më të rëndësishme të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri: hendekun midis politikave kombëtare dhe zbatimit të tyre në nivel lokal. Megjithatë kuadri ligjor dhe strategjik për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ekziston në nivel qendror, përfitimet reale për individin materializohen kryesisht në komunitetin ku ai jeton: në bashki, njësi administrative, shkollë, qendër shëndetësore apo shërbim social. Për këtë arsye, Plani e vendos pushtetin vendor në qendër të zbatimit të politikave.

Së pari, ai synon të institucionalizojë bashkëpunimin ndërmjet ministrisë përgjegjëse për aftësinë e kufizuar dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore përmes hartimit të planeve sociale vendore. Kjo do të thotë që politikat për aftësinë e kufizuar nuk do të mbeten më dokumente kombëtare të

⁸⁶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030

⁸⁷ Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, VKM

përgjithshme, por do të përkthehen në plane konkrete territoriale, të bazuara në nevojat reale të komunitetit. Bashkitë do të duhet të identifikojnë personat me aftësi të kufizuara në territor, pengesat që hasin dhe shërbimet që mungojnë, duke i integruar këto në planifikimin lokal dhe në buxhetet e tyre. Në këtë mënyrë krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë midis planifikimit social dhe financimit publik.

Një element kyç është edhe mbështetja financiare progresive për pushtetin vendor. Aktualisht, shumë bashki nuk arrijnë të ofrojnë shërbime për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe kapaciteteve. Për këtë arsye, Plani parashikon rritjen graduale të financimit dhe orientimin e tij drejt shtimit të tipologjive të shërbimeve (shërbime komunitare, mbështetje në familje, këshillim, ndërmjetësim social). Kjo synon të zhvendosë sistemin nga një model i centralizuar drejt një sistemi të decentralizuar të shërbimeve sociale, me bazë komunitare. Në të njëjtën kohë, objektivi nuk fokusohet vetëm tek financimi, por edhe tek kapacitetet institucionale. Përmes hartimit të një guide metodologjike për vlerësimin e nevojave, bashkitë do të kenë një instrument të standardizuar për të analizuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në territor. Kjo është thelbësore sepse aktualisht shumë politika lokale bazohen në kërkesa individuale dhe jo në evidencë. Me këtë ndërhyrje synohet që planifikimi social të bëhet i bazuar në të dhëna dhe jo vetëm në reagim ndaj problematikave.

Një dimension shumë i rëndësishëm i objektivit është përfshirja e organizatave të personave me aftësi të kufizuara. Plani synon që bashkëpunimi mes bashkive dhe OPAK të mos jetë i rastësishëm, por i konsoliduar dhe i strukturuar përmes marrëveshjeve bashkëpunimi dhe takimeve periodike konsultuese. Kjo e transformon konsultimin nga një praktikë formale në një mekanizëm real pjesëmarrjeje, ku personat me aftësi të kufizuara kontribuojnë në identifikimin e nevojave, monitorimin e shërbimeve dhe vlerësimin e politikave lokale.

Po ashtu, përmes promovimit të praktikave të mira dhe shpalljes së bashkive më të mira për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, Plani synon të krijojë një mekanizëm motivues institucional. Kjo ndërhyrje nuk ka vetëm karakter simbolik, ajo synon të nxisë konkurrencë pozitive ndërmjet bashkive, duke i orientuar ato drejt përmirësimit të aksesueshmërisë, shërbimeve dhe përfshirjes sociale.

Objektivi Specifik: *Përmirësimi i funksionimit të KKAK lidhur me koordinimin e politikave publike në nivel horizontal dhe vertikal për personat me aftësi të kufizuara.*

Masat prioritare

- 2.1 Ndjekje dhe monitorim i ndryshimeve legjislative në fushën e aftësisë së kufizuar;
- 2.2 Ndërtimi dhe zbatimi i një plani vjetor aktiviteteve të Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar (KKAK).⁸⁸

⁸⁸ VKM nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e këshillit kombëtar për aftësinë e kufizuar”

Ky objektiv trajton një problem strukturor të politikave për aftësinë e kufizuar, mungesën e koordinimit ndërinstytucional. Politikat që prekin personat me aftësi të kufizuara nuk i përkasin vetëm një ministrie. Ato shtrihen në arsim, shëndetësi, drejtësi, punësim, transport, strehim, mbrojtje sociale dhe qeverisje vendore. Për pasojë, pa një mekanizëm funksional koordinimi, masat mbeten të fragmentuara, ndërhyjnë mbi njëra-tjetrën ose lënë boshllëqe të rëndësishme.

Pikërisht për këtë arsye, Plani e vendos në qendër forcimin real të Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar (KKAK), duke e transformuar atë nga një strukturë kryesisht konsultative në një mekanizëm aktiv koordinimi, monitorimi dhe orientimi politikash.

Së pari, objektivi synon të përmirësojë koordinimin horizontal të politikave përmes monitorimit të ndryshimeve legjislativë. Rishikimi i Ligjit kuadër për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe përafrimi me Direktivën (BE) 2019/882 mbi kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet⁸⁹ do të shërbejë jo vetëm për harmonizim me *acquis*-n e BE-së, por edhe për të qartësuar përgjegjësitë institucionale. Në praktikë kjo do të thotë që çdo ministri, para se të ndërmarrë ndryshime ligjore sektoriale, duhet të marrë në konsideratë ndikimin mbi personat me aftësi të kufizuara dhe të informojë KKAK. Kjo krijon një filtër të politikave publike, që shmang vendimmarrjet e izoluara dhe garanton integritetin e dimensionit të aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat.

Po aq i rëndësishëm është edhe koordinimi vertikal, midis nivelit qendror dhe atij vendor. Përmes takimeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe mbledhjes së të dhënave mbi zbatimin e Planit, KKAK do të krijojë një pasqyrë reale të situatës në terren. Kjo është thelbësore sepse shpesh ekziston një diferencë e madhe midis politikave të miratuara dhe realitetit lokal. Informacioni i mbledhur do të përdoret për të orientuar vendimmarrjen në nivel qendror dhe për të identifikuar pengesat konkrete që hasin bashkitë.

Ndërtimi i një plani vjetor aktivitetesh për KKAK synon të vendosë një cikël të rregullt pune. Takimet periodike me ministrinë e linjës në fillim të çdo viti do të shërbejnë për koordinimin e prioritetëve, shmangien e mbivendosjeve dhe planifikimin e përbashkët të ndërhyrjeve. Për herë të parë, planifikimi për aftësinë e kufizuar synohet të bëhet ndërsektorial, dhe jo thjesht si një përgjegjësi e një institucioni të vetëm.

Një element i rëndësishëm i këtij objektivi është edhe përfshirja e organizatave të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë ato që nuk janë anëtare të KKAK. Kjo e zgjeron konsultimin publik dhe e afron politikëbërjen me përvojën reale të përfituesve. Në këtë mënyrë, KKAK shndërrohet në një platformë dialogu ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, duke rritur transparencën dhe legjitimitetin e politikave.

⁸⁹ Direktiva (BE) 2016/2102 për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve mobile të institucioneve publike.

Përgatitja e raporteve vjetore të aktiviteteve dhe rezultateve synon të krijojë një mekanizëm llogaridhënieje. Raportimi periodik do të mundësojë vlerësimin e progresit të Planit të Veprimit, identifikimin e vonesave dhe përshtatjen e politikave sipas nevojave reale.

Ky objektivi synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm koordinimi publik për aftësinë e kufizuar. KKAK pritet të funksionojë si nyja qendrore e sistemit: një strukturë që lidh ministrinë, pushtetin vendor dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, duke garantuar që politikat të mos jenë të shpërndara në sektorë të veçantë, por të ndërtohen dhe zbatohen në mënyrë të integruar dhe të monitorueshme.

Objektivi Specifik 3: *Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm për matjen e indikatorëve të monitorimit, në përputhje me treguesit OZHQ për aftësinë e kufizuar.*

Masa prioritare

3.1 Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore për mbledhjen, analizën dhe përdorimin e të dhënave mbi aftësinë e kufizuar.

Ky objektivi adreson një nga pengesat më të mëdha në hartimin dhe monitorimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara: mungesën e të dhënave të besueshme, të krahasueshme dhe të integruara. Në praktikë, shumë politika publike janë ndërtuar pa një vlerësim të plotë të situatës së personave me aftësi të kufizuara, sepse informacioni ekzistues është i fragmentuar, shpesh administrativ dhe jo gjithmonë i harmonizuar midis institucioneve.

Plani synon të kalojë nga një sistem i shpërndarë informacioni në një sistem statistikor kombëtar të integruar për aftësinë e kufizuar. Rishikimi i kuadrit nënligjor për mbledhjen e statistikave do të përcaktojë detyrime të qarta për institucionet publike mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave, si dhe lidhjen e tyre me monitorimin e Planit të Veprimit. Raportimi vjetor në Këshillin Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar do të krijojë për herë të parë një mekanizëm të rregullt monitorimi të bazuar në evidencë dhe jo vetëm në raportime përshkruese.

Një element kyç i objektivit është integrimi i aftësisë së kufizuar në statistikat kombëtare. Përfshirja e të dhënave për aftësinë e kufizuar në anketa të mëdha kombëtare të INSTAT⁹⁰ si Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, Anketa e Buxhetit të Familjes dhe Anketa e Forcave të Punës do të mundësojë matjen reale të varfërisë, punësimit, përjashtimit social dhe pabarazive. Kjo është thelbësore sepse aktualisht këto indikatorë shpesh maten për popullsinë në përgjithësi, pa dalluar ndikimin specifik që aftësia e kufizuar ka në jetesën ekonomike dhe sociale.

Trajnimi i pikave fokale në ministri synon të standardizojë mënyrën e mbledhjes së të dhënave. Aktualisht institucionet përdorin metoda të ndryshme, çka e bën të vështirë krahasimin dhe analizën. Përmes trajnimeve dhe udhëzimeve të përbashkëta do të sigurohet përdorimi i një metodologjie të harmonizuar, duke rritur cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit.

⁹⁰ Ligji nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare

Një hap thelbësor është ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Statistikave të Përfshirjes Sociale. Ky grup do të funksionojë si mekanizëm teknik bashkëpunimi ndërmjet institucioneve që prodhojnë të dhëna (mbrojtje sociale, punësim, arsim, shëndetësi, drejtësi, strehim). Për herë të parë, të dhënat administrative do të analizohen në mënyrë të integruar dhe ndërsektoriale, duke mundësuar krijimin e treguesve kompleksë që lidhen me gjininë, moshën, përkatësinë etnike dhe aftësinë e kufizuar.

Kjo qasje do të lidhë drejtpërdrejt politikat kombëtare me treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilët kërkojnë matjen e përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në fusha si varfëria, arsimi, punësimi, shëndeti dhe pjesëmarrja sociale. Pra, sistemi statistikor nuk do të shërbejë vetëm për raportim ndërkombëtar, por do të bëhet një instrument vendimmarrjeje për politikat publike.

Në thelb, ky objektiv synon të ndërtojë një politikë për aftësinë e kufizuar të bazuar në të dhëna dhe fakte të mbështetura. Këto të dhëna do të përdoren për planifikim më të saktë të buxheteve, për targetim më të mirë të shërbimeve dhe për vlerësimin real të ndikimit të reformave. Në këtë mënyrë, monitorimi i Planit të Veprimit nuk do të jetë vetëm formal, por do të mbështetet në tregues konkretë që matin ndryshimin real në jetën e personave me aftësi të kufizuara.

Objektivi Specifik 4: *Nxitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e KDPAK.*

Masa prioritare

4.1 Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave dhe përmirësimin e politikave për aftësinë e kufizuar.

Ky objektiv synon të forcojë dimensionin ndërkombëtar të politikave për aftësinë e kufizuar dhe të vendosë zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në një kontekst bashkëpunimi rajonal dhe evropian. Në praktikë, shumë nga reformat më të rëndësishme për aftësinë e kufizuar, si jetesa e pavarur, vendimmarrja e mbështetur, deinstitutionalizimi apo shërbimet komunitare, janë fusha relativisht të reja për institucionet e administratës publike dhe kërkojnë jo vetëm legjislacion, por edhe modele funksionale të provuara.

Plani i Veprimit parashikon që Shqipëria të mos veprojë e izoluar, por të mësojë sistematikisht nga përvojat e vendeve të tjera. Organizimi periodik i konferencave rajonale do të krijojë një hapësirë të përhershme shkëmbimi midis institucioneve shtetërore, pushtetit vendor dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara. Këto aktivitete do të fokusohen në fusha konkrete reformash, si transformimi i institucioneve rezidenciale në shërbime komunitare, zhvillimi i mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur apo mbështetja e sipërmarrjes sociale, duke ndihmuar në shmangien e gabimeve të bëra në vende të tjera dhe në përshtatjen e praktikave të suksesshme.

Pjesëmarrja në konferenca dhe rrjete rajonale dhe të Bashkimit Evropian do të shërbejë si mekanizëm për harmonizimin gradual të politikave kombëtare me standardet evropiane. Përmes këtij procesi, institucionet shqiptare do të kenë akses në udhëzime teknike, metodologji monitorimi

dhe modele financimi të përdorura në vende të tjera, gjë që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së reformave dhe në përgatitjen për procesin e integrimit evropian.

Një rol të veçantë kanë bashkëpunimet studimore, të cilat synojnë transferimin praktik të njohurive. Përfshirja në këto takime jo vetëm të administratës qendrore, por edhe e bashkive dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme sepse shumë reforma, veçanërisht shërbimet sociale komunitare, zbatohen në nivel vendor. Përmes këtyre takimeve, aktorët lokalë do të kenë mundësi të shohin drejtpërdrejt modele funksionale dhe të kuptojnë aspektet praktike të zbatimit, si organizimi i shërbimeve, financimi, monitorimi dhe përfshirja e komunitetit.

Ky objektivi synon të ndërtojë një politikë për aftësinë e kufizuar që zhvillohet përmes bashkëpunimit dhe jo vetëm përmes përpjekjeve të brendshme. Bashkëpunimi rajonal do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve institucionale, përshpejtimin e reformave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke siguruar që zbatimi i Konventës të mos mbetet një proces formal, por të përkthehet në ndryshime konkrete në jetën e personave me aftësi të kufizuara.

5. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

5.1 Përgjegjësia e institucioneve

Zbatimi i PKVPAK 2026-2030 mbështetet në parimin e përgjegjësisë së përbashkët ndërinstitucionale, duke marrë në konsideratë natyrën ndërsektoriale të politikave për personat me aftësi të kufizuara. Çështjet e aftësisë së kufizuar nuk kufizohen vetëm në sistemin e mbrojtjes sociale, por lidhen drejtpërdrejt me arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, infrastrukturën, kulturën, sportin, punësimin dhe shërbimet publike në tërësi. Për rrjedhojë, të gjitha institucionet publike mbajnë përgjegjësi për integrimin e standardeve të përfshirjes dhe mosdiskriminimit në politikat dhe shërbimet që ofrojnë për qytetarët.

MSHMS, si ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar do të luajë funksionin koordinues në nivel kombëtar dhe do të sigurojë drejtimin strategjik të Planit. Ajo do të harmonizojë ndërhyrjet sektoriale, do të ndjekë progresin e zbatimit dhe do të sigurojë konsolidimin e informacionit në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, MSHMS do të bashkërendojë veprimtarinë e ministrive të linjës, do të përgatisë udhëzime metodologjike për zbatimin dhe raportimin, si dhe raportet periodike për strukturat qeveritare apo mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit të të drejtave të njeriut.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar do të luajë rol këshillimor dhe mbikëqyrës në nivel strategjik, duke mundësuar koordinimin horizontal dhe vertikal të politikave dhe duke garantuar pjesëmarrjen e organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara në procese. Veprimtaria e tij do të vijojë të mbështetet nga Sekretariati Teknik dhe nga pikat fokale të ngritura në institucionet e linjës, të cilat do të ndjekin zbatimin e masave dhe komunikimin institucional. Çdo ministri dhe institucion qendror do të jetë përgjegjës për zbatimin e masave që lidhen me fushën e kompetencës së tij, përfshirë planifikimin e burimeve financiare, integrimin e kërkesave

të aksesueshmërisë dhe raportimin periodik të rezultateve. Objektivat e planit duhet të reflektohen në dokumentet e planifikimit dhe në programet buxhetore të institucioneve përgjegjëse.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë rol të rëndësishëm në zbatimin praktik të planit, sidomos në realizimin e aksesueshmërisë në institucione publike, ofrimin e shërbimeve komunitare dhe nxitjen e përfshirjes në jetën shoqërore. Bashkitë do të planifikojnë dhe realizojnë ndërhyrje për eliminimin e barrierave infrastrukturore dhe atyre në komunikim dhe do të bashkëpunojnë me organizatat e personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal për identifikimin e nevojave të komunitetit.

Në kuadër të realizimit të aksesueshmërisë, parashikohet ngritja e një strukture të specializuar për monitorimin dhe kontrollin e standardeve të aksesueshmërisë, e cila do të bashkërendojë veprimet e institucioneve qendrore dhe vendore. Nevoja për një mekanizëm të tillë lidhet me mungesën e deritanishme të një autoriteti koordinues dhe të kontrollit sistematik të standardeve të aksesueshmërisë, e cila ka kufizuar zbatimin praktik të legjislacionit ekzistues. Kjo strukturë do të kontribuojë në verifikimin teknik të investimeve publike dhe në standardizimin e zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në proceset e konsultimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave, duke siguruar që ndërhyrjet përmes fondeve publike të reflektojnë nevojat reale të personave me aftësi të kufizuara.

5.2 Raportimi dhe Monitorimi

Monitorimi i PKVPAK 2026-2030 do të mbështetet në një sistem të strukturuar dhe të detyrueshëm raportimi, i cili synon të kalojë nga raportimi formal i aktiviteteve drejt vlerësimit të rezultateve dhe ndikimit të politikave. Përvoja e periudhës së mëparshme ka treguar se, pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor, mungesa e mekanizmave të koordinuar të kontrollit, statistikave të integruara dhe raportimit të rregullt, ka kufizuar zbatimin efektiv të politikave. Institucionet përgjegjëse do të raportojnë në mënyrë periodike mbi realizimin e masave, treguesve dhe përdorimin e burimeve financiare. Pikat fokale të ngritura në ministri dhe institucione do të mbledhin dhe verifikojnë të dhënat përkatëse dhe do t'i përcjellin ato tek institucioni koordinues. Ministria përgjegjëse do të përpunojë informacionin e ardhur nga sektorët dhe do të hartojë raportin kombëtar të progresit, i cili do të analizojë ecurinë e indikatorëve, vështirësitë e hasura dhe nevojën për masa korrigjuese.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar do të shqyrtojë periodikisht progresin e planit dhe do të rekomandojë ndërhyrje për përmirësimin e zbatimit, duke siguruar një mekanizëm mbikëqyrjeje institucionale dhe pjesëmarrje të organizatave përfaqësuese të fushës së aftësisë së kufizuar.

Për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie, raportet e progresit do të publikohen dhe do të konsultohen me organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe aktorët e tjerë të interesit.

Në kuadër të zbatimit të Planit, do të zhvillohet një sistem i integruar statistikor për aftësinë e kufizuar, i cili do të mundësojë mbledhjen dhe analizën e të dhënave në mënyrë të vazhdueshme

dhe do të mbështesë hartimin e politikave, të bazuara në evidencë. Raportimi do të realizohet çdo vit, ndërsa një vlerësim i ndërmjetëm dhe një vlerësim përfundimtar do të kryhen gjatë dhe në përfundim të periudhës së zbatimit.

Struktura e re e aksesueshmërisë do të kryejë monitorim teknik të standardeve në infrastrukturë, shërbime dhe informacion dhe do të raportojë shkeljet apo mospërputhjet, duke rekomanduar masa korrigjuese për institucionet përgjegjëse. Ky mekanizëm synon të sigurojë që aksesueshmëria të zbatohet në praktikë dhe të kthehet nga një kërkesë formale ligjore në një standard real dhe të verifikueshëm për institucionet publike.

Në tërësi, sistemi i ri i raportimit dhe monitorimit synon të forcojë llogaridhënien institucionale, të rrisë transparencën dhe të garantojë që politikat për personat me aftësi të kufizuara të përkthehen në përmirësime konkrete dhe të matshme në jetën e tyre të përditshme.

6. INDIKATORËT

6.1 Aksesueshmëria

	Objektivat	Treguesi	Vlera bazë	Synimi 2027	Synimi 2030	Burimet dhe mjetet e verifikimit	Referenca në dok. të tjera
Qëllimi i politikës	Te realizohet aksesueshmëria në mjedise, shërbime, produkte, transport informacion dhe turizëm për personat me aftësi të kufizuara.	Mjedisi ndërtimor i aksesueshëm garanton pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës shoqërore.	N/A N/A	10 % nga vlera bazë 5 % nga vlera bazë	30 % nga vlera bazë 25 % nga vlera bazë	MTKS; MIE; MEI; MSHMS; UP; NJQV; Shoqatat e ndërtuesve Kompanitë e shërbimeve elektronike; OJQ; Raporte monitorimesh;	OZHQ3 Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK); Strategjia e BE-së 2021-2030 (aksesueshmëri, mos-diskriminim, shërbime të barabarta); Direktiva (BE) 2019/882 E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Mbi kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet”; Akti Evropian i Aksesueshmërisë (European Accessibility Act - 2019); Direktiva për Aksesueshmërinë e Uebit (2016); Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi; Standardet për ndërtimin e objekteve publike me akses për persona me aftësi të kufizuara;
	Objekti vi specifik/	Objekti Specifik 1. Aksesueshmëria në mjedisin ndërtimor, infrastrukturë dhe në produkte e shërbime: Të sigurohet aksesueshmëria e mjedisit të ndërtimor, si një parakusht për integrim për personat me aftësi të kufizuara, për pjesëmarrje në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke eliminuar barrierat ekzistuese dhe duke penguar shfaqjen e barrierave të reja.	Eliminimi i barrierave ekzistuese në objektet e vlerësuara për nivelin e aksesueshmërisë Pengimi i shfaqjes së barrierave të reja në projektet në proces për marrjen e lejes së ndërtimit	N/A N/A	5 % nga vlera bazë 20 % nga vlera bazë	35 % nga vlera bazë 80 % nga vlera bazë	MIE; MEI; MTKS; MSHMS; NJQV; Instituti i Ndërtimit; Shoqata e ndërtuesve;
	Objekti Specifik 2: Aksesueshmëria në transport, në shërbime dhe mjete: Të përmirësohet niveli i aksesueshmërisë në transportin publik, si në mjetet edhe në	Operatorët e transportit publik sigurojnë pajisje dhe shërbime të aksesueshme për PAK sipas standardeve të BE-së.	N/A N/A	10 % nga vlera bazë 20 % nga vlera	30% nga vlera bazë 20 % nga vlera	MIE; MSHMS; DPSHTRR; NJQV; Kompani	Strategjia e BE-së 2021-2030 (aksesueshmëri, mos-diskriminim, shërbime të barabarta); Legjisllacioni i BE-së për të Drejtat e Pasagjerëve Aksesueshmëria Digjitale; Bileta elektronike dhe aplikacione të aksesueshme; Informacion audio dhe vizual në kohë reale;

shërbime ndaj udhëtarëve me aftësi të kufizuara. Të mundësohet udhëtimi falas për personat me aftësi të kufizuara.	% e Stafit të trajnuar të zbatojë sjellje të respektueshme dhe ndihmuese ndaj udhëtarëve me aftësi të kufizuara Raport studimi për përgatitjen e kartës së transportit falas për personat me aftësi të kufizuara	N/A	bazë 1	bazë 1	transporti/ taksish; OJQ;	Standarde WCAG për faqet e transportit publik; Parimi i “Design for All”; Autobusë me platforma ngritëse; Stacione me ashensorë dhe rampa; Sinjalistikë me Braille dhe njoftime zanore.
Objektivi specifik 3: Aksesueshmëria në informacion, komunikim dhe media: Të sigurohet akses i barabartë dhe gjithëpërfshirës në informacion, komunikim dhe media për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në të gjitha shërbimet dhe platformat e ofruara për publikun (sportele, portale dhe faqe interneti, pajisje dhe shërbime celulare, transmetime dhe programe televizive, publikime, takime dhe ngjarje publike), duke garantuar përdorimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit në kushte të barabarta me të tjerët.	Raport vlerësim i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore të miratuara për nivelin e përfshirjes së standarde të detyrueshme të aksesueshmërisë në informacion dhe komunikim në shërbimet publike në sportel Strategji komunikimi nga AMA me fokus tek aksesueshmëria për personat me aftësi të Kufizuara që të sigurojë bashkërendimin mes shërbimeve televizive dhe pajisjeve që u mundësojnë përdoruesve marrjen, dekodimin, shfaqjen e shërbimeve të aksesueshme.	N/A N/A	1 1	1 1	MEI; AKSHI; AMA; AKEP; MSHMS Kompanitë telefonike; OJQ; Raporte monitorimi	OZHQ3 Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK); Strategjia e BE-së 2021-2030 (aksesueshmëri, mos-diskriminim, shërbime të barabarta) Direktiva (BE) 2019/882 E Parlamentit Evropian dhe e e Këshillit “Mbi kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet”; Akti Evropian i Aksesueshmërisë (European Accessibility Act - 2019); Direktiva për Aksesueshmërinë e Uebit (2016); Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike; Ligji për komunikimet elektronike; Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale; Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi;
Objektivi specifik 4: Aksesueshmëria në objektet dhe shërbimet turistike dhe të trashëgimisë kulturore: Të sigurohet akses për Personat me aftësi të kufizuara në strukturat turistike dhe shërbimet në turret turistike, duke siguruar edhe mjete të përshtatura	Strukturat turistike dhe shërbimet në turet turistike sigurojnë akses për PAK.	N/A			MTKS; MSHMS; UP; Agjencia e Turizmit; Raporte monitorimi;	Direktiva (BE) 2019/882 E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Mbi kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet”; Akti Evropian i Aksesueshmërisë (European Accessibility Act - 2019); Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024 - 2030; Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.;

Masat prioritare	Masa prioritare 1.1. Rishikimi i bazës ligjore për aksesueshmërinë dhe fuqizimi i monitorimit të zbatimit të saj. Ngritja dhe funksionimi i Strukturës monitoruese/Autoritetit, në varësi të Këshillit të Ministrave, për monitorim në nivel kombëtar	Akte ligjore/nënligjore penalizimi në ligjin " Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë" te rishikuar, për personat përgjegjës brenda këshillave teknike kur miratojnë projekte publike apo private, ku nuk janë plotësuar standardet e aksesueshmërisë si dhe për personat qe japin lejen e shfrytëzimit te objektit te ndërtuar pa standardet e aksesueshmërisë, zhvillimi i gjuhës se shenjave dhe shërbimet e interpretimit. Struktura e monitorimit / Autoriteti e krijuar me VKM, me organikë, buxhet dhe plan pune vjetor të miratuar. Numri i raporteve kombëtare të monitorimit	N/A	2 nene të reja të vendosura ne ligj ; VKM për ngritjen e Autoritetit	2 nene të reja të vendosura në ligj; VKM për zhvillimin e gjuhës së shenjave dhe shërbimet e interpretimit	MSHMS; MD; KM; Autoriteti; OJQ;	
	Masa prioritare 1.2. Vlerësimi i situatës së aksesueshmërisë së aseteve publike (ndërtesa dhe infrastrukturë), detajimi i planit me aksione konkrete për përfshirjen e elementeve të aksesueshmërisë në të gjitha asetet, sipas përparësive, krijimi i regjistrit	Raporti i vlerësimit të aksesueshmërisë në objektet publike, përfshirë edhe ato të artit e kulturës dhe të ambienteve sportive Krijimi dhe funksionimi i regjistrit të aksesueshmërisë së aseteve publike	N/A N/A	1 40% e regjistrit të plotësuar	1 80 % e regjistrit të plotësuar	MTKS; MIE; ME:I MSHMS; UP; NJQV; Shoqatat e ndërtuesve; Kompanitë e shërbimeve elektronike; OJQ; Raporte monitorimesh;	
	Masa prioritare 2. 1 Të aplikohen standardet e BE-së dhe të përafrohet kadri ligjor për të mundur realizimin e të drejtave të pasagjerëve me aftësi të kufizuara në udhëtimet	1. Raport vlerësimi nëse terminallet dhe stacionet (autobus) plotësojnë standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të	N/A N/A	1 1	1 1		

me autobusë (brenda qyteteve dhe ndër qytete), dhe te gjitha mjetet e tjera te transportit hekurudhor e ujqor. Përmirësimi i qëndrimeve dhe sjelljeve ndaj udhëtarëve

kufizuara.

2. Raport studimi për kartën e transportit për PAK. Sigurimi i autorizimit për vend parkimi falas në nivel kombëtar për PAK.

N/A

5% nga vlera bazë

20% nga vlera bazë

3. Akte nënligjore nga bashkitë për të vendosur ne kushtet e licencimit të kompanive të taksive , detyrimin për sigurim të taksive të përshtatura për shërbim ndaj PAK

<p>Masa prioritare 3.1. Përmirësimet ligjore dhe adaptimi i standardeve ndërkombëtare të sigurimit të aksesueshmërisë në TIK. Strukturat për monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të kuadrit ligjor</p>	<p>Miratimi dhe hyrja në fuqi e akteve ligjore/nënligjore të harmonizuara me standardet ndërkombëtare (p.sh. WCAG, EN 301 549). % e faqeve zyrtare dhe shërbimeve elektronike publike që certifikohen si të aksesueshme sipas standardeve të miratuara. Numri i auditimeve/inspektimeve vjetore për aksesueshmërinë digjitale</p>	1	2 akte	2 akte		
		N/A	30 % e faqeve zyrtare nga vlera bazë	50 % e faqeve zyrtare nga vlera bazë		
		N/A	2 audite/vit	6 audite		
Masa prioritare 1.3. Ndërgjegjësimi i profesionistëve të sistemit të drejtësisë mbi të drejtën për të patur akses në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara, bazuar në praktikën dhe standartet më të mira ndërkombëtare.	2026	2028	SHM/DHASH/DHKN	MD	2,467	1,467	1,467	3,950	3,950
1.3.1. Rritja e ndërgjegjësimit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë/noterë), përmes konferencave, aktiviteteve, seancave trajnuese lidhur me të drejtën e njohjes të barabartë para ligjit dhe të drejtën për akses efektiv në organet e drejtësisë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara.	2026	2028	SHM/DHASH/DHKN	MD	1,467	1,467	1,467	-	-

1.3.2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë/noterë) përmes miratimit dhe zbatimit të të programeve të trajnimit/kurrikulave të trajnimit dhe zbatimi i ligjit pa paternalizëm, përmes e-learning dhe certifikim periodik.	2029	2030	SHM/DHASH/DHKN	MD	-	-	-	3,950	3,950
1.3.3.Përgatitja e analizës së nevojave për interpretet e gjuhës së shenjave shqipe në sistemin e drejtësisë, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.	2026	2028	MD	MSHMS	1,000	-	-	-	-
Masa prioritare 1.4. Garantimi i aksesueshmërisë në mjedise, informacion e komunikim për personat me aftësi të kufizuara në institucione të sistemit të drejtësisë, apo të lidhura me të.	2026	2030	KLJGJ/KLP/DPP/DHKA/DHKN/SHM		3,600	3,600	3,600	-	-
1.4.1.Kryerja e analizës për vlerësimin e nevojave të aksesueshmërisë fizike, në informacion dhe komunikim në të gjitha nivelet e institucioneve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë të gjitha Gjykatat e vendit. Përfshirja graduale në buxhetet institucionale të nevojave të evidentuara në analizën e vlerësimit.	2026	2028	KLJGJ/Gjykatat		500	500	500	-	-
1.4.2.Kryerja e analizës për vlerësimin e nevojave të aksesueshmërisë fizike, në informacion dhe në komunikim në të gjitha nivelet e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale dhe përfshirja graduale në buxhetet institucionale të nevojave të evidentuara në analizën e vlerësimit.	2026	2028	Prokuroria e Përgjithshme		500	500	500	-	-
1.4.3.Kryerja e analizës për vlerësimin e nevojave të aksesueshmërisë fizike, në informacion dhe në komunikim në të gjitha institucionet e policisë të shtetit në rang vendi dhe përfshirja në buxhetet institucionale të nevojave të evidentuara në analizën e vlerësimit.	2026	2028	DPP		500	500	500	-	-
1.4.4. Përgatitja e protokolleve e procedurave për të realizuar aksesueshmërisë në informacion e komunikim, në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.	2026	2028	KLJGJ/KLP/DHKA/DHKN/SHM/		1,267	1,267	1,267	-	-
1.4.5 Përgatitja e protokolleve që ilustrojnë qartë se çfarë është akomodimi i arsyeshëm në aksesin në drejtësi dhe se si mund të shfaqet ai në çdo fazë të procesit.	2026	2028	KLJGJ/KLP/DHKA/DHKN/SHM/MSHMS		833	833	833	-	-

Objektivi Specifik 2. Të garantohet njohja e barabartë para ligjit dhe ushtrimi i plotë i zotësisë për të vepruar për personat me aftësi të kufizuara, duke zëvendësuar kujdestarinë me mekanizma të vendimmarrjes së mbështetur.	2026	2030	MD/MSHMS		9,847	9,847	11,347	12,180	9,180
Masa Prioritare 2.1: Përgatitja e kuadrit ligjor dhe fuqizimi i kapaciteteve për të mundësuar vendimmarrjen e mbështetur	2026	2030	MD/MSHMS		9,847	9,847	11,347	12,180	9,180
2.1.1. Përgatitja e një analize ligjore me fokus identifikimin dhe orientimin e boshllëqeve, të cilat pengojnë aplikimin e vendimmarrjes së mbështetur;	2026	2028	MD/MSHMS		667	667	667	-	-
2.1.2. Rishikimi i dispozitave ligjore të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Familjes, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, Ligjit të Shëndetit Mendor për të garantuar të drejtën për të ushtruar zotësinë e plotë për të vepruar për personat me aftësi të kufizuara, me një fokus të veçantë te personat me aftësi të kufizuara psikosociale dhe intelektuale, të cilët janë prekur në mënyrë disproporcionale nga heqja e zotësisë juridike, krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, në të gjitha aspektet e jetës ;	2026	2028	MD/MSHMS		1,000	1,000	1,000	-	-
2.1.3. Iniciimi, përgatitja, miratimi i kuadrit ligjor në mbështetje të ngritjes së mekanizmave të vendimmarrjes së mbështetur	2029	2030	MD/MSHMS		-	-	-	2,500	2,500
2.1.4. Rritja e kapaciteteve të profesionistëve për të kuptuar dhe zbatuar vendimmarrjen e mbështetur në sektorë të lidhur me shëndetësinë, policinë, prokurorinë, gjyqësorin, noterë e avokatë;	2026	2030	MD/MSHMS	MD	7,500	7,500	7,500	7,500	6,000
2.1.5. Organizimi i vizitave studimore në vende ku aplikimi në praktikë i vendimmarrjes së mbështetur ka rezultuar I suksesshëm.	2029	2030	MD/MSHMS	MD	-	-	1,500	1,500	-
2.1.6. Përgatitja e materialeve udhëzuese për aplikimin e vendimmarrjes së mbështetur në formate alternative dhe realizimi i fushatave të informimit për persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre.	2026	2030	MD/MSHMS	MD	680	680	680	680	680
Objektivi specifik 3. Të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara në paraburgim dhe në institucionet e vuajtjes së dënimit të kenë ambiente të aksesueshme, shërbime shëndetësore e psikosociale dhe plane	2026	2030	DPB	MD/MSHMS	2,085	2,085	2,000	11,500	11,500

individuale mbështetjeje, për të garantuar trajtim dinjitoz dhe të barabartë.									
Masa Prioritare 3.1: Realizimi i aksesueshmërisë fizike dhe aksesueshmërisë në informacion e komunikim për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimeve.	2026	2030	DPB	MD/MSHMS					
					1,000	1,000	1,000	2,500	2,500
3.1.1.Përgatitja e analizës lidhur me vlerësimin e nevojave të aksesueshmërisë fizike, në informacion e komunikim në të gjitha institucionet e vuajtjes të dënimeve.	2026	2028	DPB	MD/MSHMS	1,000	1,000	1,000	-	-
3.1.2.Vlerësimi i nevojave të evidentuara dhe përfshirja në buxhetet institucionale e prioriteve të orientuara nga analiza e aksesueshmërisë në institucionet e vuajtjes të dënimit.	2029	2030	DPB	MD/MSHMS	-	-	-	2,500	2,500
Masa Prioritare 3.2.: Fuqizimi i kapaciteteve në institucionet e paraburgimit dhe ato të vuajtjes së dënimit, duke mundësuar mbështetjen bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara.	2026	2030	DPB	MD/MSHMS	1,085	1,085	1,000	9,000	9,000
3.2.1. Përgatitja e miratimi i procedurave/formularëve për identifikimin e hershëm të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e aksesueshmërisë, akomodimit të arsyeshëm dhe mbështetjes së nevojshme, në mënyrë që të paraburgosurit dhe të burgosurit me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë në të gjitha shërbimet dhe mjediset e qendrës së ndalimit.	2026	2028	DPB	MD/MSHMS	1,000	1,000	1,000	-	-
3.2.2. Identifikimi dhe mbështetja e nevojave përmes hartimit dhe aplikimit të Protokollit të Vlerësimit dhe Planit Individual.	2029	2030	DPB	MD/MSHMS	-	-	-	-	-
3.2.3. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe psikosociale në institucionin e posaçëm të vuajtjes së dënimit, përmes sistemit të referimit në mjekë, psikologë, terapi të vazhdueshme, dhe sigurimi i bashkëpunimit me shërbimet komunitare.	2026	2030	DPB	MD/MSHMS	-	-	-	-	-
3.2.4. Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimit, mbi aksesin në drejtësi të të gjitha kategorive të personave me aftësisë të kufizuar, bazuar në	2026	2028	DPB	MD/MSHMS	85	85	-	-	-

standartet ndërkombëtare për aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.									
3.2.5.Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të institucioneve të vuajtjes së dënimit përmes hartimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit/kurrikulave të trajnimit, mbi aksesin në drejtësi të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara.	2029	2030	DPB	MD/MSHMS	-	-	-	9,000	9,000
III. PUNËSIMI DHE AFTËSIMI					366,299	385,865	346,515	349,002	356,300
Objekti i Specifik 1: Nxitja e pjesëmarrjes, zgjerimi i aksesit dhe përfitimit të nxënësve dhe kursantëve me aftësi të kufizuara nga programet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe parimet e arsimit gjithëpërfshirës.	2026	2030	MEI, MA, AKPA, AKAFPK, IOAFP	AKPA/ASCAP/AKAFPK/AKAP/ASCAP/IOAFP/MEI/NJVV	126,789	134,665	96,051	95,588	95,588
Masa Prioritare 1.1: Përmirësimi i kornizës politike, ligjore dhe institucionale për arsim e formim profesional gjithëpërfshirës për nxënësit e kursantët me aftësi të kufizuara	2026	2030	MEI, MA, AKAFPK	AKPA, ASCAP, AKAFPK; AKAP, ASCAP/IOAFP	38,773	46,377	7,088	6,843	6,843
1.1.1 Rishikim dhe përmirësimi i dhe Ligjit për Arsimin dhe Formimin Profesional, për të garantuar AFP gjithëpërfshirës dhe cilësor për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2027	MEI, MA	AKPA, ASCAP, AKAFPK; AKAP, ASCAP	995	723	-	-	-
1.1.2 Përfshirje e elementeve të AFP në Ligjin për Arsimin Parauniversitar, për të garantuar AFP cilësor për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2027	MEI, MA	AKPA, ASCAP, AKAFPK; AKAP, ASCAP	995	723	-	-	-
1.1.3 Hartimi dhe aprovimi i një Udhëzimi të përbashkët me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë në zbatim të Nenit 64: “Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara”	2026	2027	MEI, MA	AKPA, ASCAP, AKAFPK; AKAP, ASCAP	182	-	-	-	-
1.1.4 Aprovimi i Udhëzuesit për ofrimin e arsimit dhe formimit profesional gjithëpërfshirës për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara;	2026	2026	MEI, AKPA	IoAFP	273	-	-	-	-
1.1.5 Rishikimi i procesit të vetëvlerësimit si instrument plotësues dhe efektiv i garantimit të cilësisë duke përfshirë tregues specifik për	2027	2027	AKAFPK	AKPA	-	623	-	-	-

gadishmërinë e IOAFP për arsimimin gjithëpërfshirës									
1.1.6 Rishikim i kriterëve të cilësisë dhe modelit të akreditimit për të garantuar standardet e arsimit gjithëpërfshirës për nxënësit e kursantët me aftësi të kufizuara, si kusht për akreditimin për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së, si dhe ofrues private që ofrojnë kualifikime profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së.	2027	2027	AKAFPK	AKPA, MEI	-	623	-	-	-
1.1.7 Rishikim i qasjes dhe modelit të inspektimit në AFP të harmonizuar me kornizën e garantimit dhe zhvillimit të cilësisë, dhe plotësimi me tregues specifik që garantojnë cilësinë në arsim për nxënësit me aftësi të kufizuara	2027	2027	MEI	AKPA, AKAFPK	-	623	-	-	-
1.1.8 Sistem i kualifikimit fillestar dhe zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhësve, përfshirë atë të kulturave profesionale dhe mësuesit ndihmës, për të garantuar aftësi teknike në drejtim ofrimit të një arsimit cilësor për nxënësit/kursantët me aftësi të kufizuara, i rishikuar/ aprovuar	2027	2028	AKAFPK	AKPA	-	245	245	-	-
1.1.9 Rishikimi dhe konsolidimi (administrativ, me kapacitete dhe mjete në formate të aksesueshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuara) i të gjitha njësive të zhvillimit brenda ofruesve publikë të AFP-së, për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKAFPK	AKPA	900	6,690	6,515	6,515	6,515
1.1.10 Ngritja e kapaciteteve të stafëve drejtuese dhe mbështetëse në ofruesit publik të AFP-së përfshirë në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe arsimin gjithëpërfshirës për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2027	AKPA	AKAFPK	35,100	35,100	-	-	-
1.1.11 Krijimi dhe fuqizimi i rrjeteve të e të praktikës mes institucioneve të AFP për shkëmbim përvojash në lidhje me arsimin dhe formimin profesional gjithëpërfshirës për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKPA	AKAFPK	327	1,027	327	327	327
Masa Prioritare 1.2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe teknologjisë assistive: Krijimi i mjediseve mësimore të aksesueshme dhe të pajisura me teknologji mbështetëse.	2026	2030	AKPA/AKAFPK	MEI/AKPA	1,875	2,148	1,875	2,525	2,525

1.2.1 Pajisja, mirëmbajtja dhe përditësimi i vazhdueshëm i pajisjeve ndihmëse dhe teknologjike që garantojnë akses për nxënësit/kursantët me aftësi të kufizuara në IOAFP psh. pajisje dhe softuerë ndihmës (lexues ekrani, tastiera të përshtatura, pajisje ndihmëse).	2026	2030	AKPA	MEI	1,350	1,350	1,350	2,000	2,000
1.2.2 Sigurimi i aksesit fizik dhe digjital në Shkollat e Mesme Profesionale dhe QFP përfshirë laboratorët e TIK dhe të aftësive të gjelbra	2026	2030	AKPA	MEI	-	273	-	-	-
1.2.3 Zhvillimi i platformave online për lehtësimin e mësimit të kombinuar dhe mësimit online, për të rinj dhe të rritur me aftësi të kufizuara. Përgatitja në mënyrë graduale e platformave të aksesueshme dhe me informacion në formate alternative për tipologji të ndryshme të aftësisë së kufizuara, për të garantuar akses dhe mundësi të barabarta për nxënësit, kursantët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKAFPK	AKPA /MEI	525	525	525	525	525
Masa Prioritare 1.3: Përshtatja e kurrikulave dhe programeve mësimore - Sigurimi që programet përfshirë programet digjitale dhe të gjelbra në AFP janë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse:	2026	2030	AKAFPK/AKP A	AKPA / MEI /A, AKAFPK, ASCAP	500	500	1,000	1,000	1,000
1.3.1 Zhvillimi i moduleve të reja përfshirë ato digjitale dhe të gjelbra, të përshtatura edhe për nxënësit me lloje të ndryshme aftësish të kufizuara.	2026	2030	AKAFPK	AKPA, MEI	500	500	1,000	1,000	1,000
1.3.2 Përgatitja e moduleve e mjeteve didaktike mësimore në formate të aksesueshme (Braille, audio, gjuhë e thjeshtuar, gjuhë e shenjave/titra) përfshirë ofrimin e teknologjisë asistive të shoqëruar edhe me trajnim të mësimdhënësve dhe formuesve/instrukturëve mbi përdorimin e teknologjive asistive.	2026	2030	AKPA	MEI, MA, AKAFPK, ASCAP	-	-	-	-	-
Masa prioritare 1.4. Mbështetja e nxënësve dhe kursantëve me aftësi të kufizuara - Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë dhe përfundimit me sukses të programeve mësimore në institucionet ofruese të AFP-së	2026	2030	IOAFP/AKPA	MEI/MA/AKAF PK/ASCAP/NJV V/AKPA	84,580	84,580	84,580	84,580	84,580
1.4.1 Identifikimi i nevojave individuale për mbështetje, hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të të nxënësit nga Komisionet Multifunksionate pranë institucioneve ofruese të AFP-së. Vlerësimi dhe rishikimi periodik i tyre,	2026	2030	IOAFP	AKPA, AKAFPK , ASCAP	-	-	-	-	-

bazuar në ecurinë e nxënësit/ kursantit me aftësi të kufizuara.									
1.4.2 Ofrimi i këshillimit profesional dhe orientimit në karrierë i personalizuar për nxënësit/kursantët me aftësi të kufizuara për gjithë sektorët përfshirë sektorët digjitalë dhe të gjelbra.	2026	2030	IOAFP	AKPA	72,000	72,000	72,000	72,000	72,000
1.4.3 Rritja e mbështetjes financiare (bursa, transport, pajisje personale, mjete e teknologji ndihmëse) për nxënësit dhe kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKPA	MEI,MA,AKAFP K,ASCAP, NJVV	12,580	12,580	12,580	12,580	12,580
1.4.4 Forcimi i partneritetit shkollë-familje-komunitet për arsimin gjithëpërfshirës në AFP, përmes krijimit të mekanizmave të strukturuar të bashkëpunimit si takime periodike shkollë-familje për ndjekjen e planeve individuale; përfshirjes së komunitetit dhe bizneseve në praktika profesionale të përshtatura; informimit dhe ndërgjegjësimit të familjeve mbi arsimin gjithëpërfshirës	2026	2030	IOAFP	AKPA	-	-	-	-	-
Masa prioritare 1.5: Bashkëpunimi me sektorin privat dhe tregun e punës - Lidhja e aftësive të fituara me punësimin real.	2026	2030	IOAFP	IOAFP/AKPA/M EI/MA/ASCAP	520	520	373	100	100
1.5.1 Fuqizimi i partneriteteve me kompani të ndryshme përfshirë ato të sektorit digjital dhe të ekonomisë së gjelbër për praktika dhe mësim në punë të përshtatura për nxënësit e kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2030	IOAFP	AKPA	-	-	-	-	-
1.5.2 Zhvillimi i programeve të praktikës së asistuar për nxënësit me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKPA	IOAFP	-	-	-	-	-
1.5.3 Sensibilizimi i punëdhënësve për potencialin e PAK dhe përfitimet e punësimit gjithëpërfshirës.	2026	2030	AKPA	IOAFP	100	100	100	100	100
1.5.4 Standardizim i certifikimit të njohurive dhe aftësive përfshirë të aftësive digjitale dhe të gjelbra për nxënësit/ kursantët me aftësi të kufizuara.	2026	2028	AKAFP	AKPA, MEI, MA, ASCAP	420	420	273	-	-
Masa prioritare 1.6: Monitorimi, vlerësimi dhe administrimi i të dhënave- Matja e progresit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i masave të parashikuara në këtë sektor/objektiv të planit të veprimit	2026	2030	IOAFP/AKPA	IOAFP/AKPA	540	540	1,135	540	540

1.6.1 Rishikimi dhe administrimi i të dhënave të ndara sipas llojit të aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës, kualifikimit/profesionit, regjistrimit, përfundimit dhe gjurmimit pas përfundimit të AFP.	2028	2028	IOAFP	AKPA	-	-	595	-	-
1.6.2 Raportim periodik dhe rishikim i politikave bazuar në evidenca.	2026	2030	AKPA	IOAFP	540	540	540	540	540
Objekti i Specifik 2.Zgjerimi dhe konsolidimi i shërbimeve të punësimit që synojnë fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara, përmes programeve gjithëpërfshirëse dhe atyre specifike të aftësisimit dhe punësimit dhe ngritjes dhe konsolidimit të Fondit Social të Punësimit.	2026	2030	MEI/MF/AKPA	AKPA/ISSH/MF/DPT/MEI/AKAF PK	239,510	251,200	250,463	253,414	260,712
Masa Prioritare 2.1: Plotësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për të nxitur punësimin e punëkërkuarve me aftësi të kufizuara.	2026	2030	MEI/MF/AKPA	AKPA/ISSH/MF/DPT/MEI	3,645	5,031	-	-	-
2.1.1 Rishikimi i Ligjit për nxitjen e punësimit për të garantuar mekanizmat e duhur që garantojnë rehabilitim për punë dhe punësim të denjë për personat me aftësi të kufizuara në tregun e punës.	2026	2027	MEI	AKPA	1,386	2,772	-	-	-
2.1.2. Rishikimi i Ligjit të Sigurimeve Shoqërore për të rregulluar vlerësimin e aftësive për punë dhe garantimin e mbështetjes financiare që mbulon kostot që lidhen me aftësinë e kufizuar, pavarësisht punësimit.	2026	2027	MF	ISSH	420	420	-	-	-
2.1.3. Krijimi i bazës rregullatore për ngritjen, funksionimin dhe monitorimin e zbatimit të Fondit Social të Punësimit, përmes një procesi përfshirës me gjithë aktorët e tregut të punës, përfshirë organizatat që përfaqësojnë e mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.	2026	2027	MEI	AKPA	595	595	-	-	-
2.1.3.Krijimi i mekanizmit për mbledhjen e kontributeve nga punëdhënësit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	2026	2027	MEI	MF; DPT	1,168	1,168	-	-	-
2.1.3. Funksionimi i Fondit Social të Punësimit dhe pilotimi i mbështetjes përmes këtij fondi së programeve të ndryshme që nxisin aftësimin, punësimin, vetëpunësimin, sipërmarrjen sociale dhe përshtatjen e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara (Ref 2.4.3)					-	-	-	-	-
2.1.3.3 Krijimi i Bordit për Administrimin e Fondit Social të Punësimit.	2026	2027	AKPA	MEI	75	75	-	-	-

2.1.4 Hartimi dhe aprovimi i VKMve përkatëse, udhëzimeve dhe udhëzuesve, përfshirë VKM për zbatimin e programit të posacëm për “ Punësimin me Mbështetje” , Udhëzimin “ Për financimin e përshtatjes së arsyeshme” , Udhëzues për këshillimin e punëkërkuësve me e aftësi të kufizuara “ etj., si edhe VKM të tjera në lidhje me programet e posacme që do të mbështeten përmes Fondit Social sikurse parashikuar në ligjin për nxitjen e punësimit.	2026	2030	AKPA	MEI	-	-	-	-	-
Masa prioritare 2.2. Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe kapaciteteve institucionale të AKPA-s dhe zyrave të punësimit për të garantuar akses dhe shërbime gjithëpërfshirëse punësimi për punëkërkuësit me aftësi të kufizuara	2026	2030	AKPA	MEI	7,100	9,650	9,650	6,900	6,900
2.2.1 Përmirësimi i efektivitetit të shërbimeve të punësimit, duke garantuar(i)aksesueshmërinë fizike, digjitale, në informacion dhe komunikim;(ii)përshtatjen e arsyeshme, kur është e nevojshme (iii)modelin e ofrimit të shërbimeve të punësimit për personat me aftësi të kufizuara në tre nivele: (a) shërbime bazë universale;(b)shërbime të ndërmjetësimit të avancuar;(c) shërbime të personalizuara intensive, përfshirë punësimin me mbështetje.	2026	2030	AKPA	MEI	6,750	8,750	8,750	6,000	6,000
2.2.2. Vendosija e specialistëve të dedikuar për ofrimin e shërbimeve për punë kërkuësit me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësve potencialë.	2026	2030	AKPA	MEI	-	-	-	-	-
2.2.3 Zhvillimi i kapaciteteve të specialistëve të dedikuar për ofrimin e shërbimeve për punëkërkuësit me aftësi të kufizuara, përfshirë në përdorimin e teknologjisë asitive për punëkërkuësit me aftësi të kufizuara, për ti orientuar ata drejt përdorimin e tyre kur paraqiten pranë zyrave të punësimit.	2026	2030	AKPA	MEI	175	450	450	450	450
2.2.4 Trajnimi i këshilltarëve të specializuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në strukturat e AKPA, për të ofruar ndërmjetësim të specializuar dhe mbështetje të vazhdueshme.	2026	2030	AKPA	MEI	175	450	450	450	450
Masa prioritare 2.3 Përmirësimi i sistemit të vlerësimit dhe regjistrimit të punëkërkuësve me aftësi të kufizuara, me fokus të veçante të rinjtë dhe gratë me aftësi të kufizuara	2027	2030	AKPA	MEI	-	3,750	1,425	175	175

2.3.1 Ngritja dhe konsolidimi i sistemit të vlerësimit të kapaciteteve për punë për punëkërkesit e papunë me aftësi të kufizuara pranë AKPAs, profilizimi individual cilësor i punëkërkesve me aftësi të kufizuara, duke marrë në konsideratë (i) aftësitë, interesat dhe aspiratat;(ii) nevojat për përshtatje të arsyeshme;(iii) dimensionin gjinor dhe moshën.	2027	2030	AKPA	MEI	-	2,500	175	175	175
2.3.2 Krijimi i një sistemi të integruar të informacionit dhe ndërmjetësimit digjital të aksesueshëm, për të garantuar lidhjen automatike të punëkërkesve me aftësi të kufizuara me: (i) arsimin dhe formimin profesional (AFP); (ii) skemat aktive të punësimit; (iii) tregun e hapur të punës;	2027	2028	AKPA	MEI	-	1,250	1,250	-	-
Masë prioritare 2.4 Konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për punëdhënësit dhe punëkërkesit dhe përshtatja e vazhdueshme e tyre bazuar në praktikën e monitorimit dhe vlerësimit	2026	2030	AKPA	MEI	225,285	231,389	238,008	244,959	252,257
2.4.1 Ofrimi i shërbimeve të punësimit për personat me aftësi të kufizuara në tre nivele: (i) shërbime bazë universale; (ii)shërbime të ndërmjetësimit të avancuar; (iii) shërbime të personalizuar intensive, përfshirë punësimin me mbështetje, bazuar në “Udhëzuesin mbi këshillimin e punëkërkesve me aftësi të kufizuara”.	2026	2030	AKPA	MEI	68,000	68,000	68,000	68,000	68,000
2.4.2 Përshtatja dhe zgjerimi i programeve të nxitjes së punësimit për të garantuar akses prioritar dhe masa specifike mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë subvencionimin e pagës, përshtatjen e vendit të punës dhe mbështetjen për punëdhënësit.	2026	2030	AKPA	MEI	92,275	96,888	101,733	106,819	112,160
2.4.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe të përshtatura për nxitjen e punësimit të punëkërkesve me aftësi të kufizuara, si <i>punësimi me mbështetje, vetëpunësim, sipërmarrjeve sociale, aftësim i personave me aftësi të kufizuara etj.</i> , në partneritet me partner të tjerë social publik dhe privatë, përfshirë organizata me eksperiencë në fushën e aftësimin dhe punësimit për personat me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKPA	MEI	1,200	-	-	-	-

2.4.4. Mbështetja e tranzicionit nga shkolla në punë për të rinjtë me aftësi të kufizuara, përmes integritit i personave me aftësi të kufizuara në skemën e Garancisë Rinore, duke garantuar akses në punësim, formim, praktikë profesionale dhe mbështetje të personalizuar.	2026	2030	AKPA	MEI	33,810	35,501	37,276	39,140	41,097
2.4.5 Financim dhe mbështetje për punëdhënësit për të realizuar përshtatjen e arsyeshme për përfshirjen reale të punëkërkuarëve me aftësi të kufizuara në vendin e punës (përfshirë sigurimin e pajisjeve dhe shërbimeve personale të vazhdueshme)	2026	2030	AKPA	MEI	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
2.4.6 Organizimi i fushatave informuese për Fondin Social të Punësimit dhe programet aktive të tregut të punës për personat me aftësi të kufizuara.	2027	2030	AKPA	MEI	-	1,000	1,000	1,000	1,000
Masa Prioritare 2.5 Forcimi i qeverisjes, koordinimit dhe monitorimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara	2026	2030	AKPA/MEI	MEI/AKPA/AK AFPK	3,480	1,380	1,380	1,380	1,380
2.5.1. Vlerësim kombëtar mbi nivelin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat në përputhje me detyrimet ligjore bazuar në Ligjin për nxitjen e punësimit.	2026		AKPA	MEI	2,100	-	-	-	-
2.5.2 Vlerësim periodik i programeve dhe i efekteve të politikave dhe mekanizmit të skemave të përfshirjes aktive në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë aksesin e tyre në sistemin e pagesave të papunësisë dhe mbrojtjen që ky sistem ofron për ta.	2026	2030	AKPA	MEI	300	300	300	300	300
2.5.3. Koordinimi dhe Monitorimi i zbatimit të zbatimit të PKPAK, në mënyrë të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore.	2026	2030	MEI	AKPA, AKAFPK	1,080	1,080	1,080	1,080	1,080
IV. ARSIMI					331,251	562,523	633,142	680,211	733,312
Objektivi Specifik 1: Zhvillimi dhe edukimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me aftësi të kufizuara në fëmijërinë e hershme dhe arsimin parashkollor duke investuar në infrastrukturë, shërbime mbështetëse dhe zhvillimin profesional të stafit të kopshteve.	2026	2030	MA /MPV/NJVV/A SCAP/AKAP/ ZVA/DRAP/N JPV	NJVV / DRAP / ZVAP/ DRSHKSH / INSTITUCION E ARSIMORE/BA SHKI/AKAP/D RAP/ZVA /ASCAP/ MSHMS	60,325	91,518	90,150	90,150	90,150

Masa Prioritare 1.1: Përmirësimi i kuadrin të politikave dhe qeverisjes për të garantuar akses të barabartë në edukimin e hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara	2026	2027	MA, NJVV	MPV, NJVV, DRAP, ZVAP, DRSHKSH, MSHMS,	175	868	-	-	-
1.1.1 Rishikimi dhe përditësimi i politikave, akteve nënligjore dhe udhëzimeve për edukimin e hershëm gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Realizimi i një vlerësimi të politikave, akteve nënligjore dhe udhëzimeve në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve shoqërore, identifikimi i mangësive dhe ofrimi i rekomandimeve për ndërhyrje. (Ref SKA 2021-2026, A.1.1.2)	2026	2027	MA, NJVV	MPV, NJVV, DRAP, ZVAP, DROSHKSH, MSHMS, MPV,	175	637	-	-	-
1.1.2 Fuqizimi i mekanizmave ndërinstitucionalë të bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, përmes hartimit dhe zbatimit të një udhëzuesi të përbashkët për identifikimin, referimin, rregjistrimin dhe mbështetjen e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte e klasat përgatitore. (Ref SKA 2021-2026, A.1.1.2)	2026	2027	MA, NJVV	MPV, MSHMS, MPV, NJVV	-	231	-	-	-
1.1.3 Hartimi i raportit vjetor mbi ecurinë e nxënësve me AK, për vitin shkollor përkatës.	2026	2030	NJVV, AKAP	MPV, MA	-	-	-	-	-
Masa Prioritare 1.2: Krijimi i infrastrukturës dhe mjediseve të aksesueshme, të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte dhe arsim parashkollor.	2026	2030	MA/ MSHPV/ AKAP/DRAP/Z VAP/NJVV	NJVV/INSTITUCIONE ARSIMORE/KO PSHTE/BASHKI	59,400	59,400	59,400	59,400	59,400
1.2.1 Planifikimi dhe realizimi i investimeve për të garantuar përshtatshmërinë e godinave të kopshteve dhe klasave përgatitore, (hyrja, ambjentet e brendshme, ambjentete e lojrave, nyjet hidrosanitare) përfshirë sinjalistikë e kontraste për fëmijët e verbër. (Ref SKA 2021-2026, A2.1.5 dhe A.2.4.1)	2026	2030	MA, MSHPV	NJVV	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000

1.2.2 Planifikim, buxhetim dhe pajisja e kopshteve/klasave përgatitore me mjete didaktike dhe dhe lojra/ kënde lodrash të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara.(ref SKA2021-2025, A.2.1.4)Disa nga programet teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara janë: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, në dëgjim dhe në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecs (komunikim nëpërmjet figurave)	2026	2030	MA, MSHPV	NJVV	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
1.2.3 Sesione informuese për prindërit e fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara për rëndësinë e arsimit parashkollor, dhe për elemente që lidhen me barazinë dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit do të bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore. (ref SKA 2021-2026, A 1.1.1)	2026	2030	AKAP, DRAP, ZVAP, NJVV	Institucionet arsimore, Kopshtet, Bashki	20,400	20,400	20,400	20,400	20,400
Masa prioritare 1.3. Shërbime mbështetëse multidisiplinare dhe edukim i hershëm i individualizuar.	2026	2030	MA/MPV/AKAP/DRAP/ZVAP/MPV/NJPV	NJVV/AKAP/DRAP/ZVA/IAP/AKAP/DRAP/KOPS HTET	-	-	-	-	-
1.3.1 Mbështetja me mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte dhe në klasat përgatitore. Përmirësimi i raportit mësues ndihmës dhe fëmijë me aftësi të kufizuara, për të garantuar mbështetje për një periudhë më të gjatë për fëmijën në ambientet zhvillimore/mësimore. (ref SKA A2.1.1)	2026	2030	MA, MPV	NJVV, AKAP, DRAP, ZVAP, , IAP, Kopshtet	-	-	-	-	-
1.3.2 Krijimi dhe forcimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në edukimin e hershëm, përmes krijimit/ mbulimit me hapsira zhvillimore të gjithë kopshteve/ IAP.	2026	2030	MA, MPV	ZVAP-et IAP-et, NJVV,Kopshtet	-	-	-	-	-

1.3.3 Angazhimi i profesionistëve të specializuar (psikologë, logopedë, terapistë zhvillimi, punonjës socialë), për të hartuar dhe zbatuar Planet Individuale të Zhvillimit dhe të Edukimit, bazuar në udhëzimin mbi planifikimin e përbashkët të nënshkruar nga institucionet publike arsimore, shëndetësore dhe ato të mbrojtjes e shërbimeve shoqërore në nivel vendor, në përputhje me nevojat individuale të fëmijëve në kopshte (grupi i 3të në kopshte dhe klasa përgatitore në IAP).	2026	2030	AKAP, DRAP, ZVAP, NJVV, DROSHKSH	IAP, Kopshtet	-	-	-	-	-
					-	-	-	-	-
1.3.4 Përfshirja aktive e prindërve në procesin e zhvillimit dhe edukimit të hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara (relaizimin e planit PEI, përmes formalizimit të takimeve të paktën, 1 herë në 3 muaj.	2026	2030	NJPV, DRAP, ZVAP	IAP, Kopshtet	-	-	-	-	-
Masa prioritare 1.4: Zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe sigurimi i cilësisë së edukimit të hershëm gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara.	2026	2030	ASCAP/MA/AK AP/NJVV	DRAP/ZVAP/NJVV/ASCAP	750	31,250	30,750	30,750	30,750
1.4.1 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të detyrueshme të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për edukatorët dhe stafin ndihmës/mësuesit ndihmës me qëllim forcimin e kompetencave për arsimin gjithëpërfshirës, zhvillimin e hershëm të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe identifikimin e hershëm të nevojave zhvillimore dhe arsimore, (Ref SKA Produkti A.3.2). A.3.2.1 Zhvillimi i moduleve të trajnimit të bazuara në standardet profesionale të mësuesit dhe në koherencë me kurrikulën bazuar në kompetenca).	2026	2030	ASCAP	DRAP, ZVAP, NJVV	750	750	750	750	750
1.4.2 Mbështetja e mësuesve ndihmës në arsimin parashkollor si pjesë e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës	2026	2030	MA	ASCAP	-	-	-	-	-
1.4.3 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit për prindërit/familjarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara me qëllim bashkëpunimin me kopshtet dhe institucionet arsimore për zhvillimin dhe edukimin e hershëm të fëmijës dhe identifikimin e hershëm të nevojave,	2027	2030	ASCAP, AKAP, NJVV	DRAP, ZVAP, NJVV	-	30,500	30,000	30,000	30,000

Objektivi Specifik 2. Garantimi i arsimit parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të barabartë për nxënësit me aftësi të kufizuara.	2026	2030	MA/MPV/ /ASCAP/AKA P/ZVA/MA/M PV	DRAP/ ZVAP/NJVV/D ROSHKSH/KM D /AKAP/NJVV /ASCAP/ZVAP/ AP/ MSHMS	242,260	316,465	390,132	443,451	496,552
Masa Prioritare 2.1: Kuadër ligjor, institucional dhe mekanizma të qeverisjes për arsimin parauniversitar gjithëpërfshirës.	2026	2030	MA/MPV/ ASCAP/AKAP /MSHMS	DRAP/ ZVAP/NJVV/D ROSHKSH/KM D/	611	611	73	73	73
2.1.1 Rishikimi dhe përmirësimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve për zbatimin e arsimit parauniversitar gjithëpërfshirës, bazuar në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.	2026	2027	MA	DRAP, ZVAP, NJVV, DROSHKSH, KMD	231	231	-	-	-
2.1.2 Forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstucional ndërmjet MA, MPV dhe MSHMS përmes realizimit të një marrëveshje bashkepunimi për të identifikuar, referuar përmes një qasje të integruar, nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.	2026	2027	MA, MPV MSHMS	DRAP, ZVAP, NJVV,	182	182	-	-	-
2.1.3 Rishikimi i mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe llogaridhënies për zbatimin e arsimit parauniversitar gjithëpërfshirës. Integrimi i indikatorëve të aksesit, përfshirë indikatorët gjinorë, llojeve të aftësisë së kufizuar, të aksesueshmërisë, cilësisë, mbështetjes individuale dhe rezultateve arsimore në sistemet e monitorimit. Realizimi i monitorimeve dhe raportimeve periodike.	2026	2030	MA, ASCAP, AKAP	DRAP, ZVAP, IAP	198	198	73	73	73
Masa Prioritare 2.2 Identifikim i hershëm, vlerësim multidisiplinar dhe planifikim arsimor i individualizuar për nxënësit me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKAP/ DRAP/ ZVAP/MA	AKAP/DRAP/ ZVAP/NJVV/ DROSHKSH/IA P/AKAP/ASCA P	218	218	218	327	218
2.2.1 Forcimi i sistemit të identifikimit të hershëm të nxënësve me aftësi të kufizuara.	2026	2030	AKAP, DRAP, ZVAP	DRAP, ZVAP, NJVV, DROSHKSH,	109	109	109	109	109
2.2.2 Fuqizimi dhe rritja e efektivitetit të KMD pranë ZVAP-eve për të realizuar vlerësimin e nxënësve më aftësi të kufizuara. Zbatimi i vlerësimit multidisiplinar të nevojave arsimore të nxënësve, përfshirë dhe planifikimet e duhura buxhetore vjetore për plotësimin e kërkesave për akomodimin/ përshtatjen e arsyeshme.	2026	2027	MA	AKAP, DRAP, ZVAP	109	109	109	109	109

2.2.3 Hartimi dhe zbatimi i Planeve Edukativ Individualë), bazuar në nevojat dhe ritmin e të nxënësve të secilit nxënës.	2026	2030	MA	AKAP, DRAP, ZVAP, IAP	-	-	-	109	-
2.2.4 Monitorimi zbatimit dhe efektivitetit të PEI-ve të paktën 1 herë në vit	2026	2030	MA	AKAP/ASCAP	-	-	-	-	-
2.2.5 Përfshirja aktive e prindërve në planifikimin edukativ individual të paktën 1 herë në vit.	2026	2030	MA	AKAP/ASCAP					
Masa Prioritare 2.3 Mbështetje profesionale, kurrikulare për nxënës gjatë gjithë procesit të nxënësimit me aftësi të kufizuara.	2026	2030	MA/MPV	AKAP /DRAP/ ZVAP/ ASCAP/ IAP/ NJVV	241,431	315,636	389,841	443,051	496,261
2.3.1.. Rritja e numrit dhe forcimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës, psikologëve shkollorë, punonjësve socialë dhe specialistëve të tjerë mbështetës.	2026	2030	MA	AKAP, DRAP, ZVAP, ASCAP, IAP	185,640	259,845	334,050	387,260	440,470
2.3.2. Sigurimi i shërbimeve ndihmëse dhe mjeteve didaktike për nxënësit me aftësi të kufizuara.(ref SKA2021-2025, A.2.1.4)	2026	2030	MA	AKAP, DRAP, ZVAP, ASCAP, IAP	40,800	40,800	40,800	40,800	40,800
2.3.3. Zbatimi i metodologjive gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara. Zbatimi i parimeve të Dizajnit Universal për të Nxënët (UDL) në procesin mësimor.	2027	2028	MA	ASCAP, AKAP	1,391	1,391	1,391	1,391	1,391
2.3.4 Monitorimi sistematik i zbatimit të metodologjive gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara. Procesi i monitorimit do të organizohet nga DPAP-ja, nëpërmjet DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në bazë të udhëzimeve të hartuara nga ASCAP. Institucionet përgjegjës për këtë pikë do të jetë ASCAP dhe AKAP.	2026	2030	ASCAP, AKAP	ASCAP, AKAP					
2.3.5 Optimizimi i hapsirave shkollore, burimeve mësimore dhe i mjediseve digjitale në funksion të pjesëmarrjes aktive të nxënësve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor.	2026	2030	MA, MPV	AKAP, DRAP, ZVAP, ASCAP, NJVV	13,600	13,600	13,600	13,600	13,600
Masë prioritare 2.4 Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe përfshirja e prindërve dhe komunitetit.	2026	2030	MA	DRAP/ZVAP	-	-	-	-	-

2.4.1 Zbatimi i programeve të detyrueshme të zhvillimit profesional për mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe stafin mbështetës për forcimin e kompetencave për menaxhimin e diversitetit dhe mbështetjen e të nxëniet të individualizuar për nxënësit me aftësi të kufizuara. (Ref Programit kombëtar për zhvillimin profesional të mësuesve 2026-2028,ASCAP)	2026	2030	MA	DRAP/ZVAP	-	-	-	-	-
2.4.2 Fuqizimi i mekanizmave formalë të bashkëpunimit ndërmjet shkollave, nxënësve me dhe pa aftësi të kufizuara, prindërve dhe komunitetit. Informimi dhe përfshirja e prindërve në vendimmarrje dhe në mbështetjen e mirëqenies së nxënësve me aftësi të kufizuara.	2026	2030	MA	DRAP/ZVAP	-	-	-	-	-
Objektivi Specifik 3. Transformimi/riorganizimii shkollave specialenë qendra burimoredhe konsolidimi I rolit dhe veprimtarisë së tyre	2026	2030	MoE/ASCAP	MoE/QB për njerëzit që nuk dëgjojnë/MSHM S/INND/INNSH/ PEI/IAL/ZVA/D RAP/NJVV/ASCAP/KMVA	27,577	28,439	27,827	21,577	21,577
Masa Prioritare 3.1: Konsolidimi i kuadrit rregullator për qendrat burimore.	2026	2030	MoE	MoE/QB për njerëzit që nuk dëgjojnë/MSHM S	-	462	-	-	-
3.1.1 Miratimi i VKM-së për unifikimin e Kodit Braille në nivel kombëtar.(draft, ende e pa aprovuar).	2027		MoE	MSHMS	-	462	-	-	-
3.1.2 Zhvillimi në vazhdim i kërkimit dhe dokumentimit të gjuhës së shënjave shqipe,pasurimi i fjalorit.	2026	2029	MA	QB për njerëzit që nuk dëgjojnë; MSHMS	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
3.1.3 Rishikimi i VKM Nr 837, datë 03.12.2014, për aprovimi e alfabetit të zgjeruar të gjuhës së shënjave.		2030	MA	QB për njerëzit që nuk dëgjojnë; MSHMS	-	-	-	-	462
Masa Prioritare 3.2 Akreditimi dhe integrimi i moduleve të trajnimit të hartuara nga Qëndrat Burimore në programet kombëtare të zhvillimit.	2026	2030	ASCAP, MA	INND/INNSH/I AP/IAL	-	400	-	-	-
3.2.1.Përfundimi i procesit të akreditimit të moduleve të trajnimit të zhvilluara nga INND dhe INNSH.	2027		ASCAP, MA	INND, INNSH	-	400	-	-	-

3.2.2 Zgjerimi i përdorimit të moduleve në trajnime të detyrueshme për stafin arsimor në shkollat e zakonshme.	2028		ASCAP, MA	INND, INNSH, IAP	-	-	-	-	-
3.2.3 Forcimi i lidhjes ndërmjet qendrave burimore dhe institucioneve të arsimit të lartë për përgatitjen afatgjatë të specialistëve.	2026	2030	MA	IAL	-	-	-	-	-
Masa Prioritare 3.3. Zgjerimi territorial dhe funksional i shërbimeve të qendrave burimore	2026	2030	MA	ZVAP/ DRAP /NJVV/ ASCAP	27,500	27,500	27,500	21,500	21,500
3.3.1 Shtirja graduale e shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese të qendrave burimore në të gjitha qarqet, përmes zgjerimit të funksionit të hapsirave zhvillimore, dhe ngritjes e fuqizimit të tyre në IAP ku ende mungojnë.	2026	2030	MA	ZVAP, DRAP, NJVV	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
3.3.2 Zhvillimi dhe shpërndarja e materialeve didaktike të specializuara për përdorim në shkollë kombëtare.	2026	2030	MA	ZVAP, DRAP, NJVV	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
3.3.3 Forcimi i rolit të qendrave burimore si qendra ekspertize për shkollat e zakonshme.	2026	2030	MA	ZVAP, DRAP, AKAP, ASCAP	6,000	6,000	6,000	-	-
Masa Prioritare 3.4. Monitorimi, vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së funksionimit të qendrave burimore	2028	2030	MA	ZVAP, DRAP, AKAP, ASCAP	77	77	327	77	77
3.4.1 Vendosja e indikatorëve të performancës për shërbimet mbështetëse që qëndrat burimore ofrojnë, trajnimet dhe ndikimin e tyre në arsimin gjithëpërfshirës.	2028		MA	ZVAP, DRAP, AKAP, ASCAP	-	-	250	-	-
3.4.2 Raportim periodik mbi efektivitetin e qendrave burimore dhe përdorimi i gjetjeve për përmirësim të politikave.	2028	2030	MA	ZVAP, DRAP, AKAP, ASCAP	77	77	77	77	77
Objektivi Specifik 4. Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, cilësisë dhe mbështetjes për studentët me aftësi të kufizuara..	2026	2030	MA	ASCAL/IAL	1,089	126,101	125,033	125,033	125,033
Masa Prioritare 4.1: Rishikimi dhe forcimi i një kuadri të qëndrueshëm ligjor dhe institucional që garanton mosdiskriminimin, aksesin e barabartë dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të gjithëpërfshirjes së studentëve me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë, i integruar me mekanizma të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.	2026	2030	MA	ASCAL/IAL	389	1,101	33	33	33

4.1.1 Rishikimi dhe përditësimi i politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të IAL-ve për të garantuar arsimin e lartë gjithëpërfshirës. Harmonizimi me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë	2026	2027	MA	ASCAL/IAL	356	356	-	-	-
4.1.2 Integrimi i indikatorëve të gjithëpërfshirjes dhe aksesueshmërisë në sistemet e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit të IAL.	2027		MA	IAL	-	712	-	-	-
4.1.3 Raportim periodik mbi progresin dhe ndikimin e masave për arsimin e lartë gjithëpërfshirës.	2027	2030	MA	IAL/ASCAL	33	33	33	33	33
Masa Prioritare 4.2 Aksesueshmëri e plotë fizike, digjitale dhe akademike në institucionet e arsimit të lartë Sigurimi i një mjedisi universitar të aksesueshëm për të gjithë studentët, përmes përshtatjes së infrastrukturës, teknologjisë, komunikimit dhe proceseve akademike, në përputhje me parimet e dizajnit universal.	2027	2030	MA	IAL	700	50,000	50,000	50,000	50,000
4.2.1 Investime në përshtatjen e infrastrukturës fizike, ambienteve mësimore, bibliotekave dhe laboratorëve.	2027	2030	MA	IAL	-	50,000	50,000	50,000	50,000
4.2.2 Aksesueshmëria e platformave digjitale, materialeve mësimore dhe shërbimeve të informacionit.	2027	2027	MA	IAL	700	-	-	-	-
4.2.3 Përshtatja e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit dhe pjesëmarrjes akademike.	2027	2030	IAL	IAL	-	-	-	-	-
Masa Prioritare 4.3 Shërbime mbështetëse dhe zhvillim kapacitetesh për arsimin e lartë gjithëpërfshirës Forcimi i mbështetjes institucionale dhe profesionale për studentët me aftësi të kufizuara, përmes shërbimeve të specializuara dhe rritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe administrativ.	2027	2030	IAL	IAL	-	75,000	75,000	75,000	75,000
4.3.1 Krijimi / forcimi i njërive të posaçme mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara në IAL.	2027	2030	IAL	IAL	-	75,000	75,000	75,000	75,000
4.3.2 Ofrimi i këshillimit akademik, psikosocial dhe ndërmjetësimit për të garantuar përshtatjen e arsyeshme.	2027	2030	IAL	IAL	-	-	-	-	-
V. MBROJTJA SOCIALE					19,630	169,287	70,687	63,313	187,047

Objektivi Specifik 1. Përmirësimi i jetesës për Personat me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të mirëshënjestruara, transparente dhe të afta për të përballuar rreziqet e ndryshme	2026	2030	MSHMS	SHSSH/INSTAT	1,259	8,109	9,795	9,285	8,985
Masa Prioritare 1.1. Konsolidimi dhe përmirësimi i skemës së pagesave të aftësisë së kufizuar, për të garantuar rritjen e masës së përfitimit, për të mbuluar kostot që lidhen me aftësinë e kufizuar, por edhe skemave të tjera mbështetëse financiare (NE etj) për të garantuar akses, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre me ndikim zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë	2026	2030	MSHMS	SHSSH/INSTA	-	500	300	990	690
1.1.1.Ndërtimi i një mekanizmi vjetor për rishikimin/indeksimin e masës së përfitimit të aftësisë së kufizuar (Ndërhyrja A2.1.4 SMS);	2026	2030	MSHMS	SHSSH	-	-	-	-	-
1.1.2. Përfshirja e indikatorëve të aftësisë së kufizuar në Anketat e të Ardhurave të Nivelit të Jetesës për të matur nivelin e varfërisë tek personat me aftësi të kufizuara e familjet e tyre; Realizimi i raporteve periodike mbi nivelin e varfërisë brenda popullatës së njerëzve me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre (Ndërhyrja A2.1.16 SMS);	2027	2029	MSHMS	INSTAT	-	500	300	300	-
1.1.3. Analizë për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara gjatë krizave apo emergjencave civile (A2.1.8 SMS);	2029	2030	MSHMS	SHSSH	-	-	-	-	-
1.1.4.Përgatitja e udhëzuesve me qëllim krijimin e skemave fleksibël të mbështetjes financiare në raste emergjencash (fatkeqësi natyrore, kriza shëndetësore, zhvendosje), me prioritetizim të personave me aftësi të kufizuara;	2029	2030	MSHMS	SHSSH	-	-	-	690	690
1.1.5. 1.1.5. Mbështetja me skemën financiare të personave me aftësi të kufizuara (A.2.1.4 në SMS)	2026	2030	MSHMS	SHSSH	-	-	-	-	-
Masa prioritare 1.2. Konsolidimi i vlerësimit bio-psikosocial të aftësisë së kufizuar me qëllim adresimin efektiv dhe të përgjegjshëm gjinor të nevojave individuale të tyre.	2026	2030	MSHMS	SHSSH	1,259	7,609	9,495	8,295	8,295

1.2.1. Analizë periodike e impaktit të skemës së vlerësimit të PAK, përfshirë vlerësimin përmes lenteve gjinore të impaktit të gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara, si edhe tek fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim sugjerime të përmirësimeve lidhur me mirëshënjestrimin, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e skemës (Ndërhyrja A2.1.1 SMS);	2026	2028	MSHMS	SHSSH	-	-	-	-	-
1.2.2. Rishikimi i kritereve të vlerësimit bio-psiko-social për të rritur dhe për fëmijë, në përputhje me aplikimin e ICD 11 në sistemin e shëndetësisë	2028	2030	MSHMS	SHSSH	409	409	409	409	409
1.2.3. Përmirësimi i infrastrukturës së vlerësimit të PAK me synim realizimin e aksesueshmërisë në mjediset e vlerësimit, përfshirë atë në informacion e komunikim (A2.1.5 SMS);	2027	2030	MSHMS	SHSSH	-	6,000	6,000	6,000	6,000
1.2.4. Rritja e performancës së strukturave zbatuese të reformës së vlerësimit biopsiko-social në nivelin qendror, rajonal dhe lokal (Studim dhe rekomandime për burime njerëzore, trajnim për miradministrim, monitorim, vlerësim) (A.2.1.6 SMS);	2026	2030	MSHMS	SHSSH	-	-	-	-	-
